

RRUGA E VËRTETA JETA

Dishepullimi si
Rrugëtim i Hirit

David A. Buzik

Copyright © 2024

The Foundry Publishing

237-0-00194-599-9

Titulli i origjinalit:

Way Truth Life

Autori: David A. Buisc

Publikuar nga: The Foundry Publishing

Botuar në gjuhën shqipe me lejen e

The Foundry Publishing.

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk duhet të riprodhohet, të vihet në një sistem, ose të transmetohet në çdo formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjimi, incizimi apo në ndonjë mënyrë tjetër pa marrë më parë leje me shkrim nga botuesi.

Përkthyes: Lirak Gjoshi

Redaktuese: Edlira Biti

Në qoftë se nuk ka ndonjë shënim të veçantë, citimet nga Bibla janë marrë nga Diodati i Ri, përkthimi 1991–1994.

Adresat e internetit në këtë libër ishin të sakta në kohën e botimit, por ato mund të mos jenë të disponueshme në të gjitha gjuhët. Këto linke janë dhënë si burim. Botuesi nuk i miraton ato ose nuk garanton për përmbajtjen apo qëndrueshmërinë e tyre.

*Në kujtim të Robert E. Buzik (Robert E. Busic), një baba që më mësoi se
dishepullimi është një rrugëtim i mbuluar nga hiri dhe se ngjashmëria me
Krishtin është fati ynë.*



*Mësomë rrugën Tënde, o Zot, dhe unë do të ec në të vërtetën Tënde; bashkoje
zemrën time me frikën e emrit Tënd.*

–Psalmet 86.11

PËRMBAJTJA

Falenderimet.....	7
Hyrje.....	9
1. Hiri që na mahnit	19

Rruga

2. Hiri që na kërkon.....	33
---------------------------	----

E vërteta

3. Hiri që na shpëton.....	49
----------------------------	----

Jeta

4. Hiri që na shenjtëron	71
5. Hiri që na mban.....	101
6. Hiri që na mjafton.....	135
Pasthënie: Jezus Krishti është Zot.....	151

FALENDERIMET

Mirënjohjet mund të shtrihen në një diapazon, nga njohja e atyre që bëjnë diçka të mundshme, deri tek borxhet e mirënjohjes që nuk mund të shlyhen. Kështu është tani.

Kur u zgjodha për të shërbyer si Mbikëqyrës i Përgjithshëm për Kishën e Nazaretasit, e dija që kolegët e mi në Bordin e Mbikëqyrësve të Përgjithshëm do të kishin ndikim në jetën time, por shkalla e ndikimit të tyre ka qenë e pallogaritshme. Ndërsa ka pothuajse gjithmonë dallime mendimesh në bisedat tona të panumërta drejtuese, gjërat që qëndrojnë të palëkundura janë përkushtimi i tyre për të bërë me besnikëri dhe lutje atë që është më e mira për kishën, edhe kur është e kushtueshme dhe besimi im absolut në forcën e karakterit të tyre dhe pastërtinë e zemrave të tyre. Faleminderit Filimia Çambo (*Filimao Chambo*), Gustavo Kroker (*Gustavo Crocker*), Juxhenio Duarte (*Eugenio Duarte*), Dejvid Grejvs (*David Graves*), Xheri Porter (*Jerry Porter*), Karla Sanberg (*Carla Sunberg*) dhe J. K. Uarik (*J. K. Warrick*). Ndikimi juaj ka frymëzuar shkrimin e këtij libri në shërbim të kishës për të na ndihmuar të përmbushim misionin tonë “për të bërë dishepuj të ngjashëm me Krishtin ndër kombe”.

Faleminderit Skot Rejni (*Scott Rainey*), Drejtori i Shërbesave Globale të Dishepullimit për Kishën e Nazaretasit, për ftesën për të shkruar një libër të thjeshtë që thekson dishepullimin e shenjtërisë si një rrugëtim hiri. Faleminderit Boni Perri (*Bonnie Perry*), Drejtoreshë Editoriale në The Foundry Publishing, për besimin e saj të palëkundur se teologjia e mirë, e shkruar dhe e përcjellë

tek fëmijët tanë është një detyrë mjaft e rëndësishme për të investuar jetën e saj më të mirë. Faleminderit Audra Spajven (*Audra Spiven*) për redaktimin me një sy për qartësi dhe gjithmonë duke shtruar pyetjen: “Po sikur ta thoshe në këtë mënyrë?” Në fund, i falënderoj për pjesëmarrjen jo shumë të madhe, por jashtëzakonisht të dashur të nazaretasve të rinisë sime, të cilët më mësuhan se shenjtëria nuk është vetëm ajo që Perëndia në Krishtin ka bërë për ne, por edhe ajo që Perëndia në Krishtin po bën pa pushim në ne dhe përmes nesh kur heqim dorë nga e drejta për veten tonë dhe lejojmë Jezusin të jetë Zot.”

Shënim nga Autori

Siç ka qenë stili im në shkrimet e mëparshme, unë e inkurajoj lexuesin të konsultohet me shënimet fundore të bollshme për një kuptim më të madh në lidhje me dishepullimin dhe rrugëtimin e hirit. Shënimet e bollshme pasqyrojnë borxhin tim ndaj të menduarit të të tjerëve dhe dëshirën time për të ofruar njohuri shtesë që do të ishin një barrë për pjesën kryesore të tekstit. Për hir të qasshmërisë, citimet e plota ofrohen sa herë që fillon një kapitull i ri, edhe nëse ai autor ose burim është njohur më parë.

HYRJE

Jezusi na fton në një udhëtim. “Eja, më ndiq Mua.” Është një ftesë e thjeshtë për të shkuar në një aventurë me një mik të dashur. Jeta e krishterë është më shumë se besim i duhur. Është më shumë se pëlqim intelektual. Është një ftesë për një rrugëtim me Jezusin.

Një fjalë tjetër për udhëtimin me Jezusin është dishepullimi. Dishepullimi është ndjekja e rrugës së Jezusit, ndërsa udhëton me Jezusin. Rruga ka shumë kthime, kthesa dhe lakime të papritura. Ndonjëherë rruga ndihet e lehtë dhe herë të tjera ndihet si një ngjitje e vështirë. Sidoqoftë, qëllimi përfundimtar (në greqisht, *telos*) i dishepullimit është gjithmonë i njëjti: të jesh si Krishti.

Nëse kjo duket e pamundur, ju në të vërtetë jeni në një vend shumë të mirë për të filluar. Në fakt, do të ishte e pamundur, nëse jo për një siguri shumë të rëndësishme ne bëjmë udhëtimin me Jezusin. Kjo është arsyeja pse është një udhëtim hiri.

Kur Jezusi tha: “Unë jam udha, e vërteta, dhe jeta” (Gjoni 14.6) Ai po fliste për më shumë sesa një ekuacion vijues, intelektual ose një marrëveshje transaksionare që ne bëjmë me Perëndinë. Ai po përshkruan mënyrën reciproke në të cilën dishepullimi do të ndodhë. Në të vërtetë, Udhë, e Vërteta dhe Jeta nuk janë abstraksione filozofike ose parime të jetës. Udhë, e Vërteta dhe Jeta janë një Person.

Jezusi po na drejtonte drejt *telos* (synimit) të duhur të udhëtimit: jeta reale siç e kishte për qëllim Perëndia dhe mjetet me të cilat ne e arrijmë qëllimin

janë rruga, e vërteta, të përmbushura në dhe përmes Tij¹. Udhëtimi i hirit është relativ në thelb.

Xhejms K. A. Smith (*James K. A. Smith*) e përshkruan dishepullimin si “një lloj imigrimi, nga mbretëria e errësirës në mbretërinë e Birit të dashur të Perëndisë (Kolosianëve 1.13)”². Kjo është gjuha e një rrugëtimi, duke lëvizur nga një vend në tjetrin³. Bëhet fjalë për ndryshimin e shtetësisë dhe besnikërisë, e cila është plotësisht e pamundur, veçse përmes hirit të Perëndisë në Jezus Krishtin, i cili është Udhë. Smith vazhdon: “Në Krishtin na është dhënë një pasaportë qiellore; në trupin e Tij ne mësojmë të jetojmë si ‘vendas’ të mbretërisë së Tij. Një imigrim i tillë në një mbretëri të re nuk është vetëm çështje e teleportimit në një sferë tjetër; ne duhet të ambientohemi me një mënyrë të re të jetës, të mësojmë një gjuhë të re, të fitojmë zakone të reja – dhe të çmësojmë zakonet e atij sundimi rival.”⁴

Unë me të vërtetë besoj se kur Jezusi tha: “Po shkoj të përgatis një vend për ju” (Gjoni 14), ai premtoi përfshinte garancinë që Ai personalisht ka bërë rezervime për ne për udhëtimin, përfshirë akomodimet kur të mbërrijmë. Ai është pasaporta jonë qiellore që na mundëson të bëhemi vendas të një vendi të ri, të mbretërisë së Tij. Më e mira nga të gjitha është se Ai premton të na shoqërojë deri në shtëpi. Jezusi do të jetë Udhë jonë për rrugën. Kjo është shpresa e një udhëtimi hiri.

Unë jam Udhë, e Vërteta dhe Jeta

Kur Jezusi tha: “Unë jam udhë, e vërteta dhe jeta”, Ai nuk po sugjeronte një parim abstrakt të jetës për t’u varur si pllakë në mur. Përkundrazi, ishte një përgjigje ndaj një pyetjeje të ngritur nga dishepuj të frikësuar dhe të pasigurt.

1. Richard John Neuhaus (*Riçard Gjoni Neuhaus*) e përkufizon telos si “fundi përfundimtar që i jep kuptim sendit në fjalë” Neuhaus, *Death on a Friday Afternoon: Meditations on the Last Words of Jesus from the Cross* (New York: Basic Books, 2000), 127.
2. James K. A. Smith, *You Are What You Love: The Spiritual Power of Habit* (Grand Rapids: Brazos Press, 2016), 66.
3. John Bunyan’s *The Pilgrim’s Progress* (1678) ishte një version i hershëm fiktiv i të njëjtit koncept të udhëtimit që bën dikush për të ndryshuar vendet ose mbretëritë.
4. Smith, *You Are What You Love*, 66.

Vjen nga një pjesë në Ungjillin e Gjonit që studiuesit biblik i referohen si “diskutimi i fundit” (Gjoni, kapitujt 14 deri 17). Këta katër kapituj të Gjonit, më shumë se cilido nga tre ungjijtë e tjerë të Dhjatës së Re, na japin një vështrim nga brenda të asaj që Jezusi po mendonte dhe po i mësonte dishepujt e Tij gjatë orëve pak para vuajtjes dhe vdekjes së Tij në kryq. Kështu që, ato mund të përshkruhen si vullneti dhe testamenti i fundit i Jezus Krishtit⁵.

Mos harroni, dishepujt kishin dëgjuar një lajm tepër të keq. Ata janë mbledhur në një dhomë të huazuar. Të gjithë janë ngjeshur në cepa të ngushtë. Jezusi lan këmbët e dymbëdhjetë dishepujve të Tij, gjë që i bën të gjithë të ndihen të parehatshëm. Pastaj Ai vazhdon t’u tregojë atyre, se shumë shpejt njëri prej tyre do ta tradhtojë (13.21). Për t’i përkeqësuar gjërat dhe më shumë pas disa vitesh udhëtimi kudo bashkë, Jezusi u thotë atyre se po largohet dhe se ata nuk mund të shkojnë me Të (13.33).

E gjithë kjo është shumë shqetësuese! Jezusi mund ta ndiejë peshën e fjalëve të Tij që bie mbi ta. Nuk është çudi që Ai thotë: “Zemra juaj mos u tronditë” (14.1). Fjala e përkthyer si “tronditë” është e njëjta fjalë që përdoret për të përshkruar ujërat e Detit të Galileës gjatë një stuhie të furishme. Kur frynte era, ujërat turbulloheshin dhe trazoheshin. Dishepujt po ndihen në atë mënyrë. Stomakët e tyre po trazohen. Kokat e tyre po vërtiten. Emocionet e tyre janë të mbingarkuara. Jezusi përpiqet të ngushëllojë zemrat e tyre të tërbuara: “Zemra juaj mos u tronditë; ...Unë po shkoj t’ju përgatis një vend. ...Do të kthehem dhe do t’ju marr pranë Meje, që aty ku jam Unë, të jeni edhe ju. Ju e dini se ku po shkoj unë dhe e njihni edhe udhën” (Gjoni 14.1–4).

Pastaj flet Thomai. Historia e ka quajtur atë Thomai Dyshues, por unë jam i gëzuar që ai ishte atje, sepse Thomai ka guximin të bëjë pyetjen për të cilën gjithë të tjerët po kërkonin përgjigje. Ai është si një student në një klasë që ndalon profesorin në mes të leksionit dhe thotë: “Më falni! Kjo mund të jetë një

5. Frederick Dale Bruner i referohet Gjoni 14–16 si predikimet e dishepullimit të Jezusit, me kapitullin 17 që shërben si lutje përmbyllëse dhe marrë së bashku: “Teologjia Sistematike Kompakte e Jezusit për Kishën e Tij Misionare”. Bruner, *The Gospel of John: A Commentary* (Grand Rapids: Eerdmans, 2012), 78

pyetje pa kuptim, por ne nuk ia kemi idenë se për çfarë po flisni tani”. Në fakt, nuk ishte një pyetje pa kuptim. Unë mund të vlerësoj faktin që Thomai kishte gjakftohtësinë për të identifikuar problemin e dukshëm që të gjithë kishin me fjalët e Jezusit: “Zot, ne nuk e dimë se ku po shkon. Si mund ta njohim rrugën?” (14.5)

Jeta është e tillë, apo jo? Ka raste kur e gjejmë veten duke menduar se në cilën rrugë të kthehemi. Ndonjëherë, ne mendojmë se e dimë se ku po shkojmë – ose shpresojmë se e dimë se ku po shkojmë, por duhet të pranojmë se e kemi humbur plotësisht rrugën tonë. Duket se ka kaq shumë kryqëzime dhe kthesa, kaq shumë mundësi dhe rrugë pa krye. Ajo që dëshirojmë më shumë se çdo gjë tjetër në enigmën e jetës është një hartë. Sidoqoftë, shumë njerëz, duke mos e gjetur atë hartë, vendosin se është më mirë të shkojnë kudo sesa të qëndrojnë askund, kështu që ata zgjedhin një drejtim dhe nisen drejt asaj që duket se është rruga më e lehtë e mundshme.

Fatmirësisht, Jezusi i përgjigjet pyetjes së Thomait (dhe tonës): “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta. Askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet Meje” (14.6). Është interesante që theksi i pohimit të Jezusit është qartë tek fjala “udha”. Udhë është vijueshmërisht e para. Kjo nuk do të thotë që e vërteta dhe jeta nuk janë të rëndësishme. Thjesht do të thotë që e vërteta dhe jeta shpjegojnë se si dhe pse Jezusi është Udhë.⁶

Ai është Udhë, sepse është e Vërteta – zbuluesi e Perëndisë. Ai është Udhë, sepse jeta e Perëndisë në dispozicion të çdo personi qëndron në Të dhe vetëm në Të. Ai në të njëjtën kohë është edhe hyrja dhe mishërimi i jetës me Perëndinë. Thelbi i Lajmit të Mirë të Ungjillit të Gjonit është se tek Jezusi – Fjala e mishëruar dhe Biri unik i Perëndisë – ne mund ta shohim dhe njohim Perëndinë në një mënyrë që nuk është bërë e mundur më parë. Ai është vetëzbulimi i

6. Shumë njerëz e konsiderojnë Raymond Brown (*Rejmond Braun*) si studiuesin më të shquar të Gjonit nga brezi i tij. Ai beson se, “rruga është kallëzuesi kryesor [i thënies së Jezusit] dhe e vërteta dhe jeta janë thjesht shpjegime të rrugës”. Brown, *The Gospel According to John XII–XXI, The Anchor Bible Commentary* (New York: Doubleday, 1970), 621. Nëse kjo është e saktë, e vërteta dhe jeta janë shpjegime të rrugës – ose, thënë ndryshe, Jezusi është Udhë, sepse Ai është e Vërteta dhe Jeta. Jezusi personalisht i mishëron të tre.

autorizuar i Perëndisë.⁷ Me fjalë të tjera, Jezusi nuk është thjesht një udhë, por UDHA, sepse Ai është mishërimi i jashtëzakonshëm, i dukshëm i Perëndisë së padukshëm, të cilin e njohim si Atë (1.14, 18: 6.46; 8.19; 12.45).⁸

“Askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet Meje” (14.6). Shumë prej nesh mund të identifikohen me pyetjen e Thomait, “Si mund ta njohim udhën?” (14.5) sepse çdo person, qoftë i artikuluar apo jo, po kërkon përgjigje ndaj pyetjeve shpirtërore. Shoqëria jonë sot është më e hapur shpirtërisht sesa ka qenë në shumë vite. Problemi është se njerëzit janë të hapur ndaj shumë udhëve të ndryshme të spiritualitetit.

Botëkuptimi modern perëndimor buron nga një mentalitet i gjithanshëm i konsumatorit. Ai është e lidhur me shqetësimin politik shumë të fundit për përqafimin e pluralizmit. Kjo bën që shumë njerëz të shohin një udhë shpirtërore si relevante dhe legjitime, po aq sa çdo udhë tjetër, për aq kohë sa nevojat e tyre personale janë përmbushur, dhe për aq kohë sa ata janë realisht të vërtetë ndaj vetes së tyre. Dhe kështu supozohet, nëse dikush zgjedh budizmin, hinduizmin, islamin, shkencologjinë, judaizmin, krishterimin ose ndonjë fe tjetër, që për aq kohë sa dikush është i sinqertë dhe kënaqet me zgjedhjen e tij, atëherë ajo alternativë është po aq e mirë sa çdo tjetër, sepse të gjitha rrugët çojnë (kështu thotë botëkuptimi) tek i njëjti Perëndi.

Një nga problemet e shumta me një pikëpamje të tillë është se këto besime të ndryshme shpesh bien në kundërshtim me njëra-tjetrën dhe bëjnë pretendime përjashtuese reciproke. Kur krishterimi shihet në dritën e sistemeve të tjera të larmishme fetare, është i vetmi besim që bën pretendimin përfundimtar, se Jezusi është udha ekskluzive për tek Perëndia. Dikush nuk mund të besojë në pretendimin ekskluziv të Jezus Krishtit: “Askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet Meje”, dhe prapëseprapë të pohojë se ka mënyra të tjera për të pasur

7. Bruner, *The Gospel of John*, 811. Bruner na kujton se “Zbulimi i Jezusit të Perëndisë Atë na jep shpresë të madhe se edhe Ati [si Jezusi] do të jetë—dhe në të vërtetë, është dhe ka qenë gjithmonë—shumë, shumë i mirë.”

8. Unë marr frymëzim për këtë fjali nga një shënim fundor poetik në *The Wesley Study Bible: New Revised Standard Version*, Joel B. Green and William H. Willimon, eds. (Nashville: Abingdon Press, 2009).

qasje tek Ati. Në fakt, ta bësh këtë do të mohonte vetë Krishtin që tha këto fjalë. Jezusi nuk tha: “Unë jam një nga shumë udhët për tek Ati”. Ai nuk tha: “Ju mund të zgjidhni të më ndiqni nëse dëshironi, por ka zgjedhje të tjera që janë po aq të zbatueshme.” As nuk tha Jezusi: “Në cilëndo rrugë shpirtërore që të ecni, do të jetë në rregull me mua, për sa kohë jeni të sinqertë.” Jezusi as që la të kuptohet kurrë. Ai deklaroi qartë se Ai është udha e vetme për tek Ati.⁹

Jo shumë kohë pasi familja jonë u transferua në një qytet të ri, gruaja ime dhe unë patëm një takim në anën tjetër të qytetit. Ne drejtonim automjete të ndryshme. Meqenëse sensi i saj i drejtimit ka qenë gjithmonë më i mirë se imi, ajo udhëhoqi rrugën. Papritmas, u kapëm në trafik të dendur dhe unë e humba atë. Unë pashë atë që mendoja se ishte automjeti i saj dhe e ndoqa atë. Kur e kuptova se po ndiqja një automjet të gabuar dhe tani në një rrugë krejt tjetër, ishte tepër vonë për të arritur në takim. Thjesht u ktheva dhe shkova në shtëpi. Morali i historisë është i thjeshtë: Ju mund të jeni të sinqertë në rrugën që zgjidhni dhe njëkohësisht të jeni sinqerisht të gabuar. Fakti është, duhet më shumë se sinqeritet për të gjetur rrugën e duhur.¹⁰ Duhet e vërteta! Një person mund të jetë duke kaluar kohë të mirë në drejtimin që po shkon, por nëse është udha e gabuar, nuk ka rëndësi se sa shpejt arrin.

Pretendimi i Jezusit është rrënjësisht përfshirës, sepse të gjithë janë të ftuar të ndjekin udhën, por është rrënjësisht ekskluziv në atë se çdo udhë që një person ndjek për të gjetur të vërtetën, përfundon si në një rrugë pa krye – përveç nëse është e vetmja Udhë që i çon ata tek Perëndia i vërtetë.

Çdo person, secili prej nesh, është fajtor për marrjen e kthesës së gabuar, në aspektin shpirtëror. Si rezultat, ne e gjejmë veten larg Perëndisë. Profeti Isaia shkruan qartë: “Ne të gjithë endeshim si dele; secili prej nesh ndiqte rrugën e

9. Kjo nuk e kufizon sovranitetin e Perëndisë për të arritur me mirësi ithtarët e feve të tjera dhe traditave të besimit, të cilët mund të vdesin pa e njohur apo dëgjuar emrin e Jezusit. Zoti është gjithmonë i lirë të bëjë atë që Zoti zgjedh në mënyrë sovranë për të bërë. Unë plotësisht pres që të befasonem nga hiri në pajtimin e të gjitha gjërave.

10. Askush nuk është më i sinqertë për të vërtetën e tyre sesa kamikazët. Sidoqoftë, sinqeriteti – pavarësisht se sa i përkushtuar është njeriu për të vërtetën e tij – nuk është i mjaftueshëm nëse nuk bazohet në realitetin përfundimtar.

vet” (53.6). Apostulli Pal e përsërit këtë tek Romakët: “Të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë” (3.23). Pse? Sepse të gjithë kemi marrë rrugën e gabuar në jetë. Të gjithë kemi zgjedhur të ndjekim udhën tonë në vend që të ndjekim vullnetin dhe udhën e Perëndisë për jetën tonë.

Ungjilli (Lajmi i Mirë) është se Jezusi erdhi për njerëz si ne. Një tjetër shkruar i Ungjillit, Luka, na thotë se qëllimi i deklaruar i Jezusit është “të kërkojë dhe të shpëtojë të humburit” (19.10). Në vend që të na linte të qëndronim të pavendosur në një degëzim në rrugë ose më keq, duke ndjekur qëllimisht, tërësisht rrugën e gabuar, Jezusi erdhi për të na treguar qartë udhën e vetme për tek Perëndia, për tek vendi i ri i mbretërisë dhe për tek jeta e përjetshme.

Një komentues parafrazon fjalët e Jezusit në këtë mënyrë: “Unë, Unë jam Udhë për atje dhe Unë, Unë jam e Vërteta që do t’ju udhëheq në Rrugën për atje dhe Unë, Unë jam Jeta që do t’ju jap fuqinë të ndiqni të Vërtetën përgjatë Rrugës për atje.”¹¹ “Unë jam¹² Udhë” nuk është një grup udhëzimesh, jo një hartë rrugore, as një komplet informacionesh – Unë jam Udhë. “Unë jam e vërteta” nuk është një grup parimesh organizuese të jetës ose presupozimeve filozofike – Unë jam e Vërteta. “Unë jam jeta” nuk është një mënyrë alternative për të jetuar me një këndvështrim më optimist – Unë jam e vetmja jetë e vërtetë, mjeti unik për t’u bërë vërtet njerëzor.

Pretendimi i Jezus Krishtit se është jo vetëm një udhë, një e vërtetë dhe një jetë, por se është Biri i vërtetë dhe unik i Perëndisë, përbën themelin e krishterimit. Jo për të folur keq për sistemet e tjera të besimit, por thjesht për të thënë se ka vetëm një rrugë për tek Ati, dhe ajo është përmes Jezus Krishtit. Ai është mënyra e vetme përmes të cilit mund të shpëtohem. Siç ka theksuar Frederik Bruner (*Frederick Bruner*): “Lindja ka etje të përjetshme për “Udhën” (*Tao-n*), Perëndimi për “Të Vërtetën” (*Veritas*) dhe e gjithë bota (lindje, perëndim, veri

11. Bruner, *The Gospel of John*, 823.

12. Përmirë [ego, “Unë”] është i theksuar, duke e kthyer theksin nga një metodë në një Person. Gjithashtu duhet vënë re, dhe është theksuar shumë herë, që thëniet e Jezusit “Unë jam” tek Gjonit janë një referencë ndaj asaj që Perëndia i deklaroi Moisiut në shkurren që po digjej, “Unë jam Ai që jam” (Eksodi 3.14). “Unë jam” u bë i njohur në të gjithë shkrimet hebraike si *Yahweh*.

dhe jug) për ‘jetën (*e vërtetë*)’. Jezusi është, personalisht, të trija.”¹³

Paramendoni sikur jeni në një qytet të panjohur dhe i kërkonit dikujt udhëzime për në një vend të vështirë për t’u gjetur. Personi të cilit i keni kërkuar ndihmë mund të thotë diçka të tillë si: “Ju duhet të anoni djathtas në kryqëzimin tjetër të madh. Pastaj kaloni sheshin, kaloni kishën, qëndroni në korsinë e mesme, e cila do t’ju çojë direkt në rrugën e tretë në të djathtë, derisa të arrini në një ndalesë me katër korsi.” Edhe me udhëzime të qarta, kur rruga është e ndërlikuar, mundësitë për të bërë një kthesë të gabuar ose për të humbur janë të mëdha.

Supozoni se në vend të kësaj, personi që pyesni thotë: “E dini, nuk ka një mënyrë të lehtë për të arritur atje. Është e komplikuar nëse nuk keni qenë kurrë më parë. Thjesht më ndiqni. Më mirë akoma, eja me mua dhe unë do të të çoj atje”. Ai person jo vetëm që bëhet udhërrëfyesi juaj, por ai gjithashtu bëhet në thelb udha, dhe nuk mund të mos arrini atje ku duhet të shkoni. Kjo është ajo që Jezusi bën për ne. Ai nuk jep vetëm këshilla dhe udhëzime. Ai ecën me ne në një udhëtim hiri. Në të vërtetë, ai nuk na tregon për rrugën – Ai bëhet Udhë!

Teologu britanik dhe misiologu i njohur Lesli Njubigin, (*Lesslie Newbigin*) artikuloi fuqishëm këtë këndvështrim: “Nuk është se Ai [Jezusi] na mëson rrugën ose na udhëzon në rrugën e duhur: po të ishte kështu, ne do të mund ta falënderonim për mësimin e Tij dhe pastaj të vazhdonim rrugëtimin vetë. Ai vetë është rruga. ... Të ndjekësh këtë udhë është në fakt, e vetmja udhë për tek Ati.”¹⁴

“Luis Karol (*Lewis Carroll*), autore e një historie rreth një vajze me emrin Alis’ (Alice) dhe përvojave të saj fantastike në një vend të quajtur “Bota e Çudirave”, e cila arrin në një udhëkryq dhe i bën Macës së Çeshajer (*Cheshire*) një pyetje: “A mund të më thuash të lutem, cilën rrugë duhet të ndjek nga këtu?”

“Kjo varet shumë nga vendi ku dëshiron të shkosh”, – përgjigjet Macja.

“Nuk më intereson shumë se ku shkoj”, – u përgjigj Alisa.

13 Bruner, *The Gospel of John*, 812.

14. Lesslie Newbigin, *The Light Has Come: An Exposition of the Fourth Gospel* (Grand Rapids: Eerdmans, 1987), 181.

“Atëherë nuk ka rëndësi se cilën rrugë merr”, – tha Macja.

Ndoshta askush nuk e ka përmbledhur në mënyrë më të qartë pretendimin unik të Jezusit sesa Tomas a Kempis (*Thomas à Kempis*) në klasiken e tij devocionale, *Of the Imitation of Christ*.

Më ndiq mua! Unë jam Udhë, e Vërteta dhe Jeta! Pa Udhën, nuk mund të shkosh! Pa të Vërtetën, nuk ka njohje! Pa Jetën, nuk ka jetesë! Unë jam Udhë që duhet të ndiqni, e Vërteta që duhet ta besoni, Jeta për të cilën duhet të shpresoni. Unë jam Rrugë e paprekshme, e Vërteta e pagabueshme dhe Jeta e pafund. Unë jam Rrugë që është e drejtë, e vërteta supreme, jeta që është e vërtetë, e bekuara, jeta e pakrijuar. Nëse qëndroni në rrugën time, do ta njihni të vërtetën, e vërteta do t’ju bëjë të lirë dhe ju do të arrini jetën e përjetshme.¹⁵

Tek Jezusi, ne gjejmë Rrugën për tek Ati. Ai është rruga për në shtëpi.

Tek Jezusi, ne gjejmë të Vërtetën. Ai mishëron të vërtetën e pandryshueshme, të sigurt dhe të padyshimtë të karakterit dhe natyrës së Atit.

Tek Jezusi, ne gjejmë Jetë, jetë të bollshme, tani dhe në krijimin e ri të premtuar të Perëndisë që do të vijë.

Ky është rrugëtimi i hirit.

15. Thomas à Kempis, *Of the Imitation of Christ*, Book 3, chapter 56 (c. 1418–1427)

1

HIRI I MAHNITISHËM

Hiri është kudo.

– Xhorxhes Bernanos (Georges Bernanos)

“Amazing Grace” (“*Hiri i Mahnitshtëm*”) është një nga këngët më të njohura dhe të dashura në botë sot. Megjithëse është më shumë se dy shekuj e vjetër, ajo vazhdon të këndohet në qindra gjuhë dhe dialekte.¹ Ajo kapërcen kufijtë e racës dhe besimit, ata gjeografikë dhe të brezave. Ju nuk duhet as të jeni i krishterë për të ditur fjalët dhe për t’u prekur nga kuptimi i tyre.

Një pastor anglez me emrin Xhon Njuton (*John Newton*) e shkroi këngën. Gjatë pjesës së hershme të jetës së tij si i rritur, ai ishte kapiten i një anijeje skllevërish dhe ishte personalisht përgjegjës për sjelljen e qindra skllevërve nga Afrika Perëndimore në Britaninë e Madhe. Sidoqoftë, pas një përvoje të afërt me vdekjen gjatë një stuhie të dhunshme në det, ai pati një përvojë kthimi në besim që e ndryshoi atë rrënjësisht. Ai nuk do të ishte më kurrë i njëjti.

Jo vetëm që filloi një udhëtim të hirit me Perëndinë, por ai gjithashtu u

1. Ndërsa e shkruaj këtë ulur në një sallë pritjeje në aeroport në Johannesburg, Afrika e Jugut, unë mund të dëgjoj një nga punëtorët që e këndon atë me zë të ulët në gjuhën afrikane. Gazetari amerikan Bill Moyers (*Bill Moyers*) ishte duke marrë pjesë në një shfaqje në Qendrën Linkoln, ku publiku këndoi “Hiri i mahnitshëm”. Ai ishte aq i impresionuar nga fuqia bashkuese e këngës, mes të krishterëve dhe jo të krishterëve, sa që u frymëzua për të prodhuar një dokumentar me të njëjtin emër.

pendua thellësisht për përfshirjen e tij personale në tregëtinë e skllëvërve. Ai dha dorëheqjen nga kapiteneria, u bë një pastor anglikan dhe më vonë u bë mentor i Uilliam Uillberforce (*William Wilberforce*), i cili drejtoi fushatën për heqjen e skllavërisë në Perandorinë Britanike. Në moshën tetëdhjetë e dy vjeçare, ndërsa ishte i shtrirë dhe duke vdekur, Njutoni deklaroi: “Kujtesa ime gati më ka lënë. Por mbaj mend dy gjëra: që unë jam një mëkatar i madh dhe se Krishti është një Shpëtimtar i madh.” Nuk është çudi që ai mund të shkruante në mënyrë kaq poetike, ai kishte marrë, përjetuar dhe ishte shndërruar nga hiri i mahnitshëm.

Ky është një libër rreth hirit. Bëhet fjalë për udhëtimin e hirit me të cilin ne jemi bërë gjithnjë e më shumë në shëmbëlltyrën e Jezus Krishtit, i cili është “Rruga, e Vërteta dhe Jeta”. Hiri vjen në shumë forma, si në Shkrimet e Shenjta ashtu edhe në jetën tonë, por natyra e hirit mbetet e njëjtë. Ne e marrim atë personalisht si një dhuratë nga Perëndia dhe bashkëpunojmë me Perëndinë brenda një marrëdhënieje të ndërsjellë dhe transformuese.

Çfarë është hiri?

Çfarë është hiri i Perëndisë? Si hyn në jetën tonë, na ndikon, na ndryshon dhe na fuqizon për të jetuar jetë të ngjashme me Krishtin? Ka shumë përkufizime të hirit:

- Favori i pamerituar i Perëndisë.
- Dashuria e pamerituar e Perëndisë.
- Favori i dhënë dikujt që meriton të kundërtën.
- Shprehja absolutisht e lirë e dashurisë së Perëndisë që gjen motivin e saj të vetëm në bujarinë dhe dashamirësinë e Dhuruesit.²
- Mirësia pa kushte e Perëndisë.

Të gjitha këto përkufizime për hirin përpiqen të përshkruajnë ato aspekte të papërshkrueshme dhe mahnitëse të përgjigjes së dashur të Perëndisë ndaj njerëzimit të pamerituar. Kjo është arsyeja pse ne përdorim fjalën “i

2. Ky është një parafrazim i lirë i përkufizimit të hirit që i atribuohet dijetarit, gjuhëtarit dhe udhëheqësit, tani i ndjerë, të misioneve të Dhjatës së Re Spiros Zodhiates.

mahnitshëm”. Ajo sfidon kategoritë tona njerëzore të marrëdhënieve dhe transaksioneve.

Ata që punojnë në financa e dinë se çfarë është “grejs–periudha”. Grejs–periudhat janë dritare të vogla kohore kur një pagesë shtyhet pa gjobë. Sidoqoftë, një “grejs–periudhë” ka kushte. Zgjat vetëm për një kohë të shkurtër. Dikur ajo mbaron, dhe nëse personi ende nuk ka paguar atë që i detyrohet, do të ngarkohet me gjoba shtesë. Është falas, por nuk është pa kushte.

Hiri i Perëndisë është ndryshe. Hiri i Perëndisë vjen falas (të mos ngatërrohet me “pa kosto” – më shumë për këtë ide në fund të kapitullit) dhe është një gjë e mirë që është ashtu, sepse nuk do të mund ta përballonim gjithsesi. Ne kurrë nuk mund të paguajmë ose ta shlyejmë atë që i detyrohem Perëndisë. Është me hirin e tij që Perëndia bën për ne atë që nuk do të mund ta bënim kurrë për veten tonë. Kjo është arsyeja pse ne themi që hiri është i pamërituar. Perëndia na trajton më mirë sesa meritojmë. Është favori që na jepet kur meritojmë të kundërtën dhe që na shtrëngon të ndjekim Jezusin në një dishepullim tërësisht të përkushtuar.

Përkufizimi më i thjeshtë i hirit është “dhuratë”. Apostulli Pal huazoi fjalën e zakonshme greke për “dhuratë” ose “favor”, *charis* dhe e ndihmoi ta riimagjinonte atë si një mënyrë për të përshkruar kuptimin e gjerë të gjithçkaje që Perëndia ka bërë për ne në Jezus Krishtin (2 Korintasve 8.9; 9.15; Galatasve 2.21; Efesianëve 2.4–10).³ Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se *charis* rrjedh nga rrënja *char* – “ajo që sjell gëzim”.⁴ Kështu, veprimi i hirit i dhënë dhe i marrë ngjall gëzim dhe mirënjohje. Në atë kuptim, është e përshtatshme që marrësit e hirit të ofrojnë diçka në këmbim: falënderime dhe një jetë të shenjtëruar. Kjo nuk nënkupton që hiri hyjnor është një transaksion relativ. Dëshira (ose pritshmëria) për të kthyer favorin e mohon fuqinë e dhuratës.⁵

3. Fjala greke *charis* është përkthyer në latinisht si *gratia*, nga e cila shumë gjuhë marrin fjalën, “hir”.

4. Thomas A. Langford, *Reflections on Grace* (Eugene, OR: Cascade Books, 2007)

5. Tek *Paul and the Gift* (Grand Rapids: Eerdmans, 2015), John M. G. Barkley bën një argument të fortë se ideja e “dhuratës” si diçka e dorëzuar “falas, për asgjë” është një koncept modern perëndimor. Gjatë gjithë antikitetit, dhe madje edhe sot në shumë pjesë të botës, dhuratat

Mendimi transaksionar gjithmonë minon dhe zhvlerëson qëllimet e një dhurate.

Nëse i bëj një mikut tim një dhuratë, mund të them: “Unë dua të ta bëj këtë dhuratë si shenjë të dashurisë sime për ty.”

Përgjigja normale do të ishte që miku im të merrte dhuratën dhe thjesht të thoshte, “Faleminderit”.

Po sikur, në vend të kësaj, miku im të thoshte: “Ky është një gjest shumë i mirë nga ana jote. Sa të detyrohem?” Ata e kanë futur gjuhën e një dhurate në gjuhën e një transaksioni: Ju po bëni diçka të mirë për mua. Ta kam borxh duke u detyruar me një të tillë.

Ekziston edhe një problem tjetër me ngatërrimin e dhuratës së hirit me transaksionet që janë shpague. Kuptimi themelor i hirit është se nuk mund të bëjmë asgjë për ta bërë Perëndinë të na dojë më shumë dhe nuk ka asgjë që mund të bëjmë për ta bërë Perëndinë të na dojë më pak sesa Ai tashmë na do.⁶ Nuk ka asgjë kaq të mirë për ne që na bën të denjë ose të aftë të fitojmë dashurinë e Perëndisë dhe nuk ka asgjë kaq të keqe për ne që mund të na ndajë nga dashuria e Perëndisë, e cila është në Krishtin Jezus, Perëndinë tonë (Romakëve 8.35–39). Perëndia nuk na do sepse jemi të mirë, dhe Perëndia nuk na urren sepse jemi të këqij. Natyra thelbësore e Perëndisë është dashuria e shenjtë, që do të thotë veprim që karakterizon më plotësisht Perëndinë është hiri vetdhurues, i derdhur hyjnisht.⁷

Filip Jancei (*Philip Yancey*) e njeh këtë kur shkruan: “Hiri do të thotë që

jepen me pritshmëri të forta kthimi – qoftë edhe për të fituar diçka që do të forconte solidaritetin shoqëror. Kuptimi i Ungjillit të Dhjatës së Re për “dhuratën” e shpëtimit është se, megjithëse nuk është e merituar dhe nuk mund të fitohet, hiri lind drejtësinë dhe drejtësia lind bindjen.

6. Philip Yancey, *What's So Amazing about Grace?* (Grand Rapids: Zondervan, 1997), 70.

7. “Karakteristika më thelbësore e Perëndisë është dashuria. ‘Perëndia është dashuri,’ thotë Gjoni thjesht, por shumë thellësisht. Ne mund ta modifikojmë dashurinë e Perëndisë me fjalën ‘i shenjtë’. Megjithatë, kjo i shton pak kuptueshmërisë së Perëndisë sepse, nga natyra, dashuria e Perëndisë është e shenjtë. Modifikuesi ‘i shenjtë’ megjithatë na kujton se Perëndia është përtej nesh, ndryshe nga ne. Perëndia është i shenjtë gjithmonë i ndryshëm nga ne në natyrë. “Diane LeClerc, *Discovering Christian Holiness: The Heart of Wesleyan–Holiness Theology* (Kansas City, MO: Beacon Hill Press of Kansas City, 2010), 274.

Perëndia tashmë na do aq sa një Perëndi i pafund mund të dojë.”⁸ Meqenëse Perëndia fillimisht nuk na donte bazuar në sjelljen tonë të mirë, si mund ta bënte sjellja më e mirë që Perëndia të na donte më shumë? Në mënyrë të ngjashme, si mundet që sjellja më e keqe ta bëjë Perëndinë të na dojë më pak? Ju nuk mund të luteni më shumë, të jepni më shumë, të shërbeni më shumë ose të sakrifikoni më shumë dhe ta bëni Perëndinë të thotë: “Ajo po vepron shumë më mirë. Ajo më në fund po e kupton. Unë e dua atë më shumë tani se sa më parë”. Jo! Ju jeni të dashur ashtu siç jeni. Kur bëhet fjalë për dashurinë e Perëndisë, asgjë nuk varet nga ajo që bëni ose si silleni – jo sepse e meritoni, por sepse kjo është prirja e parë dhe e fundit e zemrës së Perëndisë.

Një krahasim i zakonshëm midis drejtësisë, mëshirës dhe hirit e thotë mirë: Drejtësia është të marrësh atë që meriton. Mëshira është të mos marrësh atë që meriton. Hiri është të marrësh atë që nuk e meriton.

Jezusi tregoi shumë shëmbëlltyra për të na ndihmuar të riimagjinojmë jetën nga pikëpamja e mbretërisë. Shëmbëlltyrat nuk ishin vetëm histori morale që janë treguar për të na treguar një mënyrë më të mirë për të jetuar. Ato na ndihmojnë të kuptojmë dhe korrigjojmë më mirë konceptin tonë për natyrën dhe zemrën e Perëndisë. Mendoni për shëmbëlltyrat e deles së humbur, monedhës së humbur dhe djemve të humbur (Luka 15).⁹ Jezusi e përshkruan Perëndinë si një bari, i cili është shumë i lumtur jo sepse nëntëdhjetë e nëntë delet ndoqën rregullat, por sepse u gjet një nga të humburat e tij. Ai e përshkruan Perëndinë si një grua që e kthen shtëpinë përmbys në kërkim të një monedhe të çmuar. Kur e gjen, ajo është aq e gëzuar sa bën një festë për të festuar me miqtë e saj. Pastaj Ai e përshkruan Perëndinë si një baba të dashur që përshkon horizontin për shenja të një djali të pabindur. Kur vë re djalin endacak “ndërsa ishte ende larg” (Luka 15.20), ai mbushet me dhembshuri dhe vrapon për ta mirëpritur në shtëpi. Të gjitha këto janë njohur për natyrën dhe

8. Yancey, *What's So Amazing about Grace?*, 70.

9. Përdorimi im i “djemve” në shumës është i qëllimshëm. Mësimi i Jezusit në këtë shëmbëlltyrë duket i qartë se të dy djemtë humbën për arsye të ndryshme – por vetëm njëri u largua nga shtëpia.

zemrën e Perëndisë. “Të gjendesh”, e kënaq zemrën e Perëndisë! Hiri kapërcen bredhjen, humbjen dhe pabesinë.

Jezusi tregoi një shëmbëlltëri tjetër për punëtorët në një vresht, punëdhënësi i të cilëve i paguan të gjithë punëtorët me të njëjtën pagë edhe pse disa punuan shumë më pak orë sesa të tjerët (Mateu 20.1–16). Kjo histori nuk ka kuptim ekonomik. Duket si një praktikë jo e mençur biznesi. Kjo lloj sjellje e pamatur nga një pronar biznesi rrezikon t’i armiqësojë punonjësit që punojnë më shumë dhe të inkurajojë përtacinë tek më pak të motivuarit. Sidoqoftë, kjo nuk është një shëmbëlltëri për praktikën më të mira të biznesit; është një shëmbëlltëri për hirin dorëhapur të Perëndisë. Hiri nuk është një ekuacion matematikor që mban një numër të orëve të punonjësve, ai ndjek parimet e duhura të kontabilitetit ose i shpërblen punëtorët më punëtorë. Hiri nuk ka të bëjë me atë se kush meriton të paguhet; bëhet fjalë për persona të padenjë të cilëve gjithsesi u jepen dhurata. Nëse kjo tingëllon skandaloze për veshët tuaj dhe qesharake për arsyen tuaj të shëndoshë, atëherë keni filluar të kuptoni hirin.

Hiri është personal

Ne mund të flasim për përvojën e hirit, sepse ai është thellësisht personal dhe ndërpersonal. Hiri është personal për dy arsye të rëndësishme. Së pari, hiri nuk është një gjë. Nuk është një gjësend. Nuk është një lëndë e shenjtë e derdhur në ne si “vaj motorik i krishterë” për të ndihmuar “motorin” tonë të dishepullimit të funksionojë në mënyrë më efikase. Hiri është personal, sepse vjen tek ne në personin e Jezus Krishtit, i cili tha: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta”.¹⁰

Tomas Langford (*Thomas Langford*), një teolog në traditën Uesliane, pohon se gjatë gjithë historisë së kishës ka pasur një luftë ndërmjet dy kuptimeve të hirit:

Nga njëra anë, hiri është menduar si diçka që Perëndia zotëron dhe mund të japë, dhe ndoshta diçka që personat mund të pranojnë dhe posedojnë;

10. Kur Ungjilli i Gjonit flet për Frymën e Shenjtë si Ngushëllues “tjetër”, kjo do të thotë që Fryma e së Vërtetës do të vazhdojë shërbesën e Jezusit të Vërtetës (14.6, 16–17).

ose, në terma më të mëdha, një lloj atmosfere, energjie ose fuqie që përfaqësojnë veprimin e Perëndisë dhe sigurojnë një kontekst rrethues për jetën njerëzore. Nga ana tjetër, hiri është identifikuar me dikë; hiri është një person, hiri është Perëndia – Perëndia i pranishëm për njerëzit. Të flasësh për hirin do të thotë të flasësh për praninë e Perëndisë dhe ndërveprimin e kujdesshëm me krijimin. Në këtë kuptim, konsideratat e hirit bazohen në reflektime mbi jetën, vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit. Jezus Krishti është hir; hiri është Jezus Krishti.¹¹

Jam i mahnitur nga fuqia e deklaratës me peshë e Diarmeid MekKullo (Diarmaid MacCulloch) në historinë e tij monumentale të krishtërit: “Një person, jo një sistem, e kapi [Palin] në ngjarjet misterioze në rrugën për në Damask.”¹² Në atë shumë mënyra, Sauli nga Tarsi – i quajtur më vonë apostulli Pal – nuk ishte i përgatitur për këtë zbulim mahnitës. Përkushtimi i tij kishte qenë ndaj një feje, një sistemi të përcaktuar, një tradite, një Ligji. Ai e njihnte atë shumë mirë. Ai ishte mbrojtësi i tij i stërvitur dhe i pasionuar, por ishte një Person që e ndryshoi atë. Ai Person ishte Jezusi nga Nazareti, të cilin Pali më vonë do ta identifikonte si Krishti dhe Zoti.

Sistemi i mëparshëm i besimit të Palit ishte respektim i plotë i Ligjit. Pas përvojës në rrugën për në Damask (Veprat e Apostujve 9.1–22), ai i pa gjërat ndryshe. Ai ende besonte se Ligji ishte i mirë, por jo i plotë. Kur takoi Personin, ai e ktheu përqendrimin e tij nga diçka e mirë, (trashëgimia e tij hebraike) te dikush pakrahasueshmërisht më i mirë: Jezus Krishti. Përmes përvojës së një takimi intim me Krishtin, ai zbuloi një drejtësi që nuk ishte e tij.¹³ Pali besonte se marrëdhënia e besimtarit me Krishtin (personin) mund të bëhej atëherë aq intime, sa që ai flet për të si “njëshmëri në Krishtin”, duke treguar bashkimin total. Njëshmëria nuk ishte një koncept abstrakt, greko–romak, Platonik për

11. Langford, *Reflections on Grace*, 18.

12. Diarmaid MacCulloch, *Christianity: The First Three Thousand Years* (New York: Penguin Books, 2009)

13. Dikaion, “të drejtësohesh” (ose në frazën e bërë të famshme nga Reforma Protestante në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, “të shfajësohesh”), tregon se ekziston një hir që vjen nga jashtë vetes tonë.

Palin. Jezus Krishti ishte (është) një qenie njerëzore e vërtetë në kohën dhe hapësirën historike të kohëve të fundit. Ai është jo vetëm si ne në natyrën e tij njerëzore, por, si Ai që Pali takoi në rrugën e Damaskut, një person i ringjallur, supernatyror, jeta, vdekja, ringjallja dhe ngjitja e të cilit përmbysën katastrofën e mëkatit dhe rënies sonë (1 Korintasve 15.22).

Në një kuptim shumë të vërtetë, ndryshimi i emrit nga Saul në Pal ishte më shumë se një kthim në besim, ishte një zgjim shpirtëror: “i ranë nga sytë disa si luspa, dhe ai fitoi përsëri të parit” (Veprat e Ap. 9.18). Ishte një rilindje. Palit iu dha një dhuratë e pastër, e papërlyer, të cilën ai nuk mund ta fitonte, as ta meritonte. Tani ai mund të shihte se ku po na drejtonte Ligji gjatë gjithë kohës, tek një person. Kjo është arsyeja pse ai më vonë do të shkruante: “por ne predikojmë Krishtin të kryqëzuar, skandal për judenjtë dhe marrëzi për grekët, kurse për ata që janë të thirrur, qofshin judenj ose grekë, predikojmë Krishtin, fuqia e Perëndisë dhe diturinë e Perëndisë” (1 Korintasve 1.23–24). Kjo ishte skandaloze për ata që ishin të lidhur me ligjin dhe traditën hebraike dhe çmenduri për ata të zhytur në kulturën elitare greke dhe botëkuptimet filozofike perëndimore. Por, për ata që mund të besonin se Jezusi ishte Krishti i Perëndisë (në greqisht, *christos* do të thotë “i vajosuri”), me hirin e Perëndisë, Ai u bë shpëtimi i tyre.¹⁴

Të krishterët e parë nuk predikuan një sistem apo madje edhe një fe. Ata shpallën një Person. Për islamin Fjala u bë një libër (Ku’ran); për krishterimin Fjala u bë mish (Gjoni 1.14).¹⁵

Një qenie njerëzore, i përjetshmi, një Perëndi u bë Person. Mishërimi. Të krishterët e parë nuk e dhanë jetën e tyre për një teori, një parim ose një forcë jetësore. Ishte për një Person dhe për shkakun e Atij Personi, një Person i vërtetë që u kryqëzua dhe u varros me të vërtetë, i cili u ringjall me të vërtetë nga të vdekurit si frytet e para të krijimit të ri, i cili me të vërtetë u ngjit në qiell dhe që

14. *Strong's Concordance of the New Testament* tregon se *charis*, “grace,” shfaqet të paktën tetëdhjetë e tetë herë në letrat e Palit drejtuar kishave të shekullit të parë.

15. I jam borxhli Daniel Gomis, Drejtor Rajonal i Kishës së Nazaretasit për Afrikën, për këtë dallim të rëndësishëm.

me të vërtetë po kthehet përsëri.

Unë nuk njoh askënd që e përshkruan këtë në mënyrë më të artikuluar sesa Ditrish Bonhofer (*Dietrich Bonhoeffer*): “Me një ide abstrakte është e mundur të hysh në një lidhje të njohurive formale, të bëhesh entuziast për Të, dhe ndoshta edhe ta zbatosh në praktikë; por kurrë nuk mund të ndiqet në bindje personale. Krishterimi pa Krishtin e gjallë është në mënyrë të pashmangshme krishterimi pa dishepullim, dhe krishterimi pa dishepullizim është gjithmonë krishterim pa Krishtin.”¹⁶

Prandaj, udhëtimi i hirit nuk ka të bëjë me ndjekjen e një sistemi, një libri, një *Udhëzuesi Përdorimi*, një emërtimi ose një tradite. Ne ndjekim, adhurojmë dhe i shërbejmë Jezus Krishtit. Hiri është rezultat i të gjitha përfitimeve të jetës, shërbesës, vdekjes, ringjalljes dhe ngjitjes së Jezusit personal, i cili tani është Krishti dhe Zoti.

Një shpjegim i hirit Krishtocentrik (me qendër Jezusin) është të mos neglizhosh një teologji hiri më të fuqishme Trinitare (Perëndia si Krijues dhe Atë; fuqia e Frymës së Shenjtë në jetën e një besimtari). Të kuptuarit e hirit si një person është të kujtojmë se gjithçka që ne njohim personalisht për Perëndinë zbulohet më qartë në jetën, mësimin dhe përvojën e personit që Perëndia zgjodhi ta bëjë të njohur vetveten. Qëllimi i të gjithë dishepullimit të krishterë është të formësojë marrësit e hirit në shëmbëlltyrën dhe shëmbëllimin e Jezus Krishtit. Hiri nuk është diçka – hiri është dikushi.

Ky pohim na çon në arsyen e dytë që hiri është personal: hiri i vjen çdo personi në përputhje me nevojën ose aftësinë e tij ose të saj të veçantë për ta pranuar atë. Çdo person në mënyrë unike merr dhe përshtat hirin.

Unë kam shumë miq, por ndërlidhem me ta në mënyra të ndryshme, sepse secili është unik. Unë kam tre fëmijë dhe ndërsa i dua të gjithë në një masë të barabartë, nuk mund t'i trajtoj të gjithë në të njëjtën mënyrë. Ata janë të gjithë të ndryshëm, kështu që qasja ime e prindërimit duhet të përshtatet për secilin. Kjo është mënyra e dashur për të qenë mik dhe për të qenë prind.

16. Dietrich Bonhoeffer, *The Cost of Discipleship* (New York: Macmillan Company, 1949), 63–64.

Po kështu, hiri përshtatet dhe merret në mënyrë unike nga çdo person, sepse ne e përfetojmë hirin në një marrëdhënie personale me Perëndinë trini, të dhënë prej Atit, të ofruar përmes Jezus Krishtit dhe të fuqizuar nga Fryma e Shenjtë. Hiri është personal, sepse vjen në një person, i personalizuar sipas nevojave tona. Ndërsa Perëndia na jep më shumë nga vetja, na jepet më shumë hir.

Hiri është i kushtueshëm

Ditrich Bonhofer na kujton se, megjithëse hiri është falas, nuk vjen pa kosto. Në një paragraf therës nga libri i tij më i njohur, *The Cost of Discipleship* (Kostoja e Dishepullimit), Bonhofer thekson ndryshimin midis hirit falas dhe hirit të kushtueshëm si mungesë e kërkesës për dishepullim të vërtetë ose një pritshmëri e tij: “Hiri falas është hiri pa dishepullim, hir pa kryq, hir pa Jezus Krishtin, i gjallë dhe i mishëruar.”¹⁷

Më tej, Bonhofer shprehet troç se hiri falas është “armiku vdekjeprurës i kishës sonë”, armiku më i hidhur i dishepullimit” dhe “ka qenë shkatërrimi i më shumë të krishterëve se çdo urdhëresë e veprave”¹⁸. Dikush mund të thotë se ata shfajësohen vetëm me anë të hirit si një dhuratë nga Perëndia, por fryti i një jete të shfajësuar është ai që ka lënë të gjitha dhe ka ndjekur Krishtin.¹⁹ Dhe arsyja, thekson me të drejtë Bonhofer, është se kur dikush dëgjon thirrjen e Jezusit për ta ndjekur atë, përgjigjja e dishepujve së pari është një akt bindjeje para se të jetë një rrëfim doktrinor i besimit (Marku 2.14).²⁰

Bonhofer vazhdon të përshkruajë se si hiri është i kushtueshëm dhe pse një dishepull i plotë dhe plotësisht i dorëzuar është e vetmja përgjigje e përshtatshme.

Hiri është i kushtueshëm, sepse na bën thirrje ta ndjekim dhe është hir, sepse na bën të ndjekim Jezus Krishtin. Është i kushtueshëm, sepse i kushton një njeriu jetën e tij dhe është hir, sepse i jep një njeriu jetën e

17. Bonhoeffer, *The Cost of Discipleship*, 47–48.

18. Bonhoeffer, *The Cost of Discipleship*, 45, 55, 59.

19. Bonhoeffer, *The Cost of Discipleship*, 47–48.

20. Bonhoeffer, *The Cost of Discipleship*, 45, 55, 59.

vetme të vërtetë. Është i kushtueshëm sepse dënon mëkatin dhe hir sepse shfajëson mëkatarin. Mbi të gjitha, është i kushtueshëm sepse i kushtoi Perëndisë jetën e Birit të Tij: “ju u bletë me një çmim”, dhe ajo që i kushtoi shumë Perëndisë nuk mund të jetë e lirë për ne. Mbi të gjitha, është hir sepse Perëndia nuk e konsideroi Birin e Tij si një çmim shumë të dashur për t’u paguar për jetën tonë, por e dorëzoi atë për ne. Hiri i kushtueshëm është Mishërimi i Perëndisë.²¹

Jeta e dishepullimit është një udhëtim hiri. Fillon me hir, fuqizohet nga hiri dhe mbushet me hir nga fillimi në fund. Nuk ka asnjë dishepull të vërtetë nëse nuk ndjekim dhe nuk i bindemi mënyrës së Jezusit. Hiri i Perëndisë mund të merret si një dhuratë falas, por nuk mund të mbetet i ndarë nga kërkesat e dishepullimit.

Hiri është i mahnitshëm

Filip Jancej (*Philip Yancey*) rrëfen një skenë nga filmi *Last Emperor*, i djalit të ri të vajosur si perandori i fundit i Kinës. Ai jeton një jetë luksoze me shumë shërbëtorë nën urdhërat e tij.

“Çfarë ndodh kur gabon?” pyet vëllai i tij.

“Kur bëj keq, dikush tjetër dënohet”, përgjigjet djali perandor. Për të demonstruar, perandori djalë thyen një objekt të çmuar dhe një nga shërbëtorët rrihet për shkeljen.²²

Ky ishte zakoni i lashtë i mbretërve dhe perandorëve. Nuk ishte as e drejtë dhe as e mëshirshme. Pastaj dikush erdhi nga një botë tjetër. Ai ishte një Mbret që solli kuptim të ri në konceptin e autoritetit. Ai përmbysi rendin e vjetër dhe përuroi një mbretëri të re. Kur shërbëtorët e Tij bien në mëkat, ky Mbret merr atë që të tjerët me të drejtë e meritojnë. Jancej reflekton, “Hiri është falas vetëm sepse vetë dhënësi e ka bartur koston.”²³

Kjo nuk është drejtësi ose mëshirë – ky është hir. Hir i kushtueshëm.

21. Bonhoeffer, *The Cost of Discipleship*, 47–48.

22. Yancey, *What’s So Amazing About Grace?*, 67.

23. Yancey, *What’s So Amazing About Grace?*, 67.

Ndoshta kjo është arsyeja pse ne ende na pëlqen ta këndojmë këngën e Njutonit. Hiri është i mahnitshëm.

Atëherë, si vepron hiri dorëlëshuar i Perëndisë në jetën tonë të përditshme? Është një gjë të dish se çfarë do të thotë hir. Është mirë të dimë që Perëndia na do ashtu, por çfarë ndryshimi bën në jetën time? Si duket hiri kur e shoh? Çfarë bën hiri kur e përjetoj? Çfarë ndryshimi bën hiri në jetën time të përditshme?

Hiri përjetohet në mënyra shumëtiparësh, ngjyrosëse dhe të ndryshme. Pjesa tjetër e këtij libri do të shqyrtojë shprehjet e shumëfishta të udhëtimit të hirit.



RRUGA

Përmes kërkimit të hirit (i quajtur edhe hiri paraprirës), Perëndia shkon para nesh për të krijuar një rrugë dhe për të na tërhequr në marrëdhënie.

2 HIRI QË NA KËRKON

Sepse Biri i njeriut erdhi të kërkojë dhe të shpëtojë atë që kishte humbur.

Luka 19.10

Dishepullimi është i ngjashëm me një bindje të gjatë në të njëjtin drejtim, me Jezusin si udhëzuesin dhe shokun tonë.¹ Ne e quajmë këtë një udhëtim hiri. Udhëtimi i hirit është gjithmonë dinamik, sepse është relativ në thelb. Të ecësh me anë të besimit është më shumë aventurë sesa punë e rëndë, më shumë kënaqësi se detyrë, në çdo hap të rrugëtimit të dishepullimit të zhytur në hirin e Perëndisë. Ne e përjetojmë hirin e Perëndisë në mënyra të ndryshme, nëpër stinë të ndryshme të jetës sonë. Ndërsa këto aspekte të hirit nuk janë gjithmonë vijuese (të ndjekin një rend specifik), ato diferencohen sipas qëllimeve të ndryshme që përmbushin në udhëtimet tona të dishepullimit.²

1. Pjesë të këtij kapitulli janë përfshirë dhe përshtatur nga kapitulli i autorit të titulluar “The Grace That Goes Before: Prevenient Grace in the Wesleyan Spirit,” by David A. Busic, in Wesleyan Foundations for Evangelism, ed. by Al Truesdale (Kansas City, MO: The Foundry Publishing, 2020). Used by permission. Fraza “një bindje e gjatë në të njëjtin drejtim” është huazuar nga një libër mbi dishepullimin i shkruar nga pastori-teolog Juxhin Peterson, *A Long Obedience in the Same Direction: Discipleship in an Instant Society* (Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 1980).
2. Ndërsa hiri mund të mos përjetohej në mënyrë të njëpasnjëshme, teologët i referohen një rendi shpëtimi (*ordo salutis*). Sidoqoftë, Diane LeKlerk e bën një argument të rëndësishëm: “Meqenëse kjo shpesh konsiderohet si një seri hapash në jetën e krishterë, disa studiues preferojnë *via salutis*, ose udha e shpëtimit, të theksojnë rrjedhshmërinë e një faze në një tjetër.” Në *Discovering Christian Holiness: The Heart of Wesleyan-Holiness Theology* (Kansas City,

Janë të paktën pesë motive të shkrimeve të shenjta që përshkruajnë se si e përjetojmë hirin e Perëndisë. Kjo nuk do të thotë se ka klasifikime të ndryshme të hirit, sikur hiri të mund të zbërthehej në matës ose lloje të ndryshme kategorike.³ Siç thekson Xhek Xhekson (*Jack Jackson*), “hiri i Perëndisë është njëjës”⁴, ose nga Xhon Uesli, hiri i Perëndisë është thjesht “dashuria e Perëndisë”⁵. Për të shmangur këtë prirje për të klasifikuar lloje të ndryshme të hirit, Uesli zgjodhi të përqendrohej në natyrën përjetuese të hirit: “Në varësi të fazës së tyre të dishepullimit, njerëzit e përjetojnë hirin e Perëndisë ndryshe. Ata që janë në gjendjen e natyrës (para se të njohin Krishtin) përjetojnë hirin në mënyrë parandaluese; sapo të zgjohen, ata përjetojnë hirin në një mënyrë bindëse dhe shfajësuese; dhe pastaj më në fund pasi të shfajësohen, ata përjetojnë hirin duke punuar për të shenjtëruar mendjet dhe zemrat e tyre.”⁶ Përshkrimi i Xheksonit për teologjinë e Ueslit është shkruar bukur logjikisht, por edhe fleksibël, duke bërë dallimin midis hirit si një gjë dhe hirit si një rrugëtim ndërpersonal, që përfshin rrethanat dhe përvojat e jetës, takimet hyjnore dhe kohën providenciale. Hiri është një person dhe shtrihet në mënyra personale.

Me këtë në mendje, ne ofrojmë motivet e mëposhtme për të na ndihmuar të kuptojmë më mirë sesi shpesh përjetojmë dashurinë e Perëndisë në udhëtimin e hirit, duke pranuar që këto nuk janë lloje të ndryshme hiri, por që këto janë mënyrat e ndryshme që ne mund ta përjetojmë Perëndinë si Hir i Personifikuar

MO: Beacon Hill Press of Kansas City, 2010), 315.

3. Kjo ishte një pikë kryesore në kapitullin e fundit. Hiri nuk është një gjë – hiri është një person dhe personal. Tom Nobël (*Tom Noble*) sugjeron prirjen e trajtimit të hirit si një forcë ose përbërës objektiv që erdhi nga augustinianizmi mesjetar. Lloje të ndryshme hiri u shfaqën që mund të futeshin te të krishterët. Prireja u zgjerua në skolasticizmin protestant të shekullit XVII. “Ai model skolasik i hirit sjell problemet e veta, veçanërisht një tendencë për të depersonalizuar veprimin e Perëndisë, duke zëvendësuar veprimin personal të Frymës me këtë përmbajtës jopersonal të quajtur ‘hir’.” TA Noble, *Holy Trinity: Holy People: the Holy of Theology of Christian Perfecting* (Eugene, OR: Cascade Books, 2013), 100.
4. Jack Jackson, *Offering Christ: John Wesley's Evangelistic Vision* (Nashville: Kingswood Books, 2017), 53.
5. John Wesley, Sermon 110, “Free Grace,” *Sermons III: 71–114*, vol. 3 in *The Bicentennial Edition of the Works of John Wesley* (Nashville: Abingdon Press, 1986), 3.544, par. 1.
6. Jackson, *Offering Christ*, 53.

gjatë gjithë jetës sonë.⁷

- Hirin që na Kërkon
- Hiri Shpëtues
- Hiri Shenjtërues
- Hiri që na Mban
- Hiri i Mjaftueshëm

Në kapitujt që pasojnë, ne do të shqyrtojmë secilin prej këtyre motiveve në detaje biblikisht, teologjikisht dhe eksperimentalisht. Ne fillojmë këtu me hirin që na kërkon.

Hiri që na paraprin

Hiri i Perëndisë nuk fillon në momentin e shpëtimit tonë. Ai i paraprin edhe vetëdijes për nevojën tonë për Perëndinë. Ne nuk e kërkojmë Perëndinë natyrshëm; përkundrazi, Perëndia na kërkon neve. Termi teologjik për këtë veprim me të cilin Perëndia kërkon të na afrojë më shumë me Vetën, është hiri paraprirës. Hiri paraprirës thjesht do të thotë që Perëndia vjen tek ne para se ne të vijmë tek Perëndia. Hiri i Perëndisë na kërkon dhe vjen aty ku jemi.

Të krishterët nganjëherë do të fillojnë një dëshmi të përvojës së tyre të kthimit në besim me një thënie se si ata “erdhën tek Krishti” në një vend ose moshë të caktuar. Këto janë përpjekje të mirëfillta për të rrëfyer një kohë dhe vend specifik kur ata kishin një ballafaqim me Perëndinë dhe përjetuan një lindje të re në Krishtin. Sidoqoftë, formulimi “erdha te Krishti” nuk është aq i saktë, sepse askush nuk vjen kurrë tek Jezus Krishti. Jezus Krishti vjen tek ne. Në një letër shumë të rëndësishme, të shkruar për të krishterët e parë johebrej, apostulli Pal thotë: “Ai ju dha jetë edhe juve, që ishit të vdekur në

7. Pas kuptimit të Uilliam Grejthaus (*William Greathouse*) dhe H. Rej Daning (*H. Ray Dunning*) për “shpëtimin” si një term teologjik që ka ngjyrimë të gjera: “[Shpëtimi] përfshin tërë veprën e Perëndisë drejtuar drejt rivendosjes së njeriut në pasurinë e tij të humbur. Duke filluar me shpëtimin fillestar, ai përfshin të gjitha aspektet e këtij restaurimi deri dhe duke përfshirë shpëtimin përfundimtar ose ‘përlëvdimin’.” William M. Greathouse and H. Ray Dunning, *An Introduction to Wesleyan Theology* (Kansas City, MO: Beacon Hill Press i Kansas City, 1982), 75. Më tej, Grejthaus dhe Daning shpjegojnë se shpëtimi nuk ndodhet në një ngjarje apo përvojë të veçantë: “Dhjata e Re flet për shpëtimin në tri kohë: e kaluara (ka qenë), e tashmja (është) dhe e ardhmja (do të jetë).”

faje dhe në mëkate, në të cilat keni ecur dikur, sipas ecjes së kësaj bote, sipas prijësit të pushtetit të erës, sipas frymës që vepron tani në bijtë e mosbindjes. Por Perëndia, që është i pasur në mëshirë, për shkak të dashurisë së Tij të madhe me të cilën na deshi, edhe atëherë kur ishim të vdekur në faje, na dha jetë me Krishtin (ju jeni të shpëtuar me anë të hirit)” (Efesianëve 2.1–2, 4– 5). Vëreni me kujdes një fjalë që Pali e përsërit për theks të veçantë: të vdekur. Pali e merr këtë shumë seriozisht. Ai nuk thotë se ne ishim “të sëmurë” në mëkatet tona ose “të bllokuar” në mëkatet tona. Jo, ne ishim të vdekur në mëkatet tona.

Sipas Biblës, ekzistojnë tri lloje të vdekjes: fizike, shpirtërore dhe të përjetshme. Pali po përshkruan vdekjen shpirtërore. Ne po jetonim dhe merrnim frymë dhe po bënim sikur po jetonim, por ishim shpirtërisht të vdekur për shkak të mëkatit. Një person mund të jetë fizikisht i gjallë dhe të ecë vërdallë, por nga brenda, ai nuk mund t’u përgjigjet gjërave shpirtërore, sepse nuk ka ndjesi shpirtërore. Kjo është arsyeja pse dikush që ka vdekur shpirtërisht nuk lidhet me të vërtetën shpirtërore. Për të nuk është më reale sesa shqisa e nuhatjes për një person të vdekur. Njerëzit e vdekur nuk reagojnë, janë të shkëputur nga të tjerët dhe të pavetëdijshëm për gjërat që i rrethojnë.

Pali thotë se ne të gjithë ishim në këtë gjendje të ngjashme me zombit e të vdekurve që ecin. Meqenëse të vdekurit nuk mund t’u përgjigjen stimujve të jashtëm, asnjë person i vdekur shpirtërisht nuk mund të “vijë tek Krishti” me forcën e tij ose të saj. Ndiham duhet të vijë nga jashtë. Prandaj, sipas Palit dhe dëshmitarëve të tjerë të shkrimeve të shenjta, Perëndia ndërhyr në situatën tonë të dëshpëruar dhe bën diçka për ne që ne nuk mund ta bëjmë për veten tonë: Perëndia vjen atje ku jemi ne. Me fuqinë e Frymës së Shenjtë, Perëndia lëviz drejt nesh dhe zgjon ndjeshmëritë tona shpirtërore. Ky realitet çon në një mendim të thellë: Edhe aftësia jonë për t’i thënë jo nxitjeve të Perëndisë janë bërë të mundshme vetëm sepse hiri paraprirës i Perëndisë tashmë na ka takuar. Ne jemi të lirë t’i përgjigjemi Perëndisë, sepse Perëndia e ka liruar vetëdijen tonë shpirtërore për ta bërë këtë. Një lëvizje e hirit mbi ne paraprin çdo përgjigje ndaj Perëndisë.

“Bukuroshja e Fjetur” është një përrallë e famshme për një princeshë e cila është nën mallkimin magjepsës të një mbretëreshe të keqe. Princesha mbetet në një gjendje të përhershme gjumi, dhe e vetmja mënyrë se si mund të zgjohet, është nëse princi i saj vjen dhe e puth atë. Kjo puthje do ta zgjojë atë nga gjendja e komës dhe do ta shpëtojë nga situata e saj e pashpresë. Megjithatë është vetëm një përrallë, është simbolike se si funksionon hiri paraprirës. Bibla thotë se çdo shpirt njerëzor është në një lloj gjumi të vdekjes shpirtërore dhe se ne jemi të paafte ta sjellim veten në vetëdijen shpirtërore. Pastaj Princi vjen dhe na puth, magjia është thyer dhe ne jemi zgjuar për realitete të reja, të panjohura më parë. Ashtu si babai i sëmurë nga dashuria i Lukës 15, vrapon tek djali i tij i mbuluar me turp në fund të rrugës, ashtu edhe kjo puthje përfaqëson një hir paraprirës. Lexoni përsëri këto fjalë nga shëmbëlltyra prekëse përmes syve të hirit paraprirës: “U çua pra dhe shkoi tek i ati. Por kur ishte ende larg, i ati e pa dhe pati dhembshuri; u lëshua me vrap, ra mbi qafën e tij dhe e puthi, ‘sepse ky biri im kishte vdekur dhe u kthye në jetë, kishte humbur dhe u gjet përsëri’. Dhe filluan të bënin një festë të madhe.” (Luka 15.20, 24).

Xhon Uesli dhe hiri paraprirës

Paraardhësi ynë teologjik Xhon Uesli kishte shumë për të thënë në lidhje me hirin paraprirës. Ndërsa ai nuk besonte se dishepullimi aktual nuk fillon deri pas kthimit në besim, ai i qëndroi asaj se hiri i Perëndisë funksionon paraprakisht, duke ngjallur tek njerëzit dëshirën për të filluar ta ndjekin Perëndinë, dëshirë e cila shënjon fillimin e zgjimit.⁸ Ne e kërkojmë Perëndinë, sepse Perëndia po na kërkon neve së pari.

Xhon Uesli nuk ishte i pari që përqafoi idenë e fuqisë së hirit paraprirës të ofruar tek të gjithë njerëzit, por ai sigurisht shtoi dallimin e tij në rendin e shpëtimit.⁹ Ndonjëherë, duke iu referuar atij si “hiri paraprirës”, Uesli besonte se që nga lindja, hiri i Perëndisë është aktiv tek të gjithë personat, duke kërkuar

8. Jackson, *Offering Christ*, 43–44. See also Randy Maddox, *Responsible Grace: John Wesley's Practical Theology* (Nashville: Kingswood, 1994), 8.

9. Në traditën katolike, “hiri i ekzistues” ndahet në dy pjesë: “hiri veprues paraprirës” dhe “hiri bashkëpunues pasues”.

t'i tërheqë ata drejt jetës së përjetshme në Jezus Krishtin. Kjo është e vërtetë edhe nëse ata kurrë nuk kanë dëgjuar ungjillin t'u shpallet. Prania dhe veprimi paraprirës i Perëndisë përmes Shpirtit të Shenjtë, është hiri që “na paraprin” para se ta kemi dëgjuar lajmin e mirë, zgjimit shpirtëror dhe kthimit në besim.

Asnjë person nuk është i panjohur ndaj hirit të Perëndisë dhe të gjithë janë objekt i ardhjes rrotull të Frymës së Jezusit. Si qenie njerëzore të rëna, “të vdekur në fajet dhe mëkatet tona” (Efesianëve 2.1), ne jemi bërë të paafte për të ardhur tek Perëndia me forcën tonë. Prandaj, Perëndia është gjithmonë i pari në skenën e të gjithë zgjimit shpirtëror, kthimit në besim dhe transformimit të jetës. Ne e quajmë veprimtarinë fillestare të Shpirtit të Shenjtë “paraprirëse,” sepse ajo gjithmonë i paraprin përgjigjes sonë. Dikush mund të besojë në Jezus Krishtin, por askush nuk “vjen tek Krishti” nëse Perëndia nuk e tërheq dhe ta aftësojë atë më parë. Jezusi u tha dishepujve të Tij se kjo do të ishte vepër e Frymës të Shenjtë (Gjoni 16.5–15; shih gjithashtu Gjoni 6.44).

Siç thotë Lovet Weems (*Loveet Weems*), “Perëndia na kërkon përpara se ne ta kërkojmë ndonjëherë Perëndinë. Nisma e shpëtimit është me Perëndinë që nga fillimi. Para se të hedhim ndonjëherë një hap, Perëndia është aty.”¹⁰ Hiri nuk është i parezistueshëm, por asnjë person nuk mbetet pa ftesën e një marrëdhënieje personale me Perëndinë. Ajo çka do të thotë kjo, për ata që janë në traditën e shenjtërisë uestiane është që, kur ndajmë ungjillin me dikë, ne kurrë nuk hasim një kontekst moralisht neutral. Nuk ka asnjë person që takojmë, i cili nuk është prekur nga hiri paraprirës. Sigurisht, disa do të jenë më kundërshtues ose më përgjegjës se të tjerët, por ne mund të jemi të sigurt se Perëndia ka qenë besnikërisht aktiv në jetën e tyre, shumë më përpara se të mbërrijmë në skenë. Princi ka paraprirë hyrjen tonë në skenën e tyre të jetës.

Oferta e shpëtimit e Perëndisë nuk është shtrënguese. Për nga natyra, dashuria reciproke (baza e marrëdhënieve të vërtetë) kërkon lirinë për të pranuar ose refuzuar dashurinë e ofruar. Sidoqoftë, hiri paraprirës i paraprin përgjigjes sonë dhe mundëson përgjigjen tonë. Ky është rendi i shpengimit dhe fillimi

10. Lovett H. Weems, Jr., *John Wesley's Message Today* (Nashville: Abingdon Press, 1991), 23.

i dishepullimit. Perëndia inicon; ne përgjigjemi. Hiri shkon gjithmonë i pari.

Ta ushtrojmë atë që Perëndia po bën në ne

E gjithë Dhjata e Re dëshmon dhe shkrimet e apostullit Pal theksojnë veçanërisht se “kur një person ka besuar në Jezusin si Perëndia i ringjallur, ajo ngjarje është në vetvete një shenjë e Frymës që është duke punuar përmes ungjillit, dhe se nëse Fryma ka filluar atë ‘punë të mirë’, fryti i parë i të cilit është ai besim, ju mund të besoni se Fryma do ta përfundojë punën.”¹¹ “Sidoqoftë, kjo siguri nuk e mohon rëndësinë e pjesëmarrjes njerëzore. Marrëdhënia përfshin bashkëpunim.”

Pali thekson se kush e fillon dhe e mbaron udhëtimin e hirit: “duke qenë i bindur për këtë, se Ai që nisi një punë të mirë në ju, do ta përfundojë deri në ditën e Jezus Krishtit.” (Filipianëve 1.6).¹² Për më tepër, si dishepull (dhe kishë) e Jezusit, ju duhet të “punoni për shpëtimin tuaj me frikë e me dridhje, sepse Perëndia është Ai që vepron në ju vullnetin dhe veprimtarinë, sipas pëlqimit të Tij.” (2.12–13).¹³ Me hir, ne duhet ta tregojmë me vepra në botë atë që Perëndia po vepron në ne. Shembuj të dobishëm biblik ka me bollëk.

Perëndia erdhi tek Abrahami në një vend të quajtur Ur i Kaldeasve (tani i quajtur Iran). Perëndia nisi thirrjen: “Unë do të bëj prej teje një komb të madh dhe do të të bekoj dhe do ta bëj të madh emrin tënd, në mënyrë që të jesh një bekim” (Zanafilla 12.2). Kush shkoi i pari? Perëndia shkoi.

Kush e filloi punën e mirë tek Abrahami? Perëndia e filloi. Sidoqoftë, Abrahamit iu desh të përgjigjej me bindje për të ushtruar në botë atë që Perëndia po bënte në të. Perëndia erdhi tek Jakobi në një ëndërr duke zbuluar një shkallë drejt qiellit (Zanafilla 28.10–22) dhe më vonë bëri mundje me Jakobin në lumin Jabok (32.22–32). Kush shkoi i pari? Perëndia shkoi. Kush e filloi punën e mirë në Jakobin? Perëndia e filloi. Sidoqoftë, Jakobit iu desh të ushtronte atë që Perëndia po bënte në të.

11. N. T. Wright, *Paul: A Biography* (San Francisco: HarperOne, 2018), 96.

12. Vini re se Perëndia është si nismëtar, ashtu edhe krijues i rrugëtimit të hirit.

13. E kam shtuar “kishë” këtu sepse fjala “ju” është në shumës.

Moisiu ishte në një vend shumë të largët. Perëndia erdhi tek ai përmes një ferrishteje që digjej dhe e thirri atë për të shpëtuar popullin e Tij nga skllavëria në Egjipt (Eksodi 3.1–4.17). Kush shkoi i pari? Perëndia shkoi. Kush e filloi punën e mirë në Moisiun? Perëndia e filloi. Sidoqoftë, Moisiut iu desh të ushtronte atë që Perëndia po bënte në të.

Krishti i gjallë iu shfaq Saulit (ose e sulmoi atë) në rrugën për në Damask (Veprat e Apostujve 9.1–19). Sauli nuk po e kërkonte Perëndinë. Ai ishte në një mision për të përndjekur të krishterët. Kush shkoi i pari? Perëndia shkoi. Kush e filloi punën e mirë në Saulin (i cili shpejt u bë Pali, misionar i johebrenjve)? Perëndia e filloi. Sidoqoftë, siç do të thoshte Pali më vonë në letrën e tij drejtuar kishës në Filipi, ai duhej të ushtronte atë që Perëndia po bënte në të.

Eunuku nga Afrika në një rrugë të shkretë në Jude (Veprat e Apostujve 8), Korneli përmes një vegimi në tre të pasdites (Veprat e Apostujve 10), Lidia buzë lumit (Veprat e Apostujve 16) çfarë kanë të përbashkët të gjithë këta? Këto dhe shumë histori të tjera si këto tregojnë se njerëzit i përgjigjen me besim Perëndisë që erdhi për herë të parë tek ata. Të gjithë ata po ushtronin atë që Perëndia po bënte në ta.

Ekziston një model i qëndrueshëm i Perëndisë që vepron me hir paraprirës dhe njerëzit që përgjigjen me besim. Misiologu britanik Lesli Njubigin tha në mënyrë të famshme, “Besimi është dora që kap punën e përfunduar të Krishtit dhe e bën timen.” Kjo nuk heq nevojën për një përgjigje, por hiri paraprirës është gjithmonë i pari. Edhe Augustini, i cili ishte një ithtar i palëkundur i paracaktimit, pohoi: “Ai që na bëri pa veten tonë, nuk do të na shpëtojë pa veten tonë.”¹⁴

Providenca dhe paraprirja

Ekziston një ndryshim midis hirit providencial dhe hirit paraprirës. Providenca është mënyra sesi Perëndia siguron ushqimin dhe furnizimin

14. Quoted in John Wesley, *The Works of the Rev. John Wesley* (Kansas City, MO: Nazarene Publishing House, n.d.; and Grand Rapids: Zondervan Publishing House, 1958, concurrent editions), VI, 513.

e krijimit të Tij, duke përfshirë qëniet njerëzore¹⁵. Perëndia “siguron”, ose “kujdeset për” (Zanafilla 22.8, 14) atë që nevojitet për të mbështetur botën dhe për të siguruar për secilin person.

Se si providenca e Perëndisë kryqëzon jetën e çdo personi, është thellësisht misterioze. Kur dhe ku dhe në çfarë familje lind një njeri është çështje e providencës. Pse një person ka lindur në një familje hinduiste në Indi në vitin 1765, ndërsa një person tjetër ka lindur në një familje të krishterë në Mozambik në vitin 2020, janë çështje providence. Providenca e Perëndisë mbart shkallë të ndryshme të përgjegjësisë shpirtërore. Atij që i është dhënë mundësia të dëgjojë ungjillin gjatë gjithë jetës së tij, do të gjykohet ndryshe nga ai që nuk e ka dëgjuar kurrë emrin e Jezusit. Shëmbëlltyra e Jezusit për shërbëtorin besnik dhe të mençur, ka të bëjë me shumë sesa për pasuritë materiale, përfshin administrimin e hirit të Perëndisë. “Kujt iu dha shumë, do t’i kërkohet shumë; dhe kujt iu besua shumë, do t’i kërkohet më shumë”(Luka 12.48). Jo të gjithëve u është dhënë mundësia e barabartë dhe i njëjti terren mbi të cilin mund të qëndrojnë. Disave i është dhënë më shumë dhe disave më pak. Me dhuratën e “më shumë” vjen një kërkesë e shtuar për përgjigje. Këto janë çështje të providencës hyjnore.

Nëse providenca është vendi ku Perëndia na vendos, paraprirja përshkruan mënyrat shumëtiparësh që Perëndia na plotëson. Të gjithë marrin të njëjtin hir që i paraprin shpëtimit. Sidoqoftë, mundësitë për përgjigje ndryshojnë. Perëndia me këmbëngulje dhe me durim i ofrohet të gjithëve. Ky besim e dallon krishtërimin nga fetë e tjera të botës që mësojnë se Perëndia do të përgjigjet nëse njerëzit së pari lëvizin drejt Perëndisë. Krishtërimi e përmbys rendin: Perëndia vepron gjithmonë i pari, duke mundësuar kështu përgjigjen.

Perëndia fillon punën e mirë të hirit dhe të paqes. Shpengimi dhe krijimi i ri gjithmonë fillojnë me iniciativën e Perëndisë. Asgjë nuk e zbulon këtë

15. Fjala “providencë” vjen nga dy fjalë latine: *pro*, që do të thotë “përpara” ose “në emër të;” dhe, *videre*, që do të thotë “të shohësh”. Providenca nganjëherë ndahet në dy kategori: “providencë e përgjithshme”, kujdesi i Perëndisë për universin; dhe “providencë e veçantë”, ndërhyrja e Perëndisë në jetën e njerëzve.

më shumë sesa bindja se Ati dërgoi Jezus Krishtin në botë. Perëndia vepron gjithmonë i pari. Fryma e Shenjtë i Perëndisë i zgjon njerëzit për nevojën e tyre për shpëtim, i bind për mëkatin dhe zbaton shlyerjen e Krishtit, ndërsa ata përgjigjen me besim.

Për Xhon Ueslin, zgjimi shpirtëror është më shumë sesa thjesht ndërgjegje: “Nuk ka njeri, përveç nëse e ka shuar Frymën, të cilit i mungon plotësisht hiri i Perëndisë. Asnjë njeri që jeton nuk i mungon plotësisht ajo që në mënyrë vulgare quhet ndërgjegje natyrore. Çdo njeri ka një farë mase të asaj drite,... i cili ndriçon çdo njeri që vjen në botë. Dhe secili... ndihet pak a shumë i shqetësuar kur vepron në kundërshtim me dritën e ndërgjegjes së tij. Kështu që, askush nuk mëkaton sepse nuk ka hir, por sepse nuk e përdor hirin që ka.”¹⁶ Një ndërgjegje e shqetësuar, rritja e vetëdijes për të drejtën dhe të gabuarën, dhe zgjimi i vetëdijes shpirtërore janë dhuratat e hirshme të Perëndisë për të gjithë. Ky besim ka implikime të rëndësishme për ungjillizimin në frymën Uesliane.

Hiri paraprirës dhe ungjillizimi

Një herë u takova me një grup pastorësh të krishterë që jetojnë në një vend ku është e vështirë të jesh ndjekës i Krishtit. Është e ligjshme të jesh i krishterë, por ka ligje të rrepta kombëtare kundër prozelitizimit nga një besim në tjetrin. Ungjillizimi i krishterë i tepërt dënohet ashpër me burgim dhe madje me vdekje. I pyeta pastorët se si ndodh ungjillizimi në një mjedis kaq armiqësor dhe të rrezikshëm. Pas disa çastesh heshtjeje, një pastor u përgjigj, “ëndrra”. Nuk e kuptova, prandaj i kërkoja të më shpjegonte. “Jo dhjetra, por qindra fqinjë tanë po shohin ëndrra natën. Krishti i ringjallur iu shfaqet atyre me gjithë bukurinë dhe madhësitinë e Tij. Kur zgjohen, ata vijnë duke bërë pyetje. ‘Na tregoni për këtë njeri që vjen tek ne natën.’ Kur ata pyesin, është detyrimi ynë të përgjigjemi. Ne nuk po ungjillëzojmë. Ne thjesht po japim prova nga përvoja jonë për të shpjeguar përvojat e tyre. Shumë prej tyre po ia dorëzojnë jetën e tyre Krishtit në atë mënyrë.”

Në vendet ku kisha përballet me dyer të mbyllura, Fryma e Perëndisë

16. Wesley, *Works*, VI, 512.

po shkon para nesh. Hiri paraprirës i Perëndisë nuk njihet ose pengesa. Dashuria ndaj Perëndisë arrin pa pushim edhe tek personat më të vështirë, kundërshtues dhe armiqësorë. Ata mund të mos përgjigjen kurrë me besim të bindur, por nuk mund t'i shpëtojnë pranisë përhapëse të Perëndisë, i cili nuk do të ndalet së dashuruari dhe tërhequri ata.

Kjo ka qenë historia e përsëritur e *Filmit Jezus*. Ky film rrëfen në mënyrë dramatike jetën e Krishtit. Ka qenë një instrument i efektshëm i hirit në jetën e mijëra, mijëra njerëzve nëpër gjithë botën. U është treguar njerëzve në zona të largëta ku emri i Jezusit nuk është folur kurrë. Një histori tregon për kreun e një fisi që u ngrit gjatë një shfaqjeje dhe tha: “Ndal! Ne e njohim këtë njeri! Ai iu shfaq paraardhësve tanë shumë vite më parë dhe ua zbuloi këtë histori të shpëtimit. Ai tha se një ditë dikush do të vinte të na tregonte emrin e Tij. Dhe tani e dimë që emri i Tij është Jezus”. Ndërsa ky është vetëm një shembull i historive të tjera të ngjashme, ai tregon se Fryma e Perëndisë është shumë përpara kishës, siç ndodh gjithmonë. Fryma e Shenjtë kishte kultivuar tokën e zemrave të njerëzve për të marrë ungjillin. Hiri paraprirës kryqëzohej me projektimin providencial të Perëndisë shumë përpara se të vinte kisha për të shpallur lajmin e mirë. Si rezultat, shpesh një fis i tërë vendos besimin e tij tek Krishti.

Ungjillizimi i krishterë nuk është një veprim i vetëm dhe as një moment i vetmuar. Ndodh në ndërveprimet relacionale të nxitura nga Fryma e Shenjtë, i cili gjithmonë në mënyrë të hirshme na paraprin. Asnjë i krishterë nuk mund të shikojë në pasqyrën e pasme të jetës dhe të mos shohë mënyrat e mrekullueshme që Perëndia ka vepruar për t'i zgjuar dhe për t'i sjellë ata në pendim dhe në besim në Krishtin Jezus.

Babai im u bë i krishterë si adoleshent i ri përmes prindërve nazaretas. Unë u bëra i krishterë përmes shembullit të prindërve birësues të krishterë dhe një grupi burrash që takoheshin me besnikëri çdo të mërkurë në mëngjes për t'u lutur posaçërisht për shpëtimin tim. Udhëtimi juaj i hirit është unik për ju. Ajo që mbetet e njëjtë për të gjithë është se Perëndia gjithmonë na paraprin.

Miku im, Stefani ishte një ateist që vijonte një universitet në Gjermani, ku po studionte shkencën robotike. Xhaxhai i tij ateist i tregoi për një film të quajtur *The Mission*. Ai e inkurajoi atë që të shikonte filmin për shkak të “aktrimit të tij të patëmetë dhe peisazheve të bukura”. Filmi është vendosur në shekullin XVIII, në xhunglat veri-lindore të Argjentinës. Një mision spanjoll jezuit është themeluar për të arritur fiset autoktone guarani për Krishtin.

Stefani e mori filmin me qira. Ai u prek veçanërisht nga një skenë ku një tregëtar skllëvërisht dhe mercenari me emrin Rodrigo Mendoza ngjitet në një ujëvarë të pjerrët malore. Të lidhura në kurriz janë mjetet e tij të punës, armatimi dhe shpatat e tij. Ai po pendohet për mëkatet e tij të shumta. Ndërsa Mendoza arrin në majë të greminës, një luftëtar nga fisi që Mendoza e kishte rrëmbyer dhe shitur në skllavëri u hodh drejt tij, duke mbajtur një thikë si për t’i prerë fytyrën Mendozës. Pasi hezitoi një moment, anëtar i fisit i preu litarin nga shpatullat e Mendozës dhe ngarkesa e rëndë ra në fund të ujëvarës. Mendoza është papritmas i vetëdijshëm se diçka e ka ndryshuar këtë luftëtar të ri nga etja për hakmarrje në vullnetin për të treguar mëshirë.

I lodhur dhe i mbuluar me baltë, Mendoza bie përtokë. Ai fillon të qajë në mënyrë të pakontrolluar, jo nga lotët e pendimit, por nga gëzimi i lindur nga paqja e brendshme. Atë e strehojnë në fshat dhe e mirëpresin në komunitetin e tyre. Përfundimisht Mendoza betohet si një prift jezuit.

Më vonë, Mendozës i jepet një libër nga i cili lexon një fragment për kuptimin e dashurisë. Stefani nuk e dinte burimin e fjalëve, por ai tha se ato ishin fjalët më poetike dhe të bukura që kishte dëgjuar ndonjëherë. Ato e prekën aq shumë, sa ai e pa skenën në mënyrë të përsëritur dhe me përpikmëri. Ai i shkroi fjalët në mënyrë që të mos i harronte. Ai më pas shkoi në një bibliotekë për të hulumtuar burimin e poezisë. Për habinë e tij, fjalët ishin nga Bibla. Ai lexoi vazhdimisht 1 Korintasve 13— “kapitullin e dashurisë”.

Pas jo shumë kohe, Stefani u interesua romantikisht për një bashkëstudente kolegji. Një natë ajo e ftoi Stefanin në atë që ajo e quajti një “klub”. Doli se ishte një studim bible. Stefani mësoi Lutjen e Zotit. Si shkencëtar, ai besonte

në eksperimente për të përcaktuar rezultatet logjike. Stefani zbuloi se, sa herë që bënte lutjen e Zotit para se të flinte, pushonte i qetë. Shpejt ai filloi të lutej para gjumit çdo natë. Ai po zgjohej nga një dashuri ndjekëse dhe një hir që po e paraprinte.

Perëndia misionar filloi t'u përgjigjej lutjeve të një ateisti të ri. Ai zbuloi shkëlqimin e dashurisë së Perëndisë përmes një filmi që përmban “aktrim të patëmetë dhe peisazhe të bukura”. Stefani iu përgjigj hirit që e paraprin. Ai rrëfeu besimin e tij në Krishtin dhe filloi të ushtronte në botë atë që Perëndia po bënte në të. Stefani tani është një misionar në Kishën e Nazaretasit. I tillë është hiri paraprirës i Perëndisë që çon në pendim dhe transformim.

Besimi në fuqinë e hirit paraprirës e bën të pamundur dëshpërimin për këdo që nuk është bërë ende i krishterë. Ne kurrë nuk duhet të humbim shpresat për askënd, sepse Perëndia nuk i humb. Besimi i ungjilltarëve nuk qëndron as te vetja e as tek aftësia e atyre që dëgjojnë ungjillin. Përkundrazi, besimi ynë absolut është që dashuria e Perëndisë është për të gjithë. Është ekstravagante (Efesianëve 1.7), e pandalshme dhe e pandryshueshme. Është e mjaftueshme për të përfunduar atë që fillon Perëndia. Takimet hyjnore presin!

Sa larg do të shkojë Perëndia për të arritur një person? Kam arritur të vlerësoj tekstin e këngës së Kori Asburi (*Cory Asbury*) 2017 “Reckless Love” (*Dashuri e Dalldisur*), për hirin e Perëndisë që na kërkon. Kënga flet për hirin e Perëndisë në jetën e këngëtarit “para se të flisja ndonjë fjalë” dhe “para se të merrja frymë”. Ai përshkruan “dashurinë kapluese, të pafund dhe të pamatur të Perëndisë” që “më ndjek, lufton derisa të gjendem, i lë të nëntëdhjetë e nëntat”. Refreni shkon kështu:

Nuk ka hije që nuk do të ndriçosh

Mal të cilin nuk do ta ngjitesh

Duke ardhur pas meje

Nuk ka mur që nuk do ta shembësh

Gënjeshër që nuk do ta rrëzosh

*Duke ardhur pas meje.*¹⁷

Kapluese. Që nuk mbaron kurrë. Kjo është sa larg do të shkojë Perëndia për të arritur një person.

17. Disa kanë shprehur shqetësim për përdorimin e fjalës “i dalldisur” në këtë këngë. Nëse do të thotë moskokëçarëse, është problematike. Nëse do të thotë e guximshme, befasuese dhe ekstravagante, ajo po i afrohet përshkrimit të dashurisë së Perëndisë.



E VËRTETA

Përmes hirit shpëtues, Jezusi na shpëton nga mëkati dhe na çon në të vërtetën që na bën të lirë.

3

HIRI QË NA SHPËTON

*Sepse paga e mëkatit është vdekja, por dhuntia e Perëndisë është jeta e përjetshme
në Jezus Krishtin, Zotin tonë.*

Romakëve 6.23

Një gazetar i sportit një herë i kërkoi golfistit të njohur të kampionatit Xhek Nikolas (*Jack Nicklaus*) të identifikonte problemin më të zakonshëm për lojtarët amatorë. Duke pritur që ai të thoshte diçka në lidhje me mungesën e stërvitjes ose paaftësinë për të goditur vazhdimisht mirë, u habita kur Nikolas në vend të kësaj u përgjigj: “Vetëbesimi i tepërt”. Duke menduar se ata janë më të mirë sesa janë në të vërtetë ose mund të bëjnë më shumë sesa mund të bëjnë në të vërtetë. Mendoj se mund ta gjuaj këtë goditje midis atyre dy pemëve. Unë ndoshta mund ta hedh topin mbi ujë. Ky është vetëbesim i tepërt.

Njerëzit e bëjnë atë gjatë gjithë kohës. Ata i mbivlerësojnë shumë aftësitë e tyre dhe i nënvlerësojnë kufizimet e tyre. Sidoqoftë, askund nuk ndodh problemi i mbivlerësimit më shpesh sesa në sferën shpirtërore. Ne e mbivlerësojmë shumë fuqinë tonë shpirtërore dhe e nënvlerësojmë dobësinë tonë shpirtërore.

Moralizmi

Kjo prirje për mbivlerësim shpirtëror të vetes quhet moralizëm. Moralizmi është besimi në vetëdrejtësinë, se gjithçka është mirë shpirtërisht, sepse dikush bën një jetë të kënaqshme morale dhe ka përmirësuar sjelljen e tyre. E thënë në

një mënyrë tjetër, një moralist është dikush që beson se ata janë të shpëtuar nga e mira që bëjnë dhe nga e keqja që shmangin.

Të gjithë moralistët thonë gjëra të ngjashme: “Unë nuk jam Nënë Tereza, por as nuk jam aq i keq. Unë jetoj një jetë të ndershme. Unë i paguaj borxhet e mia. Unë nuk e tradhetoj bashkëshorten time. Unë votoj me përgjegjësi. Jap pak para për bamirësi. Unë nuk jam një fanatik shpirtëror, por as nuk jam aq i keq”. Me fjalë të tjera, moralistët ndjekin linjën e të menduarit që u thotë atyre se Perëndia do të marrë parasysh në Ditën e Gjykimit faktin, që ata bëjnë më shumë mirë sesa keq, veçanërisht në krahasim me njerëzit “e tjerë” (vrasës serialë, përdhunues, shpërndarës droge, etj.) të cilët janë shumë më të këqinj. Moralizmi është i përhapur në botën tonë sot.

Në vitin 2004, organizata Gallup zhvilloi një sondazh për të zbuluar se çfarë besojnë amerikanët për parajsën. Ajo që vërtet tërhoqi vëmendjen time është numri i njerëzve që besojnë se po shkojnë në parajsë: 77 përqind e atyre që thanë se besojnë në parajsë i renditën mundësitë e tyre për të arritur atje si “të mira” ose “të shkëlqyera”. Sidoqoftë, sipas të anketuarve, vetëm gjashtë nga dhjetë miqtë e tyre po shkojnë në parajsë. Më interesante për mua, veçanërisht në lidhje me një këndvështrim moralist, është se shumë nga njerëzit në studim pohuan bindjen se “ekziston një parajsë ku njerëzit që kanë bërë jetë të mirë shpërblehen përjetësisht”¹. Theksoj “jetuan jetë të mirë” për të treguar që shumica e njerëzve besojnë se do shkojnë në parajsë kur të vdesin për shkak të “jetës së tyre të mirë” dhe “sjelljes morale”.

Diana, Princesha e Uellsit, vdiq në vitin 1997. Ishte një humbje tragjike për shumë njerëz në të gjithë botën. Vëmendja mediatike dhe zia publike ishin të mëdha për shkak të popullaritetit të saj ndërkombëtar. Më kujtohet duke dëgjuar njerëzit kur flisnin se sa ngushëlluese ishte të dije që Diana ishte tani në parajsë, se ajo ishte një engjëll që i ruante ata dhe se parajsa ishte një vend më i mirë për të sesa kjo botë. Unë nuk po sugjeroj që Diana nuk është në

1. Albert L. Winseman, “Eternal Destinations: Americans Believe in Heaven, Hell,” May 25, 2004, <https://news.gallup.com/poll/11770/eternal-destinations-americans-believe-heaven-hell.aspx>.

parajsë, por pyes veten për arsyetimin e kaq shumë njerëzve që thonë se ajo është atje. Nga e gjitha sa mund të vëzhgoj, është se ajo ishte një person i sjellshëm, i dhembshur që përdori ndikimin e saj të konsiderueshëm për mirë. Ajo punoi me të varfërit, advokoi për pacientët me AIDS dhe aktivizmi i saj ndihmoi në rritjen e ndërgjegjësimit për fëmijët dhe të rinjtë. Të gjitha këto janë gjëra të mrekullueshme për t'i ditur, por a janë ato gjërat që na shpëtojnë? A mundet të qenit i mirë apo të bërit mirë të të çojë në parajsë dhe shpërblim të përjetshëm?

Ne jetojmë në një epokë të mendimeve të ndryshme në lidhje me këto pyetje. Shumë njerëz besojnë se Perëndia vlerëson në bazë të kurbës dhe se pak mirësi çon shumë peshë. Nëse thjesht mund të grumbullojmë më shumë gjëra në rubrikën “e mirë” sesa në rubrikën “e keqe”, peshorja disi do të anojë në favorin tonë, dhe jeta jonë mjaft e mirë dhe përpjekjet tona të ndershme do të kompensojnë ndryshimin. Ky është moralizmi.

Sidoqoftë, Fjala e Perëndisë është e qartë në këtë pikë: ne nuk jemi të shpëtuar nga përpjekjet tona; ne nuk jemi të shpëtuar nga mirësia jonë; ne nuk jemi të shpëtuar nga qëllimet tona. Ne jemi të shpëtuar nga hiri, dhe hiri vjen nga jashtë vetes tonë. Hiri shpëtues vjen nga Perëndia në personin e Jezus Krishtit.

Shlyerja

Kryqi është mbase simboli më i spikatur dhe i njohur në botë sot. Kur shohim kryqin, na kujtohet jeta dhe vdekja e Jezusit me anë të kryqëzimit. Kryqëzimi ishte forma më e tmerrshme dhe më torturuese e ekzekutimit e shpikur ndonjëherë nga njerëzimi. Për këtë arsye, një personi në shekullin e parë do t'i dukej e çuditshme të shikonte njerëz modernë të veshur me një kryq në një zinxhir rreth qafës së tyre. Nëse sot do të shihnim një person të veshur me një ikonë të një karrigeje elektrike në një varëse, do të mendonim se ishte e çuditshme, sepse përfaqëson një mjet të dënimit penal dhe vdekjes. Kjo është ajo që kryqi ishte për njerëzit në shekullin e parë. Ishte e turpshme dhe e papëlqyeshme. Ishte fati i kriminelëve dhe kryengritësve të thekur. Kryqëzimi ishte aq i tmerrshëm, saqë u krijua një fjalë për ta shpjeguar atë. Fjala jonë

angleze “excruciating” (*shqip torturuese*) do të thotë fjalë për fjalë “nga kryqi”.

Vdekja me kryqëzim ishte një mënyrë e ngadaltë, agonizuese, publike për të vdekur. Nuk ishte e fshehtë. Ata që po kryqëzoheshin shpesh i përqeshnin dhe talleshin me ta. Turma që vëzhgonte hidhte gurë dhe qeshte, ndërsa ata që vareshin në kryq binin ngadalë në një gjendje të frymëmarrjes së thellë, të munduar dhe duke hapur gojën për frymë. Në fund të fundit ata vdisnin nga asfiksia sepse, ndërsa vareshin pezull, mushkëritë e tyre kishin vështirësi të vazhdonin të funksiononin. Ndonjëherë mund të duheshin disa ditë që dikush të vdiste më në fund, dhe pastaj atyre që kryqëzoheshin nuk i jepej një varrim njerëzor. Në vend të kësaj, ata shpesh liheshin që zogjtë të hanin mishin e tyre. Pasi kishte kaluar mjaft kohë që të vdekurit të shërbenin si shembull për cilindo që do të sfidonte Perandorinë Romake, gjithçka që kishte mbetur nga kufoma zbritej nga kryqi dhe hidhej në vendin e mbeturinave të qytetit.

Të mos harrojmë se Jezusi u kryqëzua në kryqin e një kriminel, gjë që më shtyn të them se edhe tani duket shumë e veçantë: të krishterët e shpallin këtë si një lajm të mirë. Në fakt, ne themi se është lajmi më i mirë që kemi dëgjuar ndonjëherë. Fjala që Bibla zgjedh për të shprehur këtë lajm të mirë është “ungjill”. Kryqi është ungjilli ynë – lajmi ynë i mirë.

Në përmbledhjen më të shkurtër të ungjillit në Dhjatën e Re, apostulli Pal deklaroi: “Sepse unë ju kam transmetuar para së gjithash ato që edhe unë vetë i kam marrë, se Krishti vdiq...” (1 Korintasve 15.3). Në vetvete, ky nuk është një lajm i mirë, por më pas Pali i jep një kuptim teologjik vdekjes së Krishtit përmes një parafjale thellësisht të rëndësishme, “për”, për të na zhvendosur nga një fakt tragjik i historisë në rëndësinë e tij të jashtëzakonshme për rrugëtimin tonë të hirit: “që Krishti vdiq *për* mëkatet tona sipas shkrimeve”. Kur shtohet “për”, ai bëhet një lajm i mirë – lajmi më i mirë që kemi dëgjuar ndonjëherë.

Teologjikisht, Shkrimi e quan “vdekjen për mëkatet tona” shlyerje. Shlyerja u bë përmes kryqit të Jezus Krishtit. Doktrina e shlyerjes fillon në Dhjatën e Vjetër. Dita e Shlyerjes, e quajtur gjithashtu Yom Kippur², ishte dita më e

2. Yom = “ditë”; Kippur = “për të shlyer; pastruar.”

shenjtë në judaizmin antik. Ajo u caktua si një ditë pendimi dhe faljeje.

Paramendojeni në mendjen tuaj. Paramendoni mijëra adhurues që mbliidhen së bashku për të filluar vitin duke i shlyer mëkatet e tyre dhe për ta kujtuar mëshirën e Perëndisë. Atë ditë kryepriifti, duke përfaqësuar tërë popullin, solli dy cjep. Një cja p u therr, u flijua si flijim për mëkatin për të bërë shlyerjen. U derdh gjak dhe kafsha vdiq. Romakëve 6.23 na tregon se “paga e mëkatit është vdekja”, dhe Hebrenjve 9.22 na kujton se “pa derdhjen e gjakut nuk ka falje të mëkateve”.

Cjapi i parë vdiq sipas ligjit. Sidoqoftë, cja p i dytë u mbajt gjallë dhe u quajt cja p i fajshlyes. Kryepriifti vuri duart mbi kokën e cja p i t fajshlyes dhe rrëfeu mbi të tërë ligësinë dhe mëkatet e izraelitëve. Simbolikisht, ato mëkate u transferuan dhe u vendosën në kokën e cja p i t. Pastaj, u dëbua në shkretëtirë në një vend të vetmuar ku mëkatet e njerëzve mund të barteshin larg syve.³

Ai ritual vazhdoi vit pas viti, dekadë pas dekadë (shih Hebrenjve 10.3–4). Gjaku rrodhi. Mijëra kafshë u flijuan në një cikël të pafund shlyerjeje për t’u marrë me mëkatet e njerëzve. Ky është konteksti sfond në të cilin Jezusi jetoi dhe shërbeu. Para se të shqyrtojmë se si vdekja e Jezusit në kryq bëri shlyerjen për të gjithë mëkatin, duke e bërë hirin shpëtues një mundësi, le të shqyrtojmë së pari dy pyetje themelore: Çfarë është mëkati? Pse na duhet shlyerja për mëkatin?

Çfarë është mëkati?

Së pari, mëkati është rebelim. Ndoshta përkufizimi më i njohur i mëkatit vjen nga Xhon Uesli: “një shkelje e vullnetshme e një ligji të njohur të Perëndisë”.⁴ Mëkati është diçka që është i njohur dhe i qëllimshëm, ne e dimë se është e gabuar, por ne e bëjmë gjithsesi sepse mundemi. Është mosbindje e qëllimshme.

Kur 1 Gjonit 3.4 na thotë se “kush bën mëkat, bën edhe shkelje të ligjit; dhe

3. Tradita na tregon se ai që ishte caktuar në detyrën e lirimit të cja p i t fajshlyes ishte një johebre që nuk kishte asnjë lidhje me popullin e Izraelit.

4. Wesley, *The Works of John Wesley*, vol. 12 (Kansas City, MO: Beacon Hill Press of Kansas City, 1978), 394. See also James 4.17.

mëkati është shkelje e ligjit.” Nuk i referohet vetëm kuptimit ligjor, si ne “e ke shkelur ligjin”. Ka të bëjë me qëndrimin mbresa shkeljes së ligjit. Një analogji mund të na ndihmojë të kuptojmë. Nëse dikush po drejton një automjet, është e mundur të ecë shpejt pa e ditur se cili është kufizimi i shpejtësisë. Ju mund të jeni akoma duke shkelur ligjin, por nuk po veproni në mënyrë të paligjshme. Kjo është shumë ndryshe nga një person i cili thotë: “Harroji këto rregulla budallaqe për kufizimin e shpejtësisë. Ato thjesht kanë për qëllim të përpiqen të më kontrollojnë. Unë do të bëj atë që dua, sepse unë jam përgjegjës për jetën time.” Paligjshmëria është qëndrimi rebelues prapa shkeljes së ligjit, një frymë rebele.

Kur vajza ime e vogël ishte e vogël, asaj nuk i pëlqente t’i bindej motrës dhe vëllait të saj më të madh kur mami dhe babi nuk ishin aty. Kur unë dhe gruaja ime i lamë vetëm së bashku, më e vogla jonë ngriti zërin e saj të vogël çjerrës dhe u tha vëllait dhe motrës së saj: “Ju nuk jeni shefat e mi!” Megjithëse thuhet me pafajësinë e një fëmije të vogël, ai është qëndrimi i zemrës së mëkatit: vetësorraniteti. Mëkati si rebelim është tundja e grushtit tonë të vogël në fytyrën e Perëndisë së plotfuqishëm dhe të bërës: “Ti nuk je shefi im! Do ta bëj në mënyrën time sepse mundem! Askush përveç meje, madje as Perëndia, nuk do të jetë përgjegjësi i jetës time.”

Është refuzim të pranojmë rolin tonë si krijesa me Krijuesin tonë. Është një vetë-shpallje e pavarësisë për të qenë perëndia i vetes sonë. Ky qëndrim i vetësorranitetit, nuk i habit shkruesit e Shkrimeve. “Ne të gjithë endeshim si dele; secili prej nesh ndiqte rrugën e vet, dhe Perëndia bëri që të bjerë mbi Të paudhësia e ne të gjithëve.” (Isaia 53.6). Mëkati është rebelim.

Sëdyti, mëkati është gjithashtu skllavërim. Është më shumë sesa vetësorranitet dhe zgjedhje për të bërë siç duam vetë dhe për të ecur në rrugën tonë. *Hamartia* është një fjalë greke e përkthyer si mëkat që buron nga folja *hamartano*, që do të thotë “të mos godasësh në shenjë” ose “të shtiesh drejt shënjeshtres dhe të mos godasësh në shenjë”⁵. Megjithëse u përdor për herë të parë nga Aristoteli,

të supozojnë se nëse mishi është burim i së keqes dhe mëkatit, atëherë trupat tanë fizikë duhet të jenë thelbësisht të këqij. Prandaj, siç shkon mendimi, ne duhet të minimizojmë aspektet fizike të jetës sonë, t'i rrahim trupat tanë në nënshtrim dhe të mos lejojmë asnjë kënaqësi ose përmbushje fizike.⁹ Ndërsa kjo mund të duket ekstreme, ajo ndodh në një farë mase sa herë që krijohet një hierarki e mëkatit, të tilla si mëkatet e trupit dhe mëkatet e Frymës, dhe kur e promovojmë idenë se njëri është me siguri më i keq se tjetri, (p.sh., imoraliteti seksual duhet të jetë më i keq se thashethemet ose hidhërimi; dehja duhet të jetë më e keqe se krenaria ose racizmi). Si pasojë, nëse dikush bën një mëkat të trupit, i konsideruar gjithashtu një mëkat “i vdekshëm”, është gati i pafalshëm, por mëkatet e frymës hiqen nga mendja me arsyetimin se “askush nuk është i përsosur”. Të ndash dhe klasifikosh mëkatin në këtë mënyrë është një keqkuptim i qartë i shenjtërisë së Shkrimeve të Shenjta, për të mos përmendur faktin se Pali i klasifikon të gjitha mëkatet së bashku në një kategori (p.sh., shih Galatasve 5.16–21: idhujtaria dhe grindjet identifikohen të dyja si “vepra të mishit”).

Trupi i njeriut qartaz nuk është një gjë e keqe. Mbi të gjitha, Perëndia krijoi trupin e njeriut dhe pastaj mori një trup njerëzor në Jezusin. Kur Pali dëshiron t'i referohet trupit fizik, ai zakonisht zgjedh fjalën greke *soma*, jo *sarks*, të cilën e bën trembëdhjetë herë vetëm tek Romakët. Fjala *soma* mund të nënkuptojë ose trupin fizik të njeriut, ose tërësinë e një personi, si tek Romakëve 12.1: “paraqisni trupin tuaj si fli të gjallë, të shenjtëruar, të pëlqyer tek Perëndia”, që është një thirrje e qartë për shenjtërimin e gjithë personit tonë, përfshirë trupat tanë fizikë.

Pra, çfarë është mishi, dhe pse nevojitet hiri shenjtërues? Mishi është lakmia

9. Pjesa më e madhe e herezisë së Gnosticizmit bazohet në një keqkuptim të mishit që korrespondon me trupin. Ideja platonike e një shpirti suprem abstrakt, bën që disa edhe sot të shikojnë trupin me përbuzje dhe të theksojnë vdekshmërinë e një shpirti të përjetshëm pa trup. Sidoqoftë, ky gabim është në kundërshtim me doktrinën biblike të ringjalljes trupore. Për të luftuar këtë keqkuptim të përhapur, besimet e hershme të krishtera nënvizuan rëndësinë e ringjalljes trupore (p.sh., “Ne besojmë në ringjalljen e trupit dhe jetën e përjetshme”, Kredoja e Apostujve)

e gjithë personit (trup, mendje dhe frymë) që të jemi perëndi të vetes sonë, në vend që të futemi nën sundimin e Jezusit. Është aspekti mëkatar i vetes sonë që dëshiron të jetojë jetën tonë të pavarur nga Perëndia, që të jemi mbreti dhe shpëtimtari i vetes sonë, në vend që të varemi tek Jezusi. Para hirit shpëtues, ne kontrollohemi plotësisht nga mishi në vend të Frymës. Ne kemi një natyrë mëkatore, një gjendje zemre që beson se mund të shpëtojmë vetveten dhe që konsumohet plotësisht dhe dominohet nga mendja e mishit. Sidoqoftë, në momentin e shfajësimit tonë (faljes për mëkatin) dhe rigjenerimit (rilindjes), ne na jepet dhurata e Frymës së Shenjtë¹⁰. Njerëzit e Shenjtërisë Uelsiane gjithashtu i referohen kësaj si “shenjtërimi fillestar,” sepse nuk mund të na jepet ajo që është e shenjtë – Fryma e Jezusit – dhe të mos e fillojmë vetë rrugëtimin e jetës së shenjtë.¹¹

Këtu fillon lufta për sovranitet. Kush do të jetë mbreti i jetës time?

Para se të ishim të krishterë nuk kishte luftë – madje as një përleshje të rastit. Mishi që iu përkushtua vetë sovranitetit dhe dëshirave tona egoiste na mbizotëroi. Kur Fryma vjen në jetën tonë, ne na jepen dëshira, motivime dhe mendje të reja të Krishtit (Romakëve 12.2; 1 Korintasve 2.16; Filipianëve 2.5). Këto dy forca, mishi dhe Fryma, janë në kundërshtim dhe tani luftojnë për epërsi. Shenjtëria është iniciuar, por tani duhet të rritet dhe të piquet.

Kur Pali i shkroi kishës në Korint, ai “nuk mund t’u fliste atyre si njerëz shpirtëror” (1 Korintasve 3.1). A do të thotë kjo se ata nuk ishin të krishterë? Jo, ata ishin të krishterë të rilindur. Në fakt, ai e fillon letrën duke i quajtur: “ata që janë shenjtëruar në Krishtin Jezus” dhe “të thirrur për të qenë shenjtore” (1.2). Rigjenerimi, shfajësimi dhe shpengimi kishin ndodhur. Udhëtimi i tyre i hirit kishte filluar. Problemi i tyre ishte se beteja për mishin e tyre vazhdonte. Zilia,

10. Ndërsa “rigjenerimi” nuk është një fjalë biblike në vetvete, teologët kanë krijuar fjalën për të përshkruar jetën e re që i është dhënë me hir një personi si rezultat i lindjes së tyre të re në Krishtin. Në një kuptim shumë real, njeriu ngrihet në një jetë të re, ndodh një ringjallje shpirtërore dhe pasojnë ndryshimet aktuale në mënyra të prekshme dhe të paprekshme.

11. “Uesli kurrë nuk e përdori këtë term [shenjtërimi fillestar], por nënkupton besimin e tij se momenti i shpëtimit fillon procesin e t’u bërit të drejtë”. LeClerc, *Discovering Christian Holiness*, 318.

rivaliteti, krenaria dhe përçarja e tyre ishin plotësisht të dukshme. Ata ishin të krishterë, por prapë se prapë “njerëz të mishit,” (3.1) të cilët Pali e barazonte me besimin e papjekur. Ata ishin të krishterë, por përsëri “foshnjë në Krishtin” (3.1). Ata kishin ende për t’u rritur. Kjo është një mënyrë tjetër për të thënë se kishte ende një nivel rezistence tek ata që nuk i kishin dorëzuar plotësisht vullnetet dhe mendjet e tyre Perëndisë.¹²

Përsëri, Xhon Uesli ofron një pasqyrë të mprehtë në kontekstin e deklaratave të Palit. Duke pyetur nëse Korintasit kishin humbur besimin e tyre, Uesli këmbënguli: “Jo, ai [Pali] deklaroi qartë se nuk e kishin humbur, sepse atëherë ata nuk do të kishin qenë ‘foshnjë në Krishtin’. Dhe ai flet se janë ‘njerëz të mishit’ dhe ‘foshnja në Krishtin’ si e njëjta gjë; duke treguar qartë se çdo besimtar është (në një farë shkalle) <i>‘mishit’</i>, ndërsa është vetëm një ‘foshnjë në Krishtin’¹³.” Njeriu i mishit, për Ueslin, është i barabartë me të qenit “në mish” dhe përfaqëson një besim të papjekur që duhet të rritet në ngjashmëri me Krishtin dhe mënyrën vetdhënësë të kryqit.¹⁴ Kjo është e vërtetë për çdo besimtar. Pyetja nuk është shpëtimi – është zotëria. Të shenjtëruarit duhet të rriten gjithnjë e më shumë në shëmbëllimin e Jezusit. Nuk është një gjë që duhet të vdesë në ta, ata duhet të vdesin, në një kuptim real por figurativ, për atë që sundonte jetën e tyre më parë.¹⁵ Kredencialet fetare nuk do të mjaftojnë;

12. “Termi grek i përkthyer ‘mendje’ është një nga termat më domethënës antropologjike të përdorura nga Pali. I referohet aspektit arsyetues të një personi kur ushtrohen fuqitë e gjykimet.” Dunning, *Pursuing the Divine Image*, Kindle Location 814. Kapaciteti i dhënë nga Perëndia secilit person për të menduar dhe përdorur intelektin për të kuptuar është një aspekt i të ashtuquajturit katërkëndëshi Ueslian e njohur si “arsye”.

13. Wesley, Sermon 13: “On Sin in Believers,” in *The Complete Works of John Wesley: Vol. 1, Sermons 1–53* (Fort Collins, CO: Delmarva Publications, 2014), 3.2.

14. Dunning thotë se “mishëror” është një fjalë çorientuese, që përdoret si një emër, ndërsa Shkrimet e Shenjta gjithmonë përdorin mishëror si mbiemër”. Dunning, *Pursuing the Divine Image*, Kindle Location 2076. Kjo gjithashtu hedh poshtë idenë se “mishi” është një lloj gjëje e huaj, si një “tumor kanceröz që jeton metaforikisht brenda nesh” që duhet të hiqet kirurgjikisht. Ibid., Kindle Location 801. Ithtarët e konceptit të diçkaje që duhet të hiqet, duke përfshirë disa predikues të Shenjtërisë së shekullit XIX, i referohen kësaj si çrënjësje.

15. William H. Greathouse with George Lyons, *New Beacon Bible Commentary, Romans 1–8: A Commentary in the Wesleyan Tradition* (Kansas City, MO: Beacon Hill Press of Kansas City, 2008), 182.

standardet morale nuk do të jenë të mjaftueshme. Njeriu duhet të vdesë ndaj besimit të tij në mish.

Në një moment mahnitës të një sinqeriteti të prekshëm, Pali rrëfeu: “Megjithëse unë kam përse të besoj edhe në mishin; nëse ndonjë mendon se ka përse të besojë, unë kam akoma më shumë: u rrethpreva të tetën ditë, jam nga kombi i Israelit, nga fisi i Beniaminit, hebre nga hebrenj dhe sipas ligjit farise, sa për zellin, përndjekës i kishës; përsa i përket drejtësisë, që është në ligj, i paqortueshëm.” (Filipianëve 3.4–6). Ai kishte të gjitha kredencialet fetare për t’u konsideruar i drejtë, por besimi i tij do të kishte qenë në mish. Pali vazhdon: “Sidoqoftë, çfarëdo fitimi që kisha, këto duhet t’i konsideroj si humbje për shkak të Krishtit” (3.7). Ai po mbante rregullat dhe po i bindej ligjit, por po jetonte sipas mishit për sa kohë që ai besonte dhe varej nga drejtësia e tij për ta shpëtuar ose për ta bërë të shenjtë. Ato ishin gjëra të mira që ishin ngritur në një vend qëndror në jetën e tij, kështu, ai duhej të vdiste për to në mënyrë që të njihte Krishtin. Për më tepër, duke e njohur Krishtin më plotësisht dhe gjithnjë e më shumë, Pali këmbëu përpjekjet e tij të fituara morale për drejtësinë shpëtuese dhe shenjtëruese të Krishtit: “dhe që të gjendem në Të, duke pasur jo drejtësinë time që është nga ligji, por atë që është nga besimi në Krishtin: drejtësia që është nga Perëndia, me anë të besimit” (3.8–9).

Shumë njerëz janë të moralshëm, madje edhe fetarë, por dhembshuria, ngurtësia, paragjykimi, ashpërsia dhe ftohtësia e shpirtit janë shenja treguese se mishi ka marrë fenë dhe e ka përdorur atë si një strategji për të shmangur varësinë nga Jezus Krishti për shenjtërinë e vet. Si një biznesmen lakmitar, që e shfrytëzon një njeri të bllokuar në varfëri për të përfutur, që është nën skllavërinë e mishit, kështu është fariseu. Në sytë e Perëndisë, ata janë të njëjtë. Ata të dy janë njerëz që kanë ndërmarrë një strategji për të krijuar shtegun e tyre të jetës, pa Perëndinë.

Ja e vërteta e vështirë: edhe të krishterët mund të vazhdojnë të jetojnë sipas mishit. Para hirit shpëtues, mishi nuk lufton me Frymën, sepse ne jemi të vdekur në mëkatet tona. Megjithatë, edhe kur Fryma e Perëndisë të gjallërohet në ne,

ne ende mund të jetojmë në një mënyrë mishërore. Ne ende mund të marrim gjëra të mira dhe t'i bëjmë ato gjëra për t'i arritur synimet tona. Ne ende mund të jetojmë në forcën dhe fuqinë tonë, në vend që të varemi nga Perëndia. Kjo është arsyeja pse kemi nevojë për hiri shenjtërues. Ne kemi nevojë për hiri e Perëndisë për të kryqëzuar mishin që dëshiron të varet nga vetja jonë, për të vrarë pjesën tonë mishtore që dëshiron të menaxhojë jetën tonë, në mënyrë që Fryma e Jezusit të marrë kontroll të plotë.¹⁶

Mësuesi dhe shkrimtari i mirënjohur skocez i devocioneve Osuald Chambers (*Oswald Chambers*) i hyn në thelb vdekjes për veten, në mënyrë që Krishti të njihet gjithnjë e më shumë:

Unë duhet të marr mendimet e mia emocionale dhe bindjet e mia intelektuale dhe të jem i gatshëm t'i shndërroj ato në një vendim moral kundër natyrës së mëkatit; pra, kundër çdo pretendimi që kam për të drejtën time, për veten time. ... Sapo të arrij këtë vendim moral dhe të veproj sipas tij, gjithçka që Krishti arriti për mua në kryq, përmbushet në mua. Angazhimi im i papërmbajtur ndaj Perëndisë i jep Frymës së Shenjtë mundësinë për të më dhënë shenjtërinë e Jezus Krishtit. Individualiteti im mbetet, por motivimi im kryesor për të jetuar dhe natyra që më sundon janë ndryshuar rrënjësisht.¹⁷

Mishi nuk ka pse të sundojë jetën tonë. Liria ofrohet për një jetë të shenjtë. Hiri shenjtërues është mjeti dhe ilaçi. Atëherë, si funksionon hiri shenjtërues në të vërtetë në udhëtimin e hirit? Për këtë qëllim, ne japim pjesën e mbetur të kapitullit.

Duke u Bërë si Jezusi

Dua t'ju tregoj një histori për dikë që do ta quaj Xhorxh (*George*), i cili nuk është emri i tij i vërtetë. Xhorxhi ishte anëtar i kishës sime dhe një person shumë

16. Osuald Chambers i referohet nocionit të vdekjes ndaj vetes si identifikim me vdekjen e Jezusit dhe një "bashkëkryqëzim" i vullnetshëm. Në të njëjtën mënyrë, i krishteri mund të bashkohet me Jezusin në ringjalljen e Tij dhe të marrë pjesë në një "bashkëringjallje" për jetën e re. Jeta e ringjalljes së Jezusit përjetohet tani në jetën e shenjtërisë. Chambers, *My Utmost for His Highest* (Uhrichsville, OH: Barbour and Company, 1935), 73

17. Chambers, *My Utmost for His Highest*, 58.

i pakënaqur. Ai gjithnjë ishte i mërzhitur për diçka. Atij nuk i pëlqente muzika ose predikimi im. Ai tha që unë nuk e predikoja shenjtërinë në mënyrën se si ai e dëgjoi atë kur ishte fëmijë. Për më tepër, ai nuk i pëlqente aq shumë njerëzit, në veçanti njerëzit e rinj. Xhorxhi më shkroi letra shtatë faqeshe që përmbajnë disa nga komentet më të shëmtuara që mund të imagjinoni, jo vetëm duke sulmuar çdo lëvizje që bëra në pastoratin tim, por edhe duke supozuar se i di motivet e mia.

Për një kohë ankesat e tij ishin se kisha ishte e përqendruar në vetvete dhe nuk po arrinte të jashtëm. Pastaj, kur kisha filloi të mbushej me njerëz të rinj, as ajo nuk i pëlqente sepse tani, tha ai, ne nuk interesoheshim më për njerëzit që kishin qenë atje me vite dhe që kishin paguar çmimin që kisha të bëhej e qëndrueshme. Ai tha se ne po rriteshim vetëm sepse po vidhnim dele nga kisha të tjera (e cila nuk ishte e vërtetë). Përfundimi ishte që Xhorxhi nuk donte që gjërat të ndryshonin.

Xhorxhi konsumoi shumë nga energjitë e mia emocionale si pastor. Ai kërcënoi vazhdimisht se do të largohej nga kisha. Mendoj se thellë brenda tij ai e dinte atë që ne të gjithë e dinim, se asnjë kishë tjetër nuk do ta toleronte atë. Më në fund, një ditë e thirra dhe i thashë: “Xhorxh, ti e di që të dua, por jo më letra ose email. Unë nuk mund ta dëgjoj zemrën tënde në një email dhe ti nuk mund ta dëgjosh timen. Nga tani e tutje, nëse ke një shqetësim ose ankesë, do të duhet ta thuash atë ballë për ballë”.

Dukej sikur gjërat u përmirësuan, të paktën për një kohë. Ai kurrë nuk më dërgoi më letër tjetër, por ai vazhdoi të përhapte negativitet në kishë. Arriti në atë pikë që Xhorxhi ishte më shumë si një mushkonjë, sesa një qen sulmues, më shumë i bezdisshëm sesa i rrezikshëm.

Pjesa më e trishtueshme për mua ishte se Xhorxhi nuk po transformohej. Ai ishte një person i çuditshëm dhe kishte qenë për aq kohë sa dikush mund ta mbante mend. Nuk ishte vetëm në kishë. Ai nuk ishte një burrë i mirë për gruan e tij; fëmijët e tij nuk donin të ishin pranë tij; dhe ai nuk kishte asnjë gëzim në jetën e tij. Çuditërisht, ai kishte qenë duke marrë pjesë në kishë gjatë

gjithë gjashtëdhjetë e kusur viteve të tij. Ndoshta më e keqja nga të gjitha, është se askush nuk u çudit që ai nuk po ndryshonte dhe askush madje nuk u shqetësua veçanërisht nga kjo. Ata e kishin pranuar. “Oh, i tillë është Xhorxhi”; do të thoshin ata. Askush nuk priste që ai të bëhej më shumë si Jezusi.

Duke menduar për Xhorxhin, unë kam arritur të besoj se pyetja e gabuar për të bërë në lidhje me shëndetin e një kishe është: “Sa njerëz po vijnë në kishë?” Pyetja më e mirë, ose të paktën lëvizja në drejtimin e duhur, është të pyesësh: “Çfarë lloj njerëzish janë?”¹⁸ Kur dikush bëhet i krishterë, qëllimi nuk është vetëm të mësojë se si të ndjekë Krishtin, por edhe në të vërtetë të jetojë një jetë si Krishti. Ky është qëllimi i të gjithë dishepujve në rrugëtimin e hirit.

Qëllimi i dishepullimit

Kur Pali paraqiti dhuntitë e shërbesës, ai tha se do të kishte apostuj, profetë, ungjilltarë, pastorë dhe mësues, por që qëllimi i tyre i unifikuar do të ishte “për përsosjen e shenjtorëve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit,” (Efesianëve 4.12) Ka shumë për të shpalosur në ato fjalë në lidhje me dishepullimin, por le të fillojmë me konceptin e “trupit”.

Trupi është një analogji intriguese, sepse sa herë që përmendet rritja shpirtërore, ekziston supozimi se diçka është e gjallë. Të gjitha gjërat e gjalla rriten. Gjërat e vdekura qëndrojnë statike ose prishen. Vetëm gjërat e gjalla rriten. Gjërat e pajetë nuk rriten. Një mobilje nuk rritet. Një shkëmb nuk rritet. Vetëm organizmat rriten.

Një organizëm mund të jetë (1) një gjë e gjallë si një bimë, kafshë ose person, ose (2) një sistem funksionues i pjesëve të ndërvarura që përbëjnë një krijesë të gjallë ose send. Bimët janë organizma. Bimët nuk mund të rriten pa rrezet e diellit, ujin dhe lëndët ushqyese. Ato kanë nevojë për një ekosistem për të mbështetur rritjen e tyre, ose ato vdesin. Trupat tanë njerëzorë janë gjithashtu organizma. Anatomia njerëzore është një sistem i funksionimit të pjesëve të ndërvarura, një sistem operacional i krijuar për të punuar së bashku: “trupi është një dhe ka shumë gjymtyrë” (1 Korintasve 12.12). Kur njëra nga pjesët

18 Bill Hull, *The Disciple-Making Pastor* (Old Tappan, NJ: Revell, 1988), 13.

tona nuk po funksionon si duhet, pavarësisht se sa e parëndësishme mund të duket, mund të flakë të gjithë sistemin dhe të na bëjë të pashëndetshëm.

Kur Pali thotë se ne jemi trupi i Krishtit, ai po thotë se kisha është gjithashtu një organizëm, i përbërë nga njerëz dinamikë, të gjallë që janë pjesë të ndërvarura që punojnë së bashku dhe varen nga njëri-tjetri për gjallërinë dhe shëndetin nga fuqia e Frymës së Shenjtë: “Në të vërtetë, trupi nuk përbëhet nga një gjymtyrë, por nga shumë” (1 Korintasve 12.14). Kur gjymtyrët nuk janë duke punuar së bashku në një mënyrë gjithëpërfshirëse, ai sëmuret dhe dobësohet. Në të kundërt, kur gjymtyrët janë të lidhura dhe rriten së bashku në mënyra ushqyese, gjallëria dhe shëndeti janë rezultati, një formë fillon të formohet dhe një qëllim përfundimtar (*telos*) arrihet. Ne e ndërtojmë trupin, “derisa të arrijmë të gjithë tek uniteti i besimit dhe të njohjes së Birit të Perëndisë, *te një njeri i përsosur*, në masën e *shtatit të plotësisë së Krishtit*,” (Efesianëve 4.13, theksimet e shtuara). Qëllimi i pjekurisë së krishterë është shtati i plotë i Krishtit, ngjashmëria me Krishtin. Nuk ka asnjë qëllim tjetër. Kështu është për kishën. Kur anëtarët tanë individualë bashkohen, është që të dukemi si trupi i Krishtit. Përveç kësaj, për çdo rast nëse nuk e kuptuam herën e parë, Pali përsërit se “ne duhet të rritemi në çdo mënyrë në atë që është koka, në Krishtin, prej të cilit i gjithë trupi” rritet në atë që synohet të jetë (v. 15).

Qëllimi i të gjithë rritjes shpirtërore, individualisht dhe si bashkësi, personalisht dhe bashkarisht, është që të bëhemi gjithnjë e më shumë si Jezusi. Akti ose procesi për t’u bërë si Jezusi është shenjtërim dhe bëhet i mundur me anë të hirit shenjtërues.

Shenjtëria nuk është fakultative

Në gjuhën greke, shenjtërimi lidhet me fjalën “i shenjtë” (*hagios*). Teologjia e Shenjtërisë Uesliane pohon se lajmi i mirë i ungjillit nuk është vetëm se ne një ditë do të jemi me Perëndinë kur të vdesim, por gjithashtu, se oferta e një jete të bollshme në mbretërinë e Perëndisë është tani, aty ku jemi. Plani i Perëndisë është që shëmbëlltyra e tij në ne që u dëmtua nga rënia duhet të rikthehet në të gjithë bukurinë dhe lavdinë e Tij, që ne të bëhemi kryevepra e Tij, duke

reflektuar ngjashmërinë e Krishtit në atë që mendojmë, themi dhe bëjmë. Ky quhet shenjtërim dhe kjo është ajo që po bëhemi. Nuk është fakultative për një të krishterë në rritje.

Kur dikush blen një automjet të ri, shitësi do të diskutojë për pajisjet standarde dhe aksesoret fakultativ. Çdo automjet do të vijë me një timon, rripa sigurimi, pasqyra, motor, etj. Kjo është pajisje standarde, çdo automjet i ka ato. Sidoqoftë, nëse dikush dëshiron dritare automatike, rrota speciale dhe një sistem stereo–satelitor, ata duhet të pyesin për çmimin e atyre aksesoreve fakultativ, domethënë, jo çdo automjet i ka ato. Shenjtërimi nuk është një pajisje shtesë fakultative për një dishepull të Jezusit. Është pajisje standarde për çdo model. Të bëhesh si Jezusi pritet, sepse rritja nuk është një opsion. Ne jemi gjithmonë në rritje drejt diçkaje – gjithnjë në procesin e formimit shpirtëror.

Përsëri, Pali e pohon këtë tek Romakëve 12 kur thotë: “Dhe mos u konformoni me këtë botë, por transformohuni me anë të ripërtëritjes së mendjes suaj, që të provoni cili është i miri, i pëlqyeri dhe i përsosuri vullneti i Perëndisë.” (12.2). Të konformuar ose të transformuar, këto janë dy alternativat tona të vetme. Nëse nuk po transformohemi (ndryshojmë nga brenda dhe jashtë) nga fuqia ripërtëritëse e Perëndisë, atëherë ne jemi duke u konformuar (modeluar dhe formuar) nga forca që i kundërvihen Perëndisë që janë të lira në botë. Pyetja nuk është nëse do të formohesh shpirtërisht; pyetja është çfarë do të të formojë ty? Nëse Perëndia nuk po na formon, ekziston një armik shpirtëror, një kundërshtar, i ligu, i cili është plotësisht i lumtur të konfigurojë jetën tonë.

Thënë thjesht, bota pa Perëndinë deformat dhe keqformon njerëzit. Perëndia reformon dhe transformon. Kjo është arsyeja pse shenjtërimi, t’u bërit si Jezusi është kaq i rëndësishëm. Pak fjalë përmbledhin më mirë vullnetin e Perëndisë për jetën njerëzore sesa këto nga Shkrimet: “Sepse ky është vullneti i Perëndisë, shenjtërimi juaj” (1 Thesalonikasve 4.3); dhe “Kërkoni paqe me të gjithë dhe shenjtërim, pa të cilin askush nuk ka për të parë Perëndinë.” (Hebrenjve 12.14). Urdhërimi për të ndjekur paqen dhe shenjtërinë, nënkupton veprim mbi pasivitetin. Rritja shpirtërore e një personi quhet

shenjtërim, ose shenjtëri. Shenjtërimi fillestar dhe shenjtërimi i plotë nuk janë të njëjtë, por qëllimi i të gjithë shenjtërimit është të bëhemi si Jezusi. Ky është vullneti i Perëndisë për jetën e çdo të krishteri sepse, nëse nuk “rritemi në çdo gjë drejt Atij që është kreu, Krishti”, ne po formohemi nga diçka tjetër përveç dashurisë së shenjtë (Efesianëve 4.15).

Një ekuacion për rritjen shpirtërore

Dishepullimi nuk është një alternativë. Shumica e të krishterëve nuk do ta argumentonin atë pikë. Pyetja e vërtetë është, si ndodh kjo rritje? Në librin e tij *Rethinking the Church*, Xhejms Emeri Uajt (*James Emery White*) shpjegon atë që shumë njerëz besojnë në lidhje me procesin e dishepullimit. Formula që ai ofron është dhënë në formën e një ekuacioni matematikor:

Shpëtimi + Koha + Zbatimi individual = Ndryshim jete

Formula zhvillohet bazuar në katër supozime: (1) ndryshimi i jetës ndodh në shpëtim; (2) vazhdon të ndodhë natyrshëm me kalimin e kohës; (3) arrihet kryesisht nga një veprim i vullnetit; dhe (4) arrihet më së miri vetëm.¹⁹ Le të shohim me kujdes hipotezën e propozuar.

Së pari, “shpëtimi”. Shpëtimi është një transformim aq rrënjësor i qënies sonë (“i rilindur”) sa që ka një ndryshim të menjëhershëm të zemrës që shkakton një shndërrim të mrekullueshëm të dëshirave, zakoneve, qëndrimeve dhe karakterit. Të krishterët lindin, nuk bëhen. Meqenëse shpëtimi ndryshon statusin e marrëdhënies sonë me Perëndinë, ndryshon fatin tonë të përjetshëm dhe fut fuqinë dhe punën e Frymës së Shenjtë në jetën tonë, pritet një rritje e menjëhershme dhe thelbësore. Ky është supozimi i shpëtimit.

Së dyti, “koha”. Ndërsa procesi i transformimit zhvillohet gjatë konvertimit, është e qartë se një person nuk është rritur plotësisht kur bëhet i krishterë. Ka ende hapësira të rezistencës dhe egoizmit që duhet të trajtohen, thotë Uajt, por këto janë gjëra të cilat trajtohen me kalimin e kohës.²⁰ Prandaj, formula

19. James Emery White, *Rethinking the Church: A Challenge to Creative Redesign in an Age of Transition* (Grand Rapids: Baker Books, 1997), 55.

20. White, *Rethinking the Church*, 56.

vijon se një i krishterë pesë vjeçar do të ketë pesë vite pjekuri shpirtërore dhe një i krishterë dhjetë vjeçar do të ketë dhjetë vite pjekuri, e kështu me radhë. Besimi nuk mund të mos rritet, por rritet me kohën, prandaj gjithçka që duhet të bëjmë është të lexojmë Biblën dhe të shkojmë në kishë sa më shumë që të jetë e mundur, dhe fryti i Frymës do të shumëfishohet dhe ne do të bëhemi më shumë si Jezusi. Ky është supozimi i kohës.

Së treti, “zbatimi individual”. Kjo ka të bëjë me vullnetin e një personi. Ideja është se gjithçka që nuk ndodh natyrshëm me kalimin e kohës do të plotësohet me vendosmëri dhe përpjekje njerëzore. E gjithë ajo që një person duhet të bëjë është të vendosë të jetojë dhe të veprojë në një mënyrë të caktuar (dhe të këmbëngulë), sepse jeta e krishterë mbështetet nga veprimet e vullnetit. Koha e mjaftueshme, plus vullneti ynë do të prodhojë frytin e Frymës. Ky është supozimi i zbatimit individual.

Në fund, “më së miri realizohet vetëm”. Supozimi përfundimtar i ekuacionit të dishepullimit është pavarësia, ose një marrëdhënie personale me Jezus Krishtin është e barabartë me një marrëdhënie intime.²¹

Kështu, ekuacioni shkon, por ne rrallë shqetësohemi të pyesim nëse ato supozime janë të vlefshme. A ndodh kështu dishepullimi? A fillojmë të rritemi automatikisht në jetën tonë shpirtërore pas shpëtimit? Kur dikush bëhet i krishterë, a ka ndonjë ndryshim të menjëhershëm të thellë të shprehive, qëndrimeve dhe transformimit të karakterit? A rriten të krishterët vetëm nga koha dhe vullneti? Meqenëse marrëdhënia jonë me Perëndinë është personale, a është më mirë që dishepujt e Jezusit të punojnë vetëm? Nëse këto supozime janë të sakta, duhet të ketë prova të shumta për këtë në kishë. Nëse ato janë të vërteta, thekson Uajt, atëherë thjesht funksionimi i ekuacionit duhet të ofrojë gjithnjë të njëjtat rezultate: të krishterët individualë dhe trupi i Krishtit bëhen gjithnjë e më shumë si Jezusi në të menduarit, të folurit dhe të vepruarit tonë.²²

21. Ideja e një marrëdhënie personale me Krishtin që është sinonim i një marrëdhënie intime me Jezusin është shumë më e përhapur në shoqërinë perëndimore sesa pjesët e tjera të botës. Individualizmi konsiderohet si një virtyt kulturor në SHBA.

22. White, *Rethinking the Church*, 57.

Sidoqoftë, ka arsye të rëndësishme pse formula nuk është krejtësisht e plotë.

Për fillestarët, dishepujt e Jezusit kanë lindur dhe janë krijuar. Ruajtja e hirit ndryshon statusin tonë të marrëdhënies me Perëndinë, fatin tonë të përjetshëm dhe inicion fuqinë dhe punën e Frymës së Shenjtë në jetën tonë. Sidoqoftë, siç e shohim nga mësimet e Dhjatës së Re, të krishterët e rinj nuk janë ende të pjekur në karakter. Të jesh i krishterë, nuk përkthehet automatikisht në të qenurit si Krishti. Nevojitet zhvillim. Virtyti rritet me kalimin e kohës, përmes praktikave specifike.²³ Në dritën e këtyre aktualiteteve, le të shqyrtojmë një kornizë më biblike se si zhvillohet rritja shpirtërore përmes hirit shenjtëruës.

1. Rritja shpirtërore mund të fillojë me shpëtimin, por ne vazhdojmë të rritemi me hir gjatë gjithë jetës sonë. Ekziston një ndryshim midis shenjtërimit dhe shenjtërimit të plotë. Debat i gjithmonë duket të jetë nëse shenjtërimi është i menjëhershëm apo gradual. A ka ndonjë moment kritik, apo është një proces? Përgjigjja është të dyja.²⁴ Hiri i shenjtërimit fillon në momentin kur përjetojmë hirin shpëtues. Teologët i referohen asaj si “shenjtërimi fillestar”, i cili pasohet nga rritja shpirtërore e hirit, derisa në një moment të shenjtërimit të plotë dhe dorëzimit të plotë nga ana jonë, Perëndia pastron zemrën. Kjo është një përvojë e referuar si shenjtërim i plotë, ose “përsosmëri e krishterë”²⁵.

23. N. T. Urajt e përkufizon konceptin e krishterë të virtytit si transformim të karakterit. Wright, *After You Believe: Why Christian Character Matters* (New York: HarperCollins Publishers, 2010). Shumë më shumë kohë do t'i jepet të kuptuarit të virtytit në kapitullin 5, “Hiri Mbajtës”.

24. Tema e krizës ose procesit të menjëhershëm ose progresiv, në përvojën e shenjtërimit të plotë ka qenë historikisht një temë e debatit të madh në qarqet e Shenjtërisë Uesliane. Vetë Xhon Uesli theksoi vazhdimisht nevojën për të dyja, dhe udhëheqësit e hershëm nazaretas ishin përgjithësisht të kujdesshëm për të sugjeruar një ekuilibër. Mbikqyrësi i Përgjithshëm R.T. Uilliams (*R.T. Williams*) i deklaroi Asamblesë së Përgjithshme të Kishës së Nazaretasit në vitin 1928 si më poshtë: “Kisha duhet t'i kushtojë vëmendje krizës dhe procesit në besim. Për shumë vite, njerëzit e shenjtërisë menduan se puna për të cilën ata u thirrën përfundoi në altar, kur turmat që erdhën përpara morën bekimin e rigjenerimit dhe shenjtërimit, por u bë e qartë se puna jonë vetëm sa ka filluar në këtë pikë. Kisha e Nazaretasit po kombinon këto dy parime të mëdha, domethënë krizën dhe procesin. Udhëheqja [e njerëzve] drejt Perëndisë dhe ndërtimi të trupit të Krishtit në shpëtimin fillestar dhe zhvillimin e karakterit të krishterë. *General Assembly Journal*, 1928, referenced in Dunning, *Pursuing the Divine Image*, Kindle Location 2176, footnote 26.

25. Përsosmëria e krishterë është një frazë biblike dhe e përdorur shpesh gjatë gjithë historisë së

Sidoqoftë, edhe pas atij momenti shenjtërimi të plotë ndaj Perëndisë, ne vazhdojmë të rritemi me hir dhe kurrë nuk ndalemi së rrituri për sa kohë që jetojmë.

Nenet e Besimit për Kishën e Nazaretasit thonë: “Ne besojmë se ka një dallim të dukshëm midis një zemre të pastër dhe një karakteri të pjekur. E para arrihet menjëherë, rezultat i shenjtërimit të plotë; kjo e fundit është rezultat i rritjes në hir.”

Kur i përgjigjemi me besim hirit paraprirës, marrim hirin shpëtues. Ndodh një riorientim rrënjësor i përparësive tona, një rindërtim i dëshirave tona, dhe fuqia e puna e Frymës së Shenjtë lirohen në jetën tonë. Në vend që të çlirohet menjëherë nga çdo zakon i dëmshëm, të metë karakteri apo natyre të keqe që kemi pasur ndonjëherë, Perëndia vazhdon të punojë në ne për të na formuar në atë që dëshiron të jemi. Qëllimi i të gjithë dishepullimit të krishterë, është të bëhemi gjithnjë e më shumë si Jezusi. Kjo është arsyeja pse Pali arsyeton, ashtu si nuk presim që foshnjat të mbeten foshnja, ashtu siç duam që ato të rriten dhe të pihen në të rritur plotësisht funksionalë, ne gjithashtu duhet të presim që edhe ne si të krishterë të mos qëndrojmë foshnja shpirtërore. Rritja shpirtërore fillon me shpëtimin, por ne vazhdojmë të rritemi me hir gjatë gjithë jetës sonë. Duhet të shohim, veprojmë dhe mendojmë më shumë si Krishti vitin e ardhshëm sesa sot, kështu që përparojmë me anë të hirit shenjtëruës.

2. Rritja shpirtërore përfshin jo vetëm kohë. Ose shumica e miqve të mi nuk e dinë, ose kanë harruar, që unë mund të luaj në piano. Unë kam luajtur

krishterë. Etërit dhe nënat e hershme të kishës e barazuan përsosmërinë me idenë e *theosis*, ose hyjnëzimit: marrjen e natyrës hyjnore. Sidoqoftë, koncepti modern i përsosmërisë kuptohet ndryshe. Asnjëherë nuk është mësuar me saktësi si një “përsosmëri pa mëkat”, ose, siç shkruan Tomas Nobël (*Thomas Noble*), “ideja se brenda kësaj jete, të krishterët mund të arrijnë atë gjendje përsosmërie përfundimtare, absolute, ku do të ishin pa mëkat dhe krejt të shenjtë”. T. A. Noble, *Holy Trinity, Holy People: The Historic Doctrine of Christian Perfecting* (Eugene, OR: Cascade Books, 2013), 22. Për të shmangur ngatërrimin e interpretimit modern dhe për të nxjerrë në pah aspektet dinamike të rritjes në hir, Nobël argumenton; “Duke pasur parasysh atë koncept dinamik të përsosjes së lëvizjes, në vend të arritjes përfundimtare, mund të jetë e preferueshme të shprehet ky kuptim i fjalës greke jo duke përdorur fjalën ‘përsosmëri’, por duke e përkthyer atë si ‘përsosje’.” Ibid., 24.

më shumë se dyzet vjet në piano. Kur isha dhjetë vjeç, praktikojta pothuajse çdo ditë (me shumë mbikëqyrje nga nëna ime, e cila i dha përparësi ushtrimit të pianos mbi futbollin). Tani luaj shumë më rrallë, rreth një herë në vit. Nëse dikush do të më pyeste se sa kohë kam luajtur, do të ishte e vërtetë për mua të thoja katër dekada, por pjesa tjetër e historisë është se nuk kam kaluar të gjitha këto katër dekada duke qenë i qëllimshëm për të ushtruar. Ka të rinj në kishë që kanë luajtur piano vetëm për disa vjet, që mund të luajnë më mirë se unë, edhe pse unë teknikisht kam luajtur shumë më gjatë.

Nuk është ndryshe me jetën tonë shpirtërore. Thjesht të jesh i ekspozuar ndaj informacionit, nuk do të thotë që njerëzit e përthithin, e kuptojnë, e përqafojnë dhe e jetojnë atë. Ndërsa është e vërtetë që rritja shpirtërore kërkon kohë, nuk është e vërtetë që hiri shenjtëruar është në thelb një produkt i kohës, apo edhe një nënprodukt i ekspozimit ndaj kulturës së krishterë.²⁶ Kishat janë plot me njerëz që kanë kaluar vite si të krishterë, megjithatë jeta e tyre reflekton shumë pak nga Fryma e Jezusit. Ata janë kritikues, të çuditshëm, cinikë, negativë dhe egoistë. Shumë prej tyre janë pikërisht si Xhorxhi nga një prej asambleve të mia të dikurshme: ata nuk po bëhen gjithnjë e më shumë si Jezusi çdo vit. Arsyeja është shumë e thjeshtë.

3. Rritja shpirtërore nuk është aq shumë çështje kohe, por është bashkëpunim me Perëndinë dhe stërvitje e qëllimshme. Shkruesi i Hebrenjve thotë: “Sepse, ndonëse tashmë duhet të ishit mësues, keni përsëri nevojë që t’ju mësojnë njohuritë e para të orakujve të Perëndisë, dhe keni nevojë për qumësht, dhe jo për ushqime të forta.

Sepse kushdo që ushqehet me qumësht nuk ka përvojën e fjalës së drejtësisë, sepse është foshnjë; kurse ushqimi i fortë është për të rriturit, të cilët, *nga përvoja, i kanë të zhvilluara* vetitë për të dalluar të mirën dhe të keqen. Prandaj, duke e lënë fjalën e fillimit të Krishtit, le të synojmë përsosjen, pa hedhur përsëri themel pendimi nga vepra të vdekura dhe nga besimi te Perëndia,” (Hebrenjve 5.12—6.1, theksimi i shtuar).²⁷ Bazuar në frazën “ndonëse tashmë”, mund të

26. White, *Rethinking the Church*, 59.

27. Uesli e pëlqente ta përshkruante shenjtërimin si përsosmëri të krishterë, madje duke e titulluar

supozojmë se kjo pjesë e Shkrimit u është shkruar besimtarëve që kishin qenë të krishterë për ca kohë tashmë. Në vend që të bëhen mësues të rrugëtimit të hirit përmes fjalëve dhe shembullit të tyre, ata ende po hanin ushqim për bebe. Rruga për të ngrënë një dietë të rriturish dhe për t'u bërë një i krishterë i pjekur është përmes stërvitjes së tyre për drejtësi, stërvitje që do t'i ndihmonte ata të njohin ndryshimin midis së drejtës dhe së gabuarës dhe të bëjnë dallimin midis së mirës dhe më të mirës. Ky është synimi i përsosjes së krishterë, ose e një pjekurie në Krishtin që lejon besimtarët e penduar të largohen nga aspektet e mishit që ende mbeten në zemër.²⁸

Fraza “i kanë të zhvilluara nga përvoja” në shkrimet e Hebrenjve është intriguese. Kjo nënkupton përpjekje të qëllimshme dhe nënkupton që të krishterët marrin pjesë në rritjen tonë shpirtërore në Krishtin. Shembuj të tjerë ka me bollëk: “Pajisuni! Ndërtoni besimin tuaj! Vazhdo të vraposh! Ruaje zemrën tënde!” Të gjitha këto janë urdhërime biblike për të ushtruar në botë atë që Perëndia po vepron në ne. Kjo stërvitje kryhet me anë të praktikave specifike, ose mjeteve të hirit, që Xhon Uesli i quajti vepra devotshmërie dhe

katekizmin e tij më të famshëm doktrinar *A Plain Account of Christian Perfection (Një Shtjellim i Hollësishtëm i Përsosmërisë së Krishterë)*. Duke argumentuar se përvoja e dashurisë së përsosur ose “Perëndia që përsoset në dashuri” mund të realizohet në këtë jetë, ai thekson: “(1) ekziston një gjë e tillë si përsosmëria; sepse përmendet në mënyrë të përsëritur në Shkrime. (2) Nuk është aq herët sa shfajësimi; sepse personat e shfajësuar duhet të ‘synojnë përsosmërinë’. (Heb. 6.1) (3) Nuk është aq vonë sa vdekja; sepse Shën Pali flet për burra të gjallë që ishin të përsosur. (Filipianëve 3.15).” Wesley, *A Plain Account of Christian Perfection*, Annotated, eds. Randy L. Maddox and Paul W. Chilcote (Kansas City, MO: Beacon Hill Press of Kansas City, 2015).

28. Xhon Uesli, në një predikim të titulluar “Repentance of Believers” (*Pendimi i Besimtarëve*), theksoi domosdoshmërinë e vazhdueshme të pendimit për të krishterët që do të ndiqnin jetën e shenjtë. Në një letër të dorëzuar një konference të shenjtërisë, një nga profesorët e mi të teologjisë nga seminari, Rob L. Stejpëlls (*Rob L. Staples*), tha: “I tërë shenjtërimi mund të kuptohet si përkushtim i plotë ndaj fatit tonë të *theosis* [përtëritja në shëmbëlltyrën e Perëndisë] me një vazhdimësi pendimi për, dhe pastrimin përfundimtar nga çdo gjë që e pengon ose e zbeh një angazhim të tillë, ose atë që Uesli e quajti ‘pendimi i besimtarëve’, për të cilin ai tha se ishte ‘i nevojshëm në çdo fazë të mëvonshme të rrugëtimit tonë të krishterë’”. Staples, “Things Shakable and Things Unshakable in Holiness Theology,” Revisioning Holiness Conference, Northwest Nazarene University, February 9, 2007.

vepra mëshire.²⁹ Veprat e devotshmërisë përfshijnë mjetet e krijuara të hirit të tilla si; lutja, leximi i Biblës, agjërimi, marrja e Darkës së Zotit, pagëzimi dhe kalimi i kohës me të krishterë të tjerë. Veprat e mëshirës janë gjithashtu një mjet hiri në shërbim të të tjerëve, të tilla si “ushqimi i të uriturve, veshja e të zhveshurve, mikëpritja e të huajit, vizita e atyre që janë në burg ose të sëmurë dhe udhëzimi i të painformuarve”³⁰. Ne praktikojmë mjetet e hirit edhe kur i marrim ato si dhurata; pjesëmarrja jonë është e domosdoshme.³¹

Sidoqoftë, duhet të jemi të kujdesshëm që të mos ngatërrojmë pjesëmarrjen me kontrollin. Ne nuk e kontrollojmë rritjen tonë shpirtërore, madje as nuk e shkaktojmë atë. Ka disa gjëra brenda kontrollit tonë. Ne mund të dërgojmë një mesazh me tekst, të hipim në autobus ose të blejmë ushqime. Ka edhe gjëra për të cilat ne nuk mund të bëjmë asgjë. Ne nuk mund ta ndryshojmë motin. Ne nuk mund t’i ndryshojmë genet tona. Ka gjëra që ne mund t’i kontrollojmë dhe ato që nuk mundemi – të dyja ekzistojnë.

Sidoqoftë, ekziston edhe një kategori e tretë: gjërat që ne nuk i kontrollojmë, por me të cilat mund të bashkëpunojmë. Mendoni për gjumin. Nëse keni pasur ndonjëherë fëmijë, ju mund të njiheni me rastet kur ju është dashur t’u thoni që të flenë gjumë. Ndonjëherë ata do të përgjigjen duke thënë: “Nuk mundem!” Ata kanë pjesërisht të drejtë. Ata nuk mund ta detyrojnë veten të flenë në të njëjtën mënyrë si ju mund të bëni një telefonatë.

Si prindër, ne i sigurojmë fëmijët tanë se ata mund të bëjnë disa gjëra për t’u hapur ndaj gjumit. Ata mund të përgatiten për gjumë. Ata mund të shtrihen në shtrat, të fikin dritat, të mbyllin sytë, të dëgjojnë muzikë të qetë dhe gjumi do të vijë! Ata nuk mund ta kontrollojnë atë, por nuk janë të pafuqishëm. Ata mund

29. “Me anë të ‘mjeteve të hirit’ unë i kuptoj shenjat, fjalët ose veprimet e jashtme, të të shuguruarve nga Perëndia dhe të caktuar për këtë qëllim, të jenë kanalet e zakonshëm përmes të cilave ai mund t’u përcjellë njerëzve, hirin parandalues, shfajësues ose shenjtërues.” Wesley, “Sermon 16: The Means of Grace,” II.1, <http://wesley.nnu.edu/john-wesley/the-sermons-of-john-wesley-1872-edition/sermon-16-the-means-of-grace/>. Mjetet e hirit nganjëherë quhen edhe disiplina shpirtërore.

30. Joel B. Green and William H. Willimon, eds., *Wesley Study Bible New Revised Standard Version* (Nashville: Abingdon Press, 2009), 1488, footnote “Going on to Perfection.”

31. Për më shumë rreth mjeteve të hirit, shih kapitullin 5, “Hirit Mbajtës”.

të jenë të hapur për gjumë dhe ta lejojnë atë të vijë. E njëjta gjë është e vërtetë për rritjen shpirtërore. Ne nuk mund ta shenjtërojmë veten ose ta bëjmë veten si Jezusi. I Shenjti na bën të shenjtë. Perëndia është shenjtëruesi ynë. Sidoqoftë, ashtu si në shpëtimin tonë, bashkëpunimi është i domosdoshëm. Ne nuk e ruajmë veten, por duhet t'i themi “po” hirit shpëtues.

Mësuesi i shquar i dishepullimit Dallas Uillard tha në mënyrë të shquar: “Hiri nuk është kundër përpjekjes; është kundër fitimit”.³² Hiri është më shumë sesa rilindje, shfaqësim dhe falje. Hiri është i nevojshëm për të gjithë rrugëtimin e dishepullimit. Megjithatë, mbase rreziku i madh i kohës sonë nuk është të mendojmë se po bëjmë shumë në rrugëtimin tonë të dishepullimit, por të supozojmë se nuk duhet të bëjmë asgjë. Pasiviteti mund të jetë po aq i rrezikshëm sa legalizmi. Kur Pali thotë të zhveshim njeriun e vjetër dhe të veshim të riun, ai me siguri do të thotë që ne duhet ta bëjmë atë me ndihmën e Perëndisë. Pali është i pa kompromis për këtë: “Ushtroru në perëndishmëri” (1 Timoteut 4.7), dhe përsëri: “A nuk e dini se ata që vrapojnë në pistë, vërtetë vrapojnë të gjithë, por vetëm një e fiton çmimin? Vraponi në mënyrë që ta merrni.” (1 Korintasve 9.24).

Hiri do të thotë që Perëndia ka bërë gjithçka që nuk mund të bënim për veten tonë, por nuk do të thotë që tani bëhemi konsumatorë që nuk kontribuojnë asgjë në marrëdhënie. Kjo ide e gabuar shpjegohet për qasjen mospërfshirëse në dishepullim nga shumë të krishterë dhe si rezultat, mungesën e rritjes dhe pjekurisë shpirtërore. Kështu, Dallas Uillard gjithashtu tha: “Ne e dimë, siç thotë Jezusi; ‘Pa mua nuk mund të bëni asgjë’ (Gjoni 15.5)...por më mirë të besojmë se pjesa e pasme e këtij vargu thotë: ‘Nëse nuk bëni asgjë, do të jetë pa Mua.’ Dhe kjo është pjesa që e kemi më të vështirë të dëgjojmë.”³³ Ne bashkëpunojmë me hirin aktiv të Perëndisë duke rirënditur jetën tonë rreth atyre aktiviteteve, disiplinave dhe praktikave që u modeluan nga Jezus Krishti.

32. Dallas Willard, *The Great Omission: Reclaiming Jesus's Essential Teachings on Discipleship* (New York: HarperCollins, 2006), 61.

33. Willard, “Spiritual Formation: What It Is, and How It Is Done,” n.d., <http://www.dwillard.org/articles/individual/spiritual-formation-what-it-is-and-how-it-is-done>.

Për më tepër, ne marrim pjesë në to jo për të fituar shenjtërimin tonë, por për të arritur përmes stërvitjes atë që nuk mund të bëjmë thjesht “duke u përpjekur më shumë”.

4. Rritja shpirtërore është një përpjekje e përbashkët. Lexuesit perëndimorë priren të befasohen nga theksimi i përbashkësisë në përshkrimin e Palit për udhëtimin e hirit, megjithëse shumë kultura joperëndimore tashmë e dinë që ne nuk mund të udhëtojmë në rrugë të vetëm. Duke lexuar përsëri nga traktati i tij kurorëzues teologjik në lidhje me kishën: “Prej të cilit [Krishtit] gjithë trupi, i lidhur mirë dhe i bashkuar, me anë të kontributit që jep çdo gjymtyrë dhe sipas forcës së çdo pjese të veçantë, *shkakton rritjen e trupit*, për ndërtimin e vetes së tij në dashuri. (Efesianëve 4.16, theksimi i shtuar). Sado të papritura mund të jenë këto vargje për kulturat e mësuara të përkulën në altarin e individualizmit, përfshirë këtu edhe spiritualitet individualist, Pali është jopalogjetik se dishepullimi ynë nuk kishte kurrë për qëllim të ishte një akt solo. Çdo “pjesë” (individuale) e trupit është e rëndësishme dhe ka një punë unike për të bërë, por e gjithë puna individuale ka një qëllim të kombinuar të deklaruar: të ndihmojë pjesët e tjera të rriten.

Është sinergji e shenjtë. “Sinergji” rrjedh nga fjala greke *synergos*, që do të thotë “duke punuar së bashku”. Është thënë që puna e një tërësie është më e madhe se shuma individuale e pjesëve të saj, ose se kombinimi i pjesëve individuale prodhon një ndikim më të madh sesa mund të bëhej vetëm. Sinergjia gjendet në natyrë, biznes, sport dhe marrëdhëniet familjare. Është fuqia e ndërvarësisë, reciprocitetit dhe ndërsjelljes.³⁴

Një shembull i njohur i ndërsjelljes është marrëdhënia midis zebrave dhe zogjve shumë të vegjël të quajtur okspaktorë. Okspaktorët hanë këpushat në kurrizin e zebrave, duke vepruar si një lloj kontrolli i dëmtuesve; okspaktorët gjithashtu lëshojnë një tingull fishkëllyes kur tremben, duke shërbyer si një sistem alarmi për zebrat kur grabitqarët janë afër. Zebrat sigurojnë shumë

34. Për më shumë mbi një kuptim biblik të ndërvarësisë, shih mësimet e Dhjatës së Re të Palit mbi trupin e njeriut si një metaforë për kishën (1 Korintasve 12, Efesianëve 4). Për më shumë mbi ndërsjelljen, shih mësimet e tij mbi martesën e krishterë (Efesianëve 5).

ushqim për zogjtë; zogjtë furnizojnë zebrat me higjienë të mirë dhe kujdes shëndetësor. Këto dy kafshë janë krejtësisht të ndryshme në kaq shumë mënyra, por secila ka nevojë për tjetrën që të lulëzojë.

Sinergia është gjithashtu masa e një trupi të shëndetshëm që është në rritje dhe plot dashuri të përsosur (atë që greqishtja e quan *agape*). Llogaridhënia, inkurajimi, këshillimi, lutja ndërmjetësuese dhe mbështetja janë të pamundura pa njerëzit e tjerë. Ne bëhemi një popull i shenjtë së bashku. Ne e dëgjojmë zërin e Perëndisë më qartë në komunitet. Dashuria është sipërfaqësore derisa të jetohet në kontekstin e marrëdhënieve reale. Rrugëtimi i hirit është një ngjarje në ekip!³⁵

Kështu që këtu janë, krah për krah. Dy ekuacione të dallueshme për rritjen në dishepullim.

Ekuacioni i njohur:

Shpëtimi + Koha + Vullneti Individual = Rritja Shpirtërore

Ekuacioni i shenjtërisë:

Hiri + Bashkëpunimi me Perëndinë + Komuniteti i Krishterë =
Ngjashmëria me Krishtin

Të krishterët janë thirrur të rriten në hir, i cili është një mënyrë tjetër për të thënë që ne duhet të rritemi në shëmbëllimin e Jezusit. Ne marrim jetë të re nga Krishti që të mund të rritemi në Krishtin. Perëndia riformon dhe rimodelon. Është hir shenjtëruar. Unë nuk njoh askënd që e thotë atë në mënyrë më të çuditshme se C. S. Luis (*C. S. Lewis*):

Paramendoni veten si një shtëpi të gjallë. Perëndia hyn për të rindërtuar atë shtëpi. Në fillim, mbase mund ta kuptoni se çfarë po bën. Ai po i rregullon tubacionet dhe po ndalon rrjedhjet në çati e kështu me radhë; ju e dinit që ato punë duheshin bërë dhe kështu nuk habiteni. Por aktualisht ai fillon të godasë shtëpinë në një mënyrë që dhemb keq dhe nuk duket se ka ndonjë kuptim. Çfarë është duke bërë vallë ai? Shpjegimi është se ai po ndërton një shtëpi krejt tjetër nga ajo që keni menduar – duke hedhur një krah të ri këtu, duke vendosur

35. White, *Rethinking the Church*, 61. Shih gjithashtu kapitullin 5 dhe theksin mbi llogaridhënen dhe hirin e qëndrueshëm të krishterë.

një dysHEME shtesë atje, duke ngritur kulla, duke bërë oborre. Ju menduat se po shndërrohemi në një shtëpizë modeste e të vogël: por ai po ndërton një pallat. Ai synon të vijë dhe të jetojë vetë në të.³⁶

Perëndia jo vetëm që na shpëton, por edhe na transformon. Ai na pranon aty ku jemi, por na do mjaftueshëm sa të mos na lërë aty. Ai riimagjinon, ribën dhe rimodelon. Kur e ofrojmë veten në shenjtërim të plotë dhe nënshtrim të plotë tek Perëndia Atë, Perëndia Frymë e Shenjtë i pastron zemrat tona, duke na shndërruar në shëmbëlltyrën e Perëndisë Bir. Ne bëhemi si Krishti në mendimet, fjalët dhe veprat tona. Shtëpia jonë është nën menaxhim të ri.

“Shenjtëri do të thotë që nuk ka asnjë cep të jetës suaj të jetë mbyllur ndaj kontrollit të Jezus Krishtit.”³⁷ Ne i heqim duart nga timoni dhe e lëmë Jezusin të jetë në krye dhe të japë urdhërat. Ne themi: “Ju keni qenë Shpëtimtari im (shpëtimi); tani unë përkulem në gjunjë dhe të bëj Perëndinë tim (shenjtërimi)”. Ne jemi veçuar për një qëllim të shenjtë dhe dashuria e përsosur e Perëndisë fillon të rrjedhë përmes nesh. Ne fillojmë ta duam Perëndinë me të vërtetë me gjithë zemrën, mendjen dhe forcën tonë dhe të afërmin tonë si veten tonë.

Shenjtërimi i plotë i përkufizuar

Disa fjalë të fundit mbi atë që nënkuptohet me shenjtërim të plotë. “I tërë” nuk i referohet një veprë të përfunduar të Perëndisë në ne, por në një kuptim shumë real, është plotësi. Perëndia punon vazhdimisht brenda nesh dhe mbi ne, kështu që në atë kuptim, kryevepra e jetës sonë po vazhdon deri në ringjalljen përfundimtare të të gjitha gjërave, përfshirë lavdërimin tonë.³⁸

36. C. S. Lewis, *Mere Christianity* (New York: Touchstone, 1996), 175–76.

37. Për herë të parë dëgjova Denis Kinla (*Dennis Kinlaw*) të përdorte këtë shprehje në një predikim të kishës së seminarit në vitin 1991. Ishte gjithashtu hera e parë që mbaj mend të kuptoj se kontrolli i Perëndisë mbi jetën time nuk ishte një dëshirë për manipulim nga ana e Perëndisë, por një dëshirë e madhe për intimitet. Sipas vlerësimit tim, Kinla ishte një nga predikuesit më të mirë të Shenjtërisë së fundit të shekullit XX dhe fillimi i shekullit XXI, deri në vdekjen e tij në vitin 2017.

38. “Lavdërimi” i referohet gjendjes së një besimtari pas vdekjes dhe ringjalljes përfundimtare të të gjitha gjërave. “Përmes hirit të Perëndisë ne në fund të fundit do të përlëvdohemi, do të ringjallemi me Krishtin kur Ai të kthehet dhe do të shndërrohem në ngjashmërinë e Tij të plotë, për të shijuar lavdinë e Tij përgjithmonë.” Greathouse and Dunning, *An Introduction*

Ne jemi të plotë dhe po aq “plotësisht të kompletuar” me anë të hirit shenjtërues, saqë mund të jemi në atë moment. Jetët tona janë të shënuara nga shkëlqimi i hollë i shalomit. *Shalom* është ajo që Perëndia po koncepton në krijimin dhe modelimin në jetën tonë. *Shalom* sigurisht do të thotë paqe, por gjithashtu do të thotë tërësia, plotësia, uniteti dhe çdo pjesë që vepron në harmoni me qëllimin (*telos*) për të cilin jemi krijuar.

Shenjtërimi i tërë, siç diskutuam tashmë, është një jetë e tërë e heqjes dorë nga ekzistenca egoiste (mishi) dhe nënshtrimit të vazhdueshëm të bindjes jorezistente ndaj mënyrave dhe vullnetit të Perëndisë. Siç tha Jezusi me shumë saktësi: “Nëse dikush do të vijë pas meje, le ta mohojë vetveten, ta marrë çdo ditë kryqin e vet dhe të më ndjekë.” (Luka 9.23).³⁹ Rezultati i një jete të tillë me qendër kryqin është ngjashmëria me Krishtin që shfaqet në dashurinë e përsosur për Perëndinë dhe të afërmin.

Neni i dhjetë i Besimit për Kishën e Nazaretasit artikulon shenjtërimin kështu:

Ne besojmë se shenjtërimi i plotë është ai veprim i Perëndisë, pas rilindjes, me anë të të cilit besimtarët lirohen nga mëkati fillestar ose shthurja, dhe janë sjellë në një gjendje të përkushtimit ndaj Perëndisë dhe bindja e shenjtë e dashurisë së përsosur.

Është realizuar nga pagëzimi me Frymën e Shenjtë ose mbushja me Të, dhe nënkupton në një përvojë pastrimin e zemrës nga mëkati dhe praninë e qëndrueshme, brendabanuese të Frymës së Shenjtë, që fuqizon besimtarin për

to *Wesleyan Theology*, 54. Për më tepër, Diane LeKlerk i referohet lavdërimit si shenjtërimi përfundimtar në atë “që një person të hiqet nga prania e mëkatis”. LeClerc, *Discovering Christian Holiness*, 318.

39. Në lidhje me idenë se shenjtërimi i plotë nënkupton një jetë të tërë të vetëmohimit (mishit) dhe të marrjes së kryqit, “J. O. McClurkan, udhëheqës i njëres prej degëve jugore të Lëvizjes së Shenjtë të hershme, iu referua këtij aspekti të fundit të jetës së shenjtëruar si “një vdekje më e thellë për veten”, e cila në realitet duhet të ndodhë gjatë gjithë jetës së krishterë. Nga përvoja, ai e njohu se jo e gjithë jeta mund të ngjeshet në një përvojë momentale. “Dunning, *Pursuing the Divine Image*, Kindle Location 853. For further discussion of this, see William J. Strickland and H. Ray Dunning, *J. O. McClurkan: His Life, His Theology, and Selections from His Writings* (Nashville: Trevecca Press, 1998).

jetën dhe shërbimin. Shenjtërimi i plotë sigurohet nga gjaku i Jezusit, kryhet menjëherë nga hiri përmes besimit, i paraprirë nga shenjtërimi i plotë; dhe për këtë vepër dhe gjendje hiri dëshmon Fryma e Shenjtë.

Ne besojmë se hiri i gjithë shenjtërimit përfshin impulsin hyjnor për t'u rritur në hir si një dishepull i ngjashëm me Krishtin. Sidoqoftë, ky impuls duhet të ushqehet me vetëdije dhe t'i kushtohet vëmendje e kujdesshme kushteve dhe proceseve të zhvillimit shpirtëror dhe përmirësimit të ngjashmërisë me karakterin dhe personalitetin e Krishtit. Pa një përpjekje të tillë të qëllimshme, dëshmia e dikujt mund të dëmtohet dhe vetë hiri të dështojë dhe përfundimisht të humbasë.

Duke marrë pjesë në mjetet e hirit, veçanërisht bashkësinë, disiplinat dhe sakramentet e kishës, besimtarët rriten në hir dhe në dashuri me gjithë zemër ndaj Perëndisë dhe të afërmit.⁴⁰

Ne duhet ta përfundojmë diskutimin tonë për shenjtërimin e hirit me një pyetje të thjeshtë: Për çfarë qëllimi? Pse është e nevojshme kjo shenjtëri e dëshiruar? Cila do të jetë dëshmia e një jete të shënjuar nga një ngjashmëri e tillë me Krishtin?

Ne i kthehemi dashurisë së përsosur. Shenjtërimi i plotë nuk është kulmi i moralit. Është forma më e lartë e dashurisë vetëdhuruese. Shenjtërimi i plotë është dashuria e shenjtë e bërë e plotë në ne. Se Uesli përcaktoi shenjtërimin e plotë si dashuri të përsosur, dihet mirë. Ishte përmbajtja e veçantë e mësimin të tij mbi shenjtërinë. Mildred Bengs Uajnkup e argumenton këtë, duke pretenduar se: "Diskutimet e Ueslit për çdo segment të së vërtetës së krishterë e çuan atë shpejt në dashuri. 'Perëndia është dashuri.' Çdo aspekt i shlyerjes është një shprehje e dashurisë; shenjtëria është dashuri; kuptimi i 'fesë' është dashuria. Përsosmëria e krishterë është përsosmëri e dashurisë. Çdo hap i Perëndisë drejt njeriut dhe përgjigjja e njeriut, hap pas hapi, është një aspekt i dashurisë."⁴¹ Për ta theksuar këtë argument, Uajnkup shton: "Të thuash se

40. Church of the Nazarene, *Manual: 2017–2021*, "X. Christian Holiness and Entire Sanctification" (Kansas City, MO: Nazarene Publishing House, 2017), 31–32.

41. Mildred Bangs Wynkoop, *A Theology of Love: The Dynamic of Wesleyanism* (Kansas City, MO:

shenjtëria e krishterë është *raison d'être* [arsyeja për të qenë] është të thuash se jemi të përkushtuar ndaj gjithçkaje që dashuria është, dhe ky është me të vërtetë një urdhërim i madh.⁴²

Me pak fjalë, dashuria është thelbi i çështjes. Çdo gjë më pak se dashuria nuk plotëson standardin e lartë të vendosur për “arsyen e të qenit” të një jete të shenjtë. Çdo kuptim i shenjtërimit të plotë pa dashuri është i ashpër, legalist, gjykues dhe jo i shenjtë. Agape (dashuria e krishterë) është dashuria që mban të gjitha dashuritë e tjera natyrore në rendin e tyre të duhur.⁴³ Agape udhëzon, interpreton dhe kontrollon të gjitha dëshirat e tjera. Meqenëse jemi të inkurajuar të rritemi në agape, ne e kuptojmë që jepet dhe përmirësohet; është një dhuratë dhe rritet në ne nga prania e qëndrueshme e Frymës së Shenjtë. Nevojitet përpjekje, por hiri sigurohet.

Ne tërhiqemi nga dashuria e shenjtë përmes hirit që na kërkon (paraprirës). Ne jemi kapur nga dashuria e shenjtë përmes hirit shpëtues. Ne jemi pastruar dhe veçuar nga dashuria e shenjtë përmes hirit shenjtëruës. Ne rritemi në hir ndërsa teprojmë në dashuri të shenjtë. Kështu e përjetojmë plotësinë e jetës në Krishtin.

Beacon Hill Press of Kansas City, 1972), 36.

42. Wynkoop, *A Theology of Love*, 36.

43. Për një përmbledhje ndriçuese të katër termave greke për dashuri – *eros*, *storge*, *philia* dhe *agape* – unë i rekomandoj shumë shpjegimet e shkurtra të Uajnkup nën titullin “Love and Fellowship.” Ai argumenton se të gjitha, përveç *agape*-së, janë dashuri natyrore, që nuk kërkojnë shumë përpjekje. *Agape*-ja nuk është vetëm një dimension i ndryshëm i dashurisë, por është gjithashtu një cilësi me të cilën dikush urdhëron jetë, e bërë e mundur vetëm nga plotësia e Krishtit. “Dashuria që ne e quajmë dashuri e krishterë, pra, nuk është zëvendësuese e dashurive të tjera, as nuk është një shtesë e atyre dashurive, por është një cilësi e të gjithë personit pasi përqendrohet në Krishtin. Vetëorientimi shtrembërues, i cili cënon të gjitha marrëdhëniet e tjera, sepse i përdor ato për përfitim personal (shpesh në mënyrat më delikate dhe të pahijshme), është sjellë në plotësinë e tij nga prania e qëndrueshme e Frymës së Shenjtë. Në këtë marrëdhënie, të gjitha marrëdhëniet e tjera të jetës përmirësohen dhe zbukurohen dhe bëhen të shenjta”. Wynkoop, *A Theology of Love*, 38.

5

HIRI QË NA MBAN

Dhe Atij që mund t'ju ruajë nga çdo rrëzim dhe t'ju nxjerrë para lavdisë së Tij të paqortueshëm dhe me gëzim, të vetmit Perëndi të ditur, Shpëtimtarit tonë, i qoftë lavdi, madhështi, sundim dhe pushtet, tani dhe përjetë. Amen. Amen.

Juda 1.24-25

Vjen një pikë në jetën e çdo të krishteri kur diçka fillon të agojë mbi ta. Ndonjëherë ndodh menjëherë e ndonjëherë ndodh më tej përgjatë udhëtimit të hirit; aspekte të jetës sime mbeten të padorëzuara ndaj sundimit të Krishtit. Ka dhoma në shtëpinë time që po rimodelohet (për t'u kthyer në ilustrimin e C. S. Luis) që qëndrojnë të mbyllura ndaj punës së Perëndisë.

Meqenëse Perëndia i është përkushtuar vazhdimisht shenjtërisë sonë, duke na bërë gjithnjë e më shumë si Jezusi, Fryma e Shenjtë fillon të hetojë: “A është gjithçka e imja? A më përket Mua çdo pjesë e jotja? A ka ndonjë gjë që po e mbani?”

Përgjigja jonë e parë mund të jetë: “Ju mund të keni gjithçka përveç (plotësoni zbraztirën). Unë ju kam dhënë 99 përqind të vetes sime. A nuk ka asgjë që mund të mbaj për veten time? A pret të të jap gjithçka?”¹

1. “Ruhuni nga të menduarit: ‘Oh, ajo gjë në jetën time nuk ka shumë rëndësi.’ Fakti që nuk ka shumë rëndësi për ju mund të nënkuptojë se ka shumë rëndësi për Perëndinë. Asgjë nuk duhet të konsiderohet si çështje e parëndësishme nga një fëmijë i Perëndisë. Asgjë në jetën tonë nuk është thjesht një detaj i parëndësishëm për Perëndinë”. *Chambers, My Utmost for His Highest*, 76-77.

Me dashuri të duruar dhe përkushtim të patundur për të përmbushur qëllimin përfundimtar (telos) të dishepullimit tonë, Fryma e Jezusit pëshpërit: “Po, të gjithë veten tënde. Njëqind për qind. Të mos mbash asgjë”.

Të jesh plotësisht i Perëndisë do të thotë të marrësh pjesë në të gjithë jetën e premtuar të Perëndisë. Ndërsa më shumë nga vetja jonë i lirohet Perëndisë, kështu vijon paqja dhe gëzimi më i madh. Osuald Chambers, beson se jeta e përjetshme nuk është një dhuratë nga Perëndia, por një dhuratë e Perëndisë. Më tej, fuqia shpirtërore që Jezusi u premtoi dishepujve pas ringjalljes së Tij dhe në pritje të Rrëshajave, nuk është një dhuratë nga Fryma e Shenjtë, por fuqia është Fryma e Shenjtë (Veprat e Apostujve 1.8). Rezultati është një sigurim i pafund i jetës së bollshme që rritet me çdo lirim ndaj Perëndisë. Përsëri, brendësia e Chambers është ndriçues: “Edhe shenjtori më i dobët mund të përjetojë fuqinë e hyjnisë së Birit të Perëndisë, kur ai është i gatshëm për t’u ‘dorëzuar’. Por çdo përpjekje për të ‘mbajtur’ një grimcë të vogël të fuqisë sonë, vetëm sa do të zvogëlojë jetën e Jezusit në ne. Ne duhet të vazhdojmë të dorëzojmë ngadalë, por të sigurt, jeta e madhe e plotë e Perëndisë do të na pushtojë, duke depërtuar në çdo pjesë”.²

Zemra njerëzore është vend i mëkatit dhe mosbindjes, por është gjithashtu vend i hirit dhe shenjtërisë. Në hirin që na kërkon, Perëndia përpiket të fitojë zemrat tona; në hirin shpëtues Perëndia na rrëmben zemrën; në hirin shenjtërues, Perëndia pastron zemrën tonë. Prirja jonë lëviz nga zemra e një shërbëtori në zemrën e një fëmije. Zbulojmë se nuk i shërbejmë më Perëndisë nga frika se çfarë mund të ndodhë nëse nuk bindemi; përkundrazi, na është dhënë një zemër dashurie që na jep një dëshirë për t’iu bindur. Sidoqoftë, mos u gaboni: pretendimi i Krishtit gjatë gjithë udhëtimit të hirit nuk është për asgjë më pak se të gjithë veten tonë – i tërë, i plotë, i tërësishëm.

Shenjtëri do të thotë të veçohesh për një qëllim të shenjtë dhe të mbushesh aq shumë me Frymën e Jezusit, saqë mendja, motivet dhe qëndrimet tona janë të ngjashme me Krishtin. Ne e mohojmë veten, që do të thotë se heqim dorë nga

2. Chambers, *My Utmost for His Highest*, 74–75.

e drejta për “mua”. Ne e marrim kryqin tonë, që do të thotë se ia transferojmë të drejtat tona Jezusit. Ja një paradoks befasues: duke hequr dorë nga e drejta për “mua” dhe duke transferuar të drejtat tona tek Jezusi, ne gjejmë jetë. Kur e humbasim jetën tonë në Krishtin, ne e gjejmë atë. Ajo që nuk i është dorëzuar Perëndisë ka humbur përfundimisht; ajo që i dorëzohet Perëndisë nuk mund të merret. “Sepse ju keni vdekur dhe jeta juaj është e fshehur me Krishtin në Perëndinë” (Kolosianëve 3.3). Shenjtërimi është i plotë.

Shenjtërimi ynë ndaj Perëndisë nuk është burimi i shenjtërimit tonë. Ne nuk mund ta shenjtërojmë veten; ne nuk e bëjmë veten tonë të shenjtë. Fryma e Jezusit e bën këtë. Nuk mjafton të duash të jesh si Jezusi. Dëshira nuk është e mjaftueshme, dhe imitimi do të shkojë vetëm deri diku. Ne duhet të kemi në vetvete Frymën e Jezusit, ose siç thotë Pali, Krishti duhet të formohet tek ju (Galatasve 4.19).

Në shumë aspekte, farisenjtë ishin njerëzit më të mirë të kohës së Jezusit. Ata ishin të moralshëm, ishin të pastër dhe ishin të mirë. Sidoqoftë, mirësia e tyre ishte vendosur në ndryshimin e sjelljes dhe në përpjekjet e tyre për të qenë të shenjtë përmes një sistemi të menaxhimit të mëkatit, që nuk merrej kurrë me zemrat e tyre. Ata donin të ishin të perëndishëm dhe të bënë jetë të pastra, por vetëmohimi i tyre doli të ishte vetshërbyes dhe kryqbartja e tyre i bëri ata më pak të dashur. Dikush mund të menaxhojë pjesën e jashtme vetëm për aq kohë para sa të marrë kontrollin brendia. Siç u përmend më parë, gjithçka që është në zemrën tuaj dikur ka për të dalë. I krishteri farise, ai që përpiqet të bëjë një jetë të shenjtë me përpjekje të drejtuar nga vetja dhe me mish, gjithmonë ka për të rënë nga dashuria e përsosur, sepse nuk mjafton të duash të jesh si Jezusi. Fryma e Jezusit duhet të jetë në ne. Ky është thelbi i shenjtërisë së zemrës. Hiri është i nevojshëm për të fuqizuar, mundësuar dhe drejtuar një jetë të shenjtë.

Dallas Uillard shpjegon se jeta e shenjtë në të vërtetë kërkon më shumë hir se çdo përpjekje për të imituar Jezusin përmes ndërmarrjeve të vetëdrejtuar: “Nëse vërtet do të dëshironit të konsumonit hir, thjesht bëni një jetë të shenjtë. Shenjtori i vërtetë djeg hirin ashtu si një aeroplan 747 djeg karburant në ngjitje.

Bëhuni lloji i personit që rregullisht bën atë që bëri dhe tha Jezusi. Ju do të konsumoni shumë më shumë hir duke bërë një jetë të shenjtë, sesa do të bënit duke mëkatuar, sepse çdo veprim i shenjtë që bëni do të duhet të mbështetet nga hiri i Perëndisë. Dhe kjo mbështetje është plotësisht favor i pamërituar i Perëndisë në veprim”.³ Ne duhet të kemi mbështetjen e pandërprerë të hirit mbështetës të Perëndisë – hirit që na mban të mos biem (Juda 1.24).

Pavarësisht kësaj, hiri i qëndrueshëm nuk e mohon nevojën për pjesëmarrjen tonë. Në kapitullin 4, ne pamë që hir do të thotë se Perëndia ka bërë gjithçka që nuk mund të bënim për veten tonë, por nuk do të thotë që ne tani bëhemi “konsumatorë të hirit” që nuk kontribuojnë asgjë në marrëdhënie. Ne bashkëpunojmë me hirin aktiv të Perëndisë duke renditur jetën tonë rreth atyre aktiviteteve, disiplinave dhe praktikave që Jezusi modeloi. Ne marrim pjesë në to jo për të fituar shenjtërimin tonë, por për të arritur përmes ushtrimit të asaj që nuk mund të bëjmë duke u përpjekur më shumë.

Drejtësia e dhënë

Ndoshta disa fjalë për ndryshimin midis drejtësisë së llogaritur dhe asaj të dhënë do të jenë të dobishme. Sipas Diane LeKlerk, drejtësia e dhënë është “drejtësia e Jezusit që i është atribuar të krishterit, e cila më pas i mundëson të krishterit të shfajësohet. Perëndia e sheh personin përmes drejtësisë së Krishtit, por nuk flet për transformimin e brendshëm dhe pastrimin e individit nga Perëndia”. Drejtësia e llogaritur, nga ana tjetër, është “një dhuratë e hirshme e Perëndisë e dhënë në momentin e rilindjes së një individi. Perëndia fillon procesin për të na bërë të shenjtë”.⁴

Dallimi midis të dyjave nuk është aq delikat sa mund të mendoni. Njëra është një drejtësi e llogaritur, e zbatuar, si të thuash; tjetra është një drejtësi e dhënë që banon brenda. Drejtësia e llogaritur mund të kuptohet si dhuratë e

3. Willard, *The Great Omission*, 62.

4. LeClerc, *Discovering Christian Holiness*, 312. Kjo është arsyeja pse Xhon Uesli i referohej rilindjes si shenjtërimi fillestar. Ndërsa nuk e mohon tjetrën, tradita e Reformuar tenton të vërë theksin në drejtësinë e llogaritur, ndërsa teologjia e Shenjtërisë Uesliane, vë theksin kryesor në drejtësinë e dhënë.

Perëndisë që mundëson dhe fuqizon një dishepull të Krishtit të përpiket për shenjtëri, shenjtërim dhe dashuri të përsosur. Më saktësisht, Timoti Tenent (*Timothy Tennent*) e kap mirë ndryshimin: “Si të krishterë, ne e dimë që Perëndia i merr mëkatarët dhe i vesh me drejtësinë e Krishtit (të llogaritur). Atëherë Perëndia vepron në ne çdo vepër të mirë, në mënyrë që drejtësia që na ishte imponuar dikur thjesht, të bëhej në kohë reale, të na jepej në masa gjithnjë në rritje.”⁵

Optimizmi i hirit

Drejtësia e dhënë është ajo që e bëri Xhon Ueslin tërësisht optimist për potencialin e transformimit. Duke njohur plotësisht shkatërrimin e mëkatit fillestar, Uesli nuk ishte optimist për natyrën njerëzore. Sidoqoftë, ai ishte plotësisht i bindur se hiri i Perëndisë mund të transformonte fjalë për fjalë një jetë nga brenda jashtë.

Një herë dëgjova mikun tim Uesli Trejsi (*Wesley Tracy*) duke iu referuar atij si “optimizmi radikal i hirit”. Për ta ilustruar, ai më tregoi një histori: Pyrfytyroni një vajzë të vogël që hyn në pjesën e pasme të kishës. Ajo është njëmbëdhjetë ose dymbëdhjetë vjeçare. Rrobat e saj janë të pista dhe flokët të pakrehura, të hollë dhe të lëmuar poshtë. Ajo mban erë myku, sikur të mos ketë bërë një banjë të vërtetë për më shumë se disa ditë. Ju dini pak nga historia e saj. Shkolla nuk po shkon mirë; ajo po mbetet prapa në mësimet e saj dhe nuk po merr nota kaluese. Jeni mjaft të sigurt që problemi nuk është intelekt i saj, por ka shumë të ngjarë, të ketë të bëjë me atë që po ndodh në shtëpi. Ajo nuk e njeh babanë e saj biologjik dhe nëna e saj ka pasur disa të dashur bashkëjetues. Ka zëra për abuzim të fëmijëve pas dyerve të mbyllura dhe mavijosjet në krahët e saj duket se e konfirmojnë atë.

Trejsi më pas tha: “Një psikolog do ta shikonte atë vajzë të re dhe do të

5. Timothy Tennent, “Living in a Righteousness Orientation: Psalm 26” Seedbed Daily Text, September 1, 2019, <https://www.seedbed.com/living-in-a-righteousness-orientation-psalm-26/>. Tenent shton: “Vetëm në krijimin e ri kjo është bërë tërësisht e plotë, por shenjtërimi është thirrja e çdo besimtari – për t’u veçuar si i shenjtë, në mënyrë që me zemra të plota, të mund të lëvdojmë Perëndinë “në kuvende” (Psalmi 26.12)

thoshte: ‘Ajo është përjetësisht e plagosur; përgjithmonë e ngatërruar. Disa gjëra janë të riparueshme, por ajo gjithmonë do të ecë me një çalim dhe nuk do të mund të jetë kurrë gjithçka që mund të kishte qenë nëse mjedisi i saj do të ishte ndryshe.’ Kështu do të thoshte një psikolog.” Por Trejsi vazhdon: “A e dini se çfarë do të thoshte dikush që beson në optimizmin radikal të hirit? ‘Pavarësisht se çfarë i është bërë asaj ose çfarë i bën ajo vetes, ajo vajzë e vogël ka shpresën e ungjillit. Perëndia mund ta marrë atë nga aty ku është dhe ta bëjë atë siç Ai dëshiron të jetë. Ose, siç mund të shprehej Uesli” Më trego të mjerin më të ndyrë në të gjithë Londrën, dhe unë do të të tregoj dikë që ka gjithë hirin e vetë apostujve.”

Ky optimizëm e merr seriozisht gjendjen tonë mëkatore, por duhet edhe më seriozisht fuqia e hirit për të marrë këdo, nga kudo, nga çdo gjë, dhe për ta bërë atë gjithçka që Perëndia dëshiron që ata të jenë.⁶ Asnjë dhimbje nuk është aq e dhimbshme, asnjë lëndim nuk është aq i lëndueshëm, asnjë plagë nuk është aq e thellë, asnjë mëkat nuk është aq i tmerrshëm sa që hiri i Perëndisë nuk mund ta transformojë, shërojë dhe të mos e bëjë të tërë përsëri.

Falja dhe fuqia

Udhëtimi i hirit është transformimi i të gjithë personit. Drejtësia është dhënë; shenjtëria është dhënë. Nuk është “përpikuni më shumë” ose “mblidhe mendjen”, por një ndryshim i vërtetë që rezulton në një jetë të fuqizuar. E thënë ndryshe, hiri i Perëndisë është i nevojshëm për falje dhe fuqi. Ne kemi nevojë për faljen e mëkateve tona (pardon) dhe ne kemi nevojë për forcë (fuqi) për të jetuar një jetë që nderon Perëndinë. Njëra pa tjetrën çon në ekstreme të rrezikshme. Nëse themi: “Perëndia do të na falë, por Atij nuk i intereson vërtet se si e jetojmë jetën tonë të papërsosur sepse, në fund të fundit, e gjitha është e mbuluar me hir”, ne jemi në rrezik të antinomianizmit. Në të kundërt, nëse supozojmë se hiri është i nevojshëm vetëm për të falur mëkatet tona, por atëherë

6. “Siç do të thoshte Uesli, të mohosh një optimizëm të tillë do ta bënte fuqinë e mëkatit më të madhe se fuqinë e hirit, një opsion që duhet të ishte i paimagjinueshëm për një teologji të Shenjtërisë Uesliane.” LeClerc, *Discovering Christian Holiness*, 27.

na takon neve ta marrim timonin nga atje, ne jemi në rrezik të legalizmit. Të dyja janë ekstreme të rrezikshme që janë pengesa në udhëtimin e hirit. Apostulli Pal u flet këtyre dy ekstremeve kur thotë: “Punoni për shpëtimin tuaj me frikë e me dridhje, sepse Perëndia është Ai që vepron në ju vullnetin dhe veprimtarinë, sipas pëlqimit të Tij” (Filipianëve 2.12–13). Kush është përgjegjës për rritjen tonë shpirtërore? A është puna jonë apo puna e Perëndisë? Përgjigja e Palit është po për të dyja, dhe kjo nuk është një kontradiktë.

Konsideroni ekstremën e legalizmit. Legalizmi në përkufizimin e tij më të rreptë teologjik është nocioni i mbivlerësuar se bindja ndaj rregullave, rregulloreve dhe kodeve të veçanta të sjelljes është i nevojshëm për shpëtimin. Praktikisht, legalizmi thotë; ne e dimë që Perëndia ka siguruar shpëtimin tonë përmes kryqit të Jezusit, por nëse ai aktualizohet ndonjëherë në jetën tonë, varet nga fakti nëse lutemi shumë, lexojmë Biblën tonë çdo ditë dhe jemi të kujdesshëm për të shmangur njerëz dhe vende të caktuara. Në thelb të tij, legalizmi po përpiqet të bëjë për veten tonë atë që vetëm Perëndia mund të bëjë. Rezultati i një personi të prirur për të mbajtur rregullat, është një sasi e madhe faji, frike, zhgënjimi dhe pasigurie me shumë pak hir, paqe ose siguri. Është një dishepullim pa hir dhe nëse çohet në ekstremën e tij më të largët, bëhet një formë e pakapshme e humanizmit të vetëdrejtë dhe një ndjesi epërsie. Legalistët kanë pritshmëri të mëdha për veten e tyre, por standarde edhe më të larta për të gjithë të tjerët, gjë që nuk është tërheqëse dhe i largon ata që janë të larguar nga kisha.

Në kontrast me legalizmin është ekstremi i kundërt i antinomianizmit. Antinomianizmi është një fjalë teknike që buron nga dy fjalë greke: *anti*, që do të thotë “kundër” dhe *nomos*, që do të thotë “ligj”. Kombinuar, ajo shpreh idenë e paudhësisë. Ndërsa është e vërtetë dhe ne kemi kaluar shumë kohë duke argumentuar këtë pikë që një i krishterë shpëtohet vetëm me hir dhe jo me vepra të mira ose me veprimet tona, kjo e vërtetë nuk na çliron nga detyrimet morale dhe shpirtërore. Duke folur praktikisht, personi antinomian thotë: “Meqë hiri është i tepërt, pse të mos mëkatoj edhe më tepër që të marr edhe

më shumë hir? Meqenëse jam i mbuluar nga hiri, nuk jam i detyruar t'i bindem asnjë standardi etik ose moral. Jam çliruar nga barra e përgjegjësisë. Dashuria i mbulon të gjitha”. Sado e palogjikshme (dhe jopraktike) mund të tingëllojë, ajo është mendësia e disa të krishterëve. “Mos më kërkoni ndonjë përkushtim serioz ose vetëmohim. Unë kam hequr dorë nga vendosja e një barre të rëndë shpirtërore mbi shpatullat e kujtdo, sepse kjo thjesht çon në faj të modës së vjetër dhe legalizëm. Unë jam në hir.”⁷ Veçanërisht, megjithëse Xhon Uesli nuk ishte legalist, ai besonte se mënyra antinome e të menduarit përbënte një rrezik edhe më të madh se legalizmi dhe e konsideroi antinomianizmin më të keqen nga të gjitha herezitë, sepse zhvlerësonte dashurinë e përsosur. Dashuria pa shenjtëri është lejuese; shenjtëria pa dashuri është e ashpër.

Në vitin 1751, Xhon Uesli i shkroi një letër shokut, ku shumica besojnë në përgjigje të akuzave se predikimi i tij ishte ose shumë legalist, ose shumë lejues (antinomian). Përgjigja e tij ishte udhëzuese: “Unë nuk do të këshilloja të predikohej ligji pa ungjill më shumë sesa ungjilli pa ligj. Padyshim, të dy duhet të predikohen në radhët e tyre; po, të dy menjëherë, ose të dy në një “. Uesli përmbledh atë që ai do të thotë me “të dy në një” të mbajtur në tension: “Perëndia të do; prandaj duajeni dhe bindjuni Atij. Krishti vdiq për ty; prandaj vdis për mëkat. Krishti u ringjall; prandaj ngjallu në shëmbëlltyrën e Perëndisë. Krishti jeton përherë; prandaj jeto për Perëndinë derisa të jetosh me Të në lavdi. ... Kjo është mënyra biblike, mënyra metodiste, mënyra e vërtetë. Dashed Perëndia që të mos kthehemi prej kësaj, në të djathtë ose në të majtë.”⁸

Pra, cila qëndron? Shpëtimi dhe rritja jonë shpirtërore është detyra e Perëndisë apo puna jonë? Pali e bën të qartë: nuk është “ose... ose” por “që të dyja ... dhe”. Shpëtimi i plotë është puna e Perëndisë nga fillimi në fund. Ne jemi kërkuar, shpëtuar, shenjtëruar dhe mbështetur nga hiri i Perëndisë. Sidoqoftë,

7. Në një bisedë me Ueslin, Klif Sanders (Cliff Sanders) në lidhje me legalizmin dhe antinomianizmin, Sanders bëri një argument interesant: “Pesëdhjetë vjet më parë, legalizmi ishte sfida më e madhe për kishat ungjillore. Sot ka më shumë të ngjarë antinomianizmi, si luftë e veçantë e shumë të rinjve të rritur që janë rritur në kishë dhe duan të lënë të shenjtën jashtë dashurisë.”

8. John Wesley, “Letter on Preaching Christ,” *The Works of the Rev. John Wesley*, Volume 6.

ne gjithashtu këshillohemi, për të bërë çdo përpjekje për të bashkëpunuar me veprën e Frymës së Shenjtë në jetën tonë (Luka 13.24; Filipianëve 2.12–13; 2 Timoteut 2.15; Hebrenjve 12.14; 2 Pjetrit 1.5–7; 3.13–34).⁹

Hiri është edhe për faljen, dhe për fuqinë. Kjo është mënyra se si hiri mbajtës kontribuon në dishepullimin tonë në partneritetin hyjnor njerëzor. Perëndia inicon, ne përgjigjemi. Perëndia thërret, ne dëgjojmë. Perëndia udhëzon, ne bindemi. Perëndia fuqizon, ne punojmë. “Së pari, Perëndia punon; prandaj mund të punosh”, tha Uesli. “Së dyti, Perëndia punon; prandaj duhet të punosh.”¹⁰

Domosdoshmëria e vullnetit të lirë

Tema e këtij kapitulli është hiri mbajtës, i cili është hiri që na aftëson të bëjmë atë që Perëndia na thërret për të bërë dhe të jetojmë jetë të shenjtë. Libri i Dhjatës së Re, Juda, i referohet këtij hiri, në uratë, si fuqia e Perëndisë që na mban të mos biem dhe na bën të qëndrojmë të patëmetë para Tij në ditën e fundit. Një deklaratë e tillë komunikon një të vërtetë shumë të rëndësishme për dishepullimin tonë: ne mund të biem nga hiri, por hiri mbajtës i Perëndisë e bën të mundur që të mos biem.

Dikur ishte një kohë kur disa predikues qëllim mirë të shenjtërisë, thanë që sapo të shenjtërohej një person, ai nuk do të mëkatonte më kurrë. Kjo shpallje gjeneroi shumë hutim dhe shqetësim midis të krishterëve të sinqertë që ishin të apasionuar pas ecjes së tyre me Krishtin, por që zbuluan se jo vetëm që ishte e mundur të pengohesh dhe të biesh, por që bëhej me një farë shpeshësie, veçanërisht në dritën e mesazheve që u thuhej atyre se shenjtërimi i plotë do të zgjidhte problemin. Thjesht nuk është kështu, arsyeja është që vullneti ynë i lirë nuk hiqet kurrë nga ekuacioni. Vullneti i lirë mbetet përgjithmonë në jetën e një besimtari, sepse bazohet në domosdoshmërinë e marrëdhënies. Dashuria është ndërvepruese dhe zgjedhja është një përbërës i domosdoshëm

9. Shikoni theksin e kapitullit 2 mbi “duke ushtruar në botë atë që Perëndia po punon në ne”.

10. John Wesley, “Sermon 85: On Working Out Our Own Salvation,” 3.2, <http://wesley.nnu.edu/john-wesley/the-sermons-of-john-wesley-1872-edition/sermon-85-onworking-out-our-own-salvation>.

i çdo marrëdhënieje të shëndetshme. Në fakt, shëmbëlltyra e Perëndisë është vulosur mbi ne, dhe ajo që po rikthehet në plotësinë e Krishtit, është aftësia për marrëdhënie të shenja dhe të dashura.

Historia e krijimit tek Zanafilla është ndriçuese. Një Perëndi sovran e krijon universin me një fjalë goje me pak më shumë përpjekje sesa fjalët e thëna: “U bëftë...”. Rregulli i Perëndisë është absolut dhe sundimi i Tij i pashembullt, megjithatë, çuditërisht, liria e njeriut është e ndërthurur në strukturën e krijimit. Duke pasur parasysh fuqinë e pakrahasueshme të Perëndisë për të krijuar dhe mbështetur, kjo liri është e papritur sepse, siç mësojmë më vonë, zgjedhjet e dallueshme të qenieve njerëzore jo vetëm që lejohen, por ato gjithashtu kanë potencialin për të ndihmuar ose dëmtuar lulëzimin e botës së mirë të Perëndisë. I Plotfuqishmi, duke rrezikuar shumë, lejon që zgjedhjet tona të kenë rëndësi.

Në parajsën e parë, Zoti Perëndi e urdhëroi njeriun: “Ha, bile lirisht nga çdo pemë e kopshtit, por mos ha nga pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes, sepse ditën që do të hash prej saj ke për të vdekur me siguri”. (Zanafilla 2.17). Fuqia për të zgjedhur ishte dhënë në urdhër. Në fillim, dikush mund ta konsiderojë këtë si të padrejtë nga ana e Perëndisë. Pse Perëndia do të urdhërojë diçka duke ditur që në momentin që ia thua dikujt atë që mund ose nuk mund të bëjë, është gjithçka që ata mund të mendojnë? A ishte ky një konfigurim për tundim? Jo! Perëndia nuk i tundoi ata. Atyre iu dha një zgjedhje. Të dy nuk janë njësoj. Në urdhërim është njohja e vullnetit të lirë (ose vullneti i liru).¹¹ Vullneti i lirë është i nevojshëm që dashuria të ekzistojë në një marrëdhënie.

Nëse gruaja ime do të detyrohej të më donte dhe nuk do të kishte zgjedhje në këtë çështje, ne do të kishim ende një lidhje, pak a shumë, por nuk do të ishte një martesë. Pse? Sepse po të isha në kontroll të plotë, do të bëhej diçka tjetër përveç dashurisë. Ajo do të bëhej një automat, një robot, i cili nuk mund

11. Mildred Bengs Uajnkup na kujton se theksi kryesor i Xhon Ueslit ishte më shumë në hiri të lirë, sesa në vullnetin e lirë. Prandaj, ata që janë në traditën Uesliane do të flisnin më saktësisht për “vullnetin e lirë”, i cili i referohet vullnetit të fuqizuar dhe të liru nga Fryma e Shenjtë, duke bërë të mundur që një person aktivisht të rrëfejë besimin në Jezus Krishtin. Gjatë gjithë rrugës, shpëtimi është i Perëndisë, vetëm nga hiri. Wynkoop, *Foundations of Wesleyan-Arminian Theology*, 69.

të vepronte vullnetarisht në ndonjë mënyrë tjetër. E vetmja mënyrë se si mund të kemi një martesë të shëndetshme, është nëse të dyve na është dhënë zgjedhja për të dashur tjetrin. Aty qëndron rreziku i natyrshëm i dashurisë: ajo mund të zgjedhë të mos më dojë mua.

Kur Perëndia i krijoi qeniet njerëzore, Ai i vendosi ata në një kopsht të bukur të mbushur me jetë dhe mirësi. Ishte hiri i pastër në atë që u iniciua dhe u dha nga Perëndia pa asnjë kontribut nga ana e tyre. Sidoqoftë, Perëndia nuk i bëri robotë që u detyruan të bënin vullnetin e Tij. Ata mund të zgjedhin midis së mirës ose së keqes. Ata kishin zgjedhjen për të dashur Perëndinë, ose jo. Ishte gati sikur Perëndia të thoshte: “Bëni këtë gjë, sepse unë jam Perëndia. Bindja juaj është një zgjedhje. Unë dua që kjo marrëdhënie të bazohet në dashuri, jo në kontroll”. Perëndia nuk na jep një vullnet të lirë sepse dëshiron të na tundojë, por sepse dëshiron që ne ta zgjedhim në kthim. Vetëm atëherë do të jetë një marrëdhënie vullnetare e rrënjosur në dashuri.

Soren Kierkegaard (*Soren Kierkegaard*) besonte se një vullnet i dorëzuar ishte shenja e një zemre të pastër: “Pastërtia e zemrës është të duash një gjë”. E kundërta e një zemre të pastër është mendja e dyfishtë, e pasqyruar edhe në vullnet. Përgjigjja nëse personi plotësisht i shenjtë mund të mëkatojë përsëri është “po”. Është e mundur të biesh nga hiri, sepse njeriu është gjithmonë i lirë t’i përgjigjet Perëndisë ose tundimit të afërt. Për hiri të dashurisë, zgjedhja do të jetë gjithmonë e jona. Megjithatë, këtu është ndryshimi kryesor i një jete të mbështetur në hiri: tani ne kemi fuqinë për të mos mëkatuar. Përmes fuqisë së hirit që na mban, ne mund t’i themi “po” Perëndisë dhe “jo” tundimit. Besimi ynë mbrohet nga fuqia e Perëndisë, e mbrojtur nga një shpresë e gjallë përmes ringjalljes së Jezus Krishtit nga të vdekurit (1 Pjetrit 1.3–4).

Në një rrëfim të drejtpërdrejtë, Pali pranon që para Frymës, mëkati kontrollonte jetën e tij aq fort, sa ishte si një mbikqyrës ndaj një skllavi. “Në fakt të mirën që unë dua nuk e bëj; por të keqen që s’dua, atë bëj” (Romakëve 7.19). Ai ishte kapur në ciklin vicioz të mosdashurit të bëj diçka, por të qenit i paafte për të rezistuar dhe të dëshirës për të bërë diçka, por duke mos qenë

në gjendje ta realizojë atë. “Oh, njeri i mjerë që jam! Kush do të më çlirojë nga ky trup i vdekjes?” (7.24). Tani që ai është nën fuqinë e Frymës së Shenjtë, vazhdon Pali, ai mund t’i thotë po Perëndisë dhe jo tundimit. “I falem nderit Perëndisë me anë të Jezus Krishtit, Zotit tonë! Sepse ligji i Frymës së jetës në Jezus Krishtin më çliroi nga ligji i mëkatit dhe i vdekjes.” (7.25; 8.2). Pa Frymën e Shenjtë, vullneti ynë njerëzor është i dobët dhe i pafuqishëm për t’iu bindur; me Frymën e Shenjtë, ne jemi të fuqizuar të bindemi. Nuk është se ata që janë të shenjtëruar nuk mund të mëkatojnë kurrë më, por tani ata kanë fuqinë për të mos mëkatuar. Dallimi është hiri mbajtës i Perëndisë që na mban të mos biem.

Besnikëria bazohet në besim dhe plotësi. Siç ishte Uesli i shpejtë për të shtuar, Shpirti i Shenjtë forcon vullnetin tonë, që të mund të prodhojmë “çdo dëshirë të mirë, qoftë në lidhje me temperamentin, fjalët ose veprimet tona, për shenjtërinë e brendshme dhe të jashtme”.¹²

Hiri mbajtës si transformimi i karakterit

Në librin e tij jashtëzakonisht të dobishëm dhe gjithëpërfshirës mbi dishepullimin, *After You Believe* N. T. Urajt tregon se si karakteri i ngjashëm me Krishtin formohet në persona dhe kisha. Ai i referohet asaj si rritje e gjatë, por e qëndrueshme e hirit që vjen si rezultat i praktikave shpirtërore dhe zakoneve të formuara në jetën e një personi, që i shndërron ata gjithnjë e më shumë në shëmbëlltyrën e Jezus Krishtit. Shkrimtarët e lashtë e quanin formimin e tillë të karakterit “virtyt”.

Urajt fillon librin duke ritreguar historinë e vërtetë të Çeslej Sullenberg (*Chesley Sullenberg*), i njohur më mirë si “Suli” (“Sully”). Ishte një e enjte pasdite, 15 Janar 2009 dhe ndihej si çdo ditë tjetër në qytetin e Nju Jork–ut. Avioni komercial u ngrit në 03.26 pasdite dhe u nis për në Sharlot (*Charlotte*). Suli ishte kapiten. Ai bëri të gjitha kontrollet rutinë dhe gjithçka dukej normale derisa, vetëm dy minuta pas ngritjes, aeroplani përplasi një tufë patash. Të dy motorët u dëmtuan rëndë dhe humbën fuqinë. Aeroplani po drejtohej në veri mbi Bronks, një nga pjesët më të populluara të qytetit. Suli dhe bashkëpiloti i

12. Wesley, “Sermon 85: On Working Out Our Own Salvation,” III.2.

tij duhej të merrnin vendime të shpejta e të rëndësishme. Jetët e më shumë se 150 udhëtarëve dhe mijëra të tjerëve në tokë, ishin në rrezik.

Aeroportet më të afërt më të vegjël ishin shumë larg, dhe ulja në Rrugën me pagesë të Nju Xhersit do të kishte qenë një katastrofë. Kjo u la atyre vetëm një mundësi tjetër: aterrimin në lumin Hadsën. Në vetëm tre minuta para uljes, Suli dhe bashkë-piloti i tij u deshën të bënë disa gjëra jetike për të mos u përplasur. (Urajt përmend nëntë detyra teknike dhe të ndryshme). Çuditërisht ata ia dolën; ata ulën aeroplanin në lumin Hadsën. Të gjithë zbritën të sigurt, me kapiten Sulin që ecte lart e poshtë midis rreshtave disa herë për të kontrolluar nëse të gjithë kishin shpëtuar para se të zbriste vetë.¹³

Shumë njerëz thanë se ishte një mrekulli dhe në një nivel të caktuar, sigurisht që ishte. Megjithatë, ku ishte mrekullia? Sepse mrekullitë vijnë në shumë forma të ndryshme. A ishte mrekullia në dorën e mbinatyrshme mbrojtëse dhe udhëheqëse të Perëndisë? Sigurisht që është e mundur. Sidoqoftë, ekziston një mënyrë tjetër për ta parë atë. Ndoshta mrekullia ishte virtyti i Sulit që e bëri atë të aftë të përgjigjej me një shpejtësi të tillë teknike nën presion të fortë. Nëse përdorimi i fjalës “virtyt” në këtë mënyrë duket i çuditshëm, kjo është për shkak se virtyti nuk është vetëm një mënyrë tjetër për të thënë “e mirë” ose “morale”. Urajt argumenton se virtyti, në kuptimin më rigoroz të fjalës, “është ajo që ndodh kur dikush ka bërë një mijë zgjedhje të vogla, që kërkojnë përpjekje dhe përqendrim, për të bërë diçka që është e mirë dhe e drejtë, por që nuk ‘vjen natyrshëm’ dhe më pas, në herën e një mijë e një-të, kur ka vërtet rëndësi, ata zbulojnë se e bëjnë atë që duhet ‘automatikisht’, siç themi ne.”¹⁴

Me fjalë të tjera, kur diçka duket sikur ajo “thjesht ndodh”, ne fillojmë të kuptojmë se ajo “nuk ndodhi thjesht”. Siç thekson Urajt, nëse ndokush prej nesh do të pilotonte aeroplanin atë ditë dhe të kishim bërë vetëm atë që vjen natyrshëm, do të ishim përplasur në anën e një ndërtese. Virtyti, formimi i karakterit ose për qëllimet tona dishepullimi, që rritet në hir për t’u bërë gjithnjë

13. Wright, *After You Believe: Why Christian Character Matters* (New York: HarperCollins, 2010), 18–20.

14. Wright, *After You Believe*, 20.

e më shumë si Jezusi, nuk është ajo që ndodh natyrshëm; është gjithashtu ajo që ndodh kur zgjedhjet e mençura dhe të gjykuara bëhen instiktive. Suli nuk lindi me aftësinë për të pilotuar një avion komercial, as nuk lindi me tiparet e karakterit që u zbuluan në momente të shkurtra kohore si; guximi, qetësia, arsyetimi i shpejtë dhe interesimi për sigurinë e të tjerëve duke rrezikuar veten e tij. Këto janë aftësi dhe tipare të fituara që kërkojnë praktikë specifike dhe përsëritje me kalimin e kohës, derisa ajo që fillimisht na duket e çuditshme fillon të ndihet normale, dhe pastaj ajo që ndihet normale fillon të jetë aq e ngulitur në mendjet dhe kujtesën tonë muskulore, sa të reagojmë në vend që të mendojmë. Është instiktive.

Nuk dua të fyej asnjë lexues që mund të jetë pilot, por nëse do të kisha qenë udhëtar në atë aeroplan që zbriste me shpejtësi të lartë, nuk do doja që një pilot fillestar të bënte atë që i vinte natyrshëm. Nëse do të duhej të nxirrnin manualin i motorit, të kontrollonin internetin ose të vrisnin mendjen për të kujtuar ato që kishin mësuar në shkollën për pilot për një emergjencë të tillë para se të mund t'i përgjigjeshin një krize me të cilën nuk ishin përballur kurrë më parë, rezultati mund të ishte shumë më ndryshe. Njohuritë nuk janë të mjaftueshme; as guximi dhe vendosmëria. Jo, Urajt ngulmon me forcë, ajo që duhej në atë moment krize ishte virtyti i praktikuar i diçkaje që ishte bërë instiktive; një transformim i karakterit, “formuar nga pikat e forta specifike, domethënë “virtytet”, e të diturit saktësisht se si të pilotosh një aeroplan.”¹⁵ Unë do të shtoja se nuk ishte thjesht ndonjë lojë, por ai aeroplan i caktuar, aeroplani që Suli ishte trajnuar ta njihnte nga afër në çdo detaj.

Ideja e “instiktives” tërheq vëmendjen time, veçanërisht sa i përket dishepullimit, shenjtërisë dhe udhëtimit të hirit. Pak vetë nuk do të pajtoheshin që cilësi të tilla si guximi, qëndrueshmëria, përmbytja, urtësia, gjykimi i mirë dhe durimi nuk vijnë natyrshëm tek ne. Ato janë gjëra që mësohen dhe nguliten në karakterin tonë, ndonjëherë përmes rrethanave të dhimbshme dhe të vështira, por gjithmonë përmes filtrit të sjelljeve të mësuara. Një karakter

15. Wright, *After You Believe*, 21.

i mirëthemeluar sipas Dhjatës së Re dhe siç përkufizohet nga Urajt – është “modeli i të menduarit dhe të vepruarit që depërton drejtpërdrejt në dikë, kështu që kudo që e ‘hap’ (si të thuash), do të shohësh të njëjtin person.”¹⁶

E kundërta e një karakteri të themeluar mirë natyrisht, është sipërfaqësia. Shumë njerëz mund ta paraqesin veten fillimisht si të ndershëm, të mirë e pozitiv, por sa më shumë që i njihni, aq më shumë shfaqen tiparet e tyre të vërteta. Njerëz të tillë thjesht po bëjnë një paraqitje të mirë. “Kur përballen me një krizë, ose thjesht kur nuk janë të vëmendshëm, ata janë po aq të pandershëm, të pakënaqur dhe të padurueshëm sa personi tjetër”.¹⁷ Cili është problemi? Ata thjesht po bëjnë atë që iu vjen natyrshëm; ata janë mjaft të vetëdijshëm për të ditur se qëndrimi i tyre duhet të jetë i ndryshëm, por ata nuk kanë fituar zakone të reja instiktive për të reaguar mirë ndaj sfidave dhe zhgënjimeve të papritura. Karakteri i dikujt nuk ndërtohet në një krizë; zbulohet në një të tillë. Kur nuk kemi kohë të mendojmë, kush jemi ne në të vërtetë zbulohet çdo herë.

H. Rej Daning (*H. Ray Dunning*) ka treguar se si disa nga termat e shekullit të tetëmbëdhjetë të Ueslit ndryshojnë nga përdorimi bashkëkohor. Për shembull, sa i përket diskutimit tonë mbi vullnetin e lirë, “liria” ishte termi që ai përdori për lirinë e zgjedhjes, ndërsa “vullneti” ishte termi që ai përdori për t’iu referuar atyre që ai i quajti “afeksione”, ose prirje që motivojnë veprimin njerëzor. Afeksionet nuk u referoheshin ndjenjave që vijnë e shkojnë, as nuk u ndryshuan nga modifikimet e përkohshme të sjelljes. Ato kishin më shumë të bënin me nivelin më të thellë se pse një person bën zgjedhje ose veprime të caktuara. Lidhur ngushtë me afeksionet ishte përdorimi i termit “temperament” nga Uesli. Një temperament në shekullin XVIII nuk do të thoshte që një person ishte nervoz ose zemërohej lehtë. Përkundrazi, ishte më shumë në përputhje me mënyrën se si ne përdorim “personalitetin” sot. Uesli përdori temperamentin në kuptimin e “një prirjeje të qëndrueshme ose të zakonshme të një personi”.¹⁸ Ose më saktësisht, ato afeksione njerëzore që përqendrohen dhe zhvillohen në

16. Wright, *After You Believe*, 27.

17. Wright, *After You Believe*, 27.

18. Maddox, *Responsible Grace*, 69.

aspekte të qëndrueshme të karakterit të dikujt, të kultivuara me anë të hirit, derisa nuk janë ndodhi të çastit, por bëhen virtyte afatgjata dhe të qëndrueshme dhe, kur bëhen me qëllime të drejta, “kalitjet e shenjtë”.

“Temperamentët e Shenjtë” ishte një frazë e përdorur shpesh në mësimet e Ueslit mbi dishepullimin, veçanërisht në përsiatjet e tij mbi frytin e Frymës te Galatasit. “Përkundrazi, fryti i Frymës është dashuria, gëzimi, paqja, durimi, mirësia, bujaria, besnikëria, butësia dhe vetëkontrolli” (Galatasve 5.22–23). Disa aspekte të këtij teksti ia vlen të theksohen. Për njërën, Uesli u shpreh shpejt se fryti ishte njëjës, jo shumës (“frytet”). Nëse do të ishte shumës, dikush mund të tundohej të përqendrohej te një “fryt” mbi tjetrin, sikur besnikëria të ishte përqendrimi dhe bujaria të lihej mënjanë. Fryti si i tërë i unifikuar është dëshmi se Fryma e Perëndisë është duke punuar. Ato nuk janë karakteristika të pavarura. Pastaj, ndërsa rritemi, të nëntë llojet e fryteve punojnë së bashku për të krijuar një pamje bindëse të asaj se si duket kur Fryma e Shenjtë kontrollon një jetë të shenjtëruar. N. T. Urajt tregon se Pali, “nuk parashikon specializim”.¹⁹ Ashtu si dikush mund të identifikojë një pemë pjeshke nga fruti që prodhon, ashtu edhe një i krishterë njihet nga fryti i Frymës; temperamentët e shenjtë që dëshmojnë në jetën e dikujt. Nuk është për t’u habitur, Uesli nxitoi të shtonte se dashuria prin listën e temperamentëve të shenjtë, sepse që të nëntë janë shprehje e dashurisë. Sidoqoftë, përgjatë udhëtimit të hirit, të gjitha karakteristikat e Krishtit do të shfaqen në jetët tona.

Ndoshta më e rëndësishmja për të kuptuar për udhëtimin e hirit është që këta temperamentë të shenjtë nuk përjetohen menjëherë. Në vend të kësaj, siç shpjegon Rendi Maddox (*Randy Maddox*), “hiri rigjenerues (shpëtues) i Perëndisë zgjon te besimtarët ‘farat’ e virtyteve të tilla. Këto fara më pas forcohen dhe marrin formë ndërsa ‘rritemi në hir.’ Duke pasur parasysh lirinë, kjo rritje përfshin bashkëpunim të përgjegjshëm, sepse në vend të kësaj mund të neglizhohet ose të mbysim fuqizimin e hirshëm të Perëndisë.”²⁰ Ka shumë për

19. Wright, *After You Believe*, 195.

20. Randy Maddox, “Reconnecting the Means to the End: A Wesleyan Prescription for the Holiness Movement,” *Wesleyan Theological Journal*, vol. 33, No. 2 (Fall 1998), 41.

të shpalosur nga shpjegimi i Madoks. Sidoqoftë, ideja kryesore që nuk duhet ta humbasim: virtyti duhet të ushqehet që të rritet.

Me hirin e Perëndisë, ne shpëtohem dhe shenjtërohemi në një kohë të caktuar dhe na është mundësuar të fillojmë rrugëtimin drejt ngjashmërisë së Krishtit – farat e drejtësisë janë mbjellë. Në një ndërmarrje të hirit madhështor, neve na është dhënë liri për të lënë një jetë mëkatore dhe me interes vetjak, në mënyrë që ta duam Perëndinë me gjithë zemrën, shpirtin, forcën dhe mendjen tonë. Sidoqoftë, tre virtytet e qëndrueshme të besimit, shpresës dhe dashurisë (1 Korintasve 13.13) dhe shumëllojshmëria nëntëfishe e fryteve që vijnë nga jeta e mbushur me Frymën janë dhënë dhe rritur. Fryti i Frymës nuk shfaqet papritmas, dhe as siç shprehet saktë Urajt, nuk “rritet automatikisht”. Ka padyshim indikacione premtuese fillestare se fryti është në rrugë e sipër. “Shumë të krishterë të rinj, veçanërisht kur një konvertim i papritur është shoqëruar me një largim dramatik nga një mënyrë jetese e mbushur me ‘vepra të mishit’, shprehin habinë e tyre nga dëshira që buron brenda tyre për të dashur, për të falur, për të qenë të butë, të jenë të pastër. Nga, – pyesin ata, – ka ardhur e gjithë kjo? Unë nuk kam qenë i tillë. Kjo është një gjë e mrekullueshme, një shenjë e sigurt e Frymës që po funksionon.”²¹

Këto ndryshime të pabesueshme “afeksioni,” nuk janë asgjë më pak se një dhuratë e pastër hiri. Sidoqoftë, i krishteri i ri nuk mund të bëhet pasiv. Ai duhet të ushtrojë atë që Perëndia po punon në të. I njëjti hir që bëri të mundur këto ndryshime “afeksioni” tani duhet të rritet në “temperamentë të shenjtë”, të kultivuar përmes zakoneve të reja dhe praktikave të fituara. Përsëri Urajt, e ndërton pikërisht këtë argument me një imagjinatë të mprehtë të dishepullimit: “Këto [dëshira të reja] janë lulet; për të marrë frytet duhet të mësosh të jesh kopshtar. Ju duhet të zbuloni se si të kujdeseni dhe të krasitni, si të ujisni arën, si t’i mbani larg zogjtë dhe ketrat. Ju duhet të ruheni nga sëmundjet dhe myku, të prisni dredhken dhe parazitët e tjerë që thithin jetën nga pema, dhe të siguroheni që trungu i ri mund të qëndrojë i fortë në erëra të forta. Vetëm

21. Wright, *After You Believe*, 195–196.

atëherë do të shfaqet fryti.”²²

Lulet janë sigurisht shenja e “Krishtit në ju, shpresë lavdie” (Kolosianëve 1.27), por për të marrë frytin aktual të një karakteri të pjekur, të ngjashëm me Krishtin, ne duhet të bëhemi kopshtarë. Farat tani duhet të fillojnë të japin frytet e tyre. Afeksionet e dorëzuara prodhojnë temperament të shenjtë, një gjendje të re, e cila sjell të menduarit si Krishti dhe veprime që fillojnë të funksionojnë në mënyra instiktive.²³ “Në këtë është përlëvdur Atri Im, që të jepni shumë fryt, dhe kështu do të jeni dishepujt e Mi.” (Gjoni 15.8). Lulet bëhen fryte – farat bëhen virtyt. Fuqia energjike e Perëndisë bëhet hiri që na mban.

Vesi dhe virtyti

Pali këshillon të krishterët korintas: “Analizoni veten tuaj nëse jeni në besim; provoni veten tuaj! A thua nuk e njihni vetveten se Jezus Krishti është në ju? Veç në qofshi të përjashtuar?” (2 Korintasve 13.5). Në stilin e tij të zakonshëm perceptues, parafrazimi i Juxhin Peterson është për këtë qëllim: “Provoni veten për t’u siguruar që jeni të fortë në besim. Mos u end duke marrë gjithçka si të mirëqenë. Bëjini vetes kontroll të rregullt. Ju duhen prova të drejtpërdrejta, jo thjesht fjalë, se Jezus Krishti është në ju. Provojeni! Nëse dështoni në provë, bëni diçka në lidhje me të” (vargjet 5–9).

Kontrollet e rregullta shëndetësore janë gjithmonë më të mira se sulmet në zemër ose goditjet në tru. Një problem që gjendet mjaft herët është shpesh i shërueshëm. Në mënyrë të ngjashme, ndjekja e një orari të mirëmbajtjes për makineritë e shtrenjta, mund të parandalojë dështimin katastrofik.

Gjatë historisë biblike, periudhat dyzet ditore janë njohur si periudha të përgatitjes, pastrimit dhe bërjes së inventarit shpirtëror.²⁴ Dikush mund të thotë që qëllimi i zgjimeve [shpirtërore] dhe takimeve të veçanta si p.sh.

22. Wright, *After You Believe*, 196.

23. “Gjuha e veprimeve të shenja të Ueslit që ‘rrjedh’ nga temperamenti i shenjtë sugjeron që ai e vlerësonte kuptimin në të cilin afeksionet e zakonshme sjellin ‘liri’ për veprimet njerëzore – lirinë që vjen nga praktika e disiplinuar (p.sh., liria për të luajtur një koncert të Bahut). Maddox, *Responsible Grace*, 69.

24. Periudha e Kreshmës në kalendarin e krishterë bazohet në konceptin dyzet ditore të vetë ekzaminimit.

konferencave, është për kontrolle të përbashkëta dhe personale. Siç i referohet Pali tek Korintasit, rritja shpirtërore kërkon shëndet shpirtëror. Në frymën e këshillës së Palit, këmbëngulja e Ueslit që besimtarët të takoheshin në grupe të vogla llogaridhënëse (“mbledhjet e klasave” siç i quante ai) ishte të praktikonin disiplinën e kontrolleve të shëndetit shpirtëror.

Cilat janë shenjat paralajmëruese të sëmundjes shpirtërore të zemrës? Klasifikuar nga kisha në shekullin e gjashtë, shenjat paralajmëruese u identifikuan si “mëkatet vdekjeprurëse” ose “veset vdekjeprurëse”. Ashtu si kolesterol i lartë është një paralajmërim për sëmundjen e zemrës dhe një dritë e dridhur është një shenjë se llamba po digjet, ashtu edhe këto shenja janë tregues të prirjeve jo të shëndetshme në dishepullimin tonë dhe nëse nuk trajtohen, mund të çojnë në vdekje shpirtërore. Kuptimi historik i kishës për vesin – i quajtur zakonisht “shtatë mëkatet vdekjeprurëse,” është më gjithëpërfshirës dhe përfshin më shumë se shtatë:

Krenaria: vendosja e vetvetes në vendin e Perëndisë si qendra dhe qëllimi kryesor i jetës së dikujt; refuzimi për të njohur vendin e dikujt si krijesë, e varur nga Perëndia.

Mosrespektimi: neglizhimi i qëllimshëm i adhurimit të Perëndisë, ose kënaqësia me pjesëmarrje automatike në të; manifestoi cinizëm ndaj të shenjtës ose përdorimit të krishterimit për përfitim personal.

Ndjeshmëria: kënaqësi me ndjenja të devotshme dhe ceremoni të bukura pa u përpjekur për shenjtëri personale; asnjë interes për të bartur kryqin ose sakrificën personale; një tërheqje më e madhe për shpirtëroren emocionale, sesa angazhimet sakrifikuese.

Mosbesimi: refuzimi për të njohur diturinë dhe dashurinë e Perëndisë; shqetësim të panevojshëm, ankth, përpikëri ose perfeksionizëm; përpjekjet për të fituar ose mbajtur kontrollin e jetës së dikujt me anë të spiritualizmit, druajtjes së tepruar ose frikës.

Mosbindja: refuzimi i vullnetit të njohur të Perëndisë; refuzimi për të mësuar natyrën e Perëndisë siç zbulohet në Shkrimin e Shenjtë; thyerja e besimit

nga papërgjegjësia, tradhtia dhe zhgënjimi i panevojshëm i të tjerëve; prishja e marrëveshjeve ligjore ose morale.

Mospëndimi: refuzimi për të kërkuar dhe për t'u përballur me mëkatet e dikujt, ose për t'i rrëfyer ato përpara Perëndisë; vetëarsyetimi duke besuar se mëkatet e tij janë të parëndësishme, të natyrshme ose të pashmangshme; refuzimi për të kërkuar falje dhe pajtim me fqinjin ose të qenit i gatshëm për ta falur veten.

Kotësia: dështimi për ta njohur Perëndinë dhe të tjerët për kontributin e tyre në jetën e dikujt; mburrja, ekzagjerimi dhe sjellja mburravece; shqetësim i tepruar për “gjërat”.

Arroganca: të qenit imponues dhe grindavec; të qenit këmbëngulës dhe kokëfortë.

Hidhërimi: refuzimi i talenteve, aftësive ose mundësive që Perëndia dhe të tjerët ofrojnë për mirëqenien tonë; rebelim dhe urrejtje ndaj Perëndisë ose të tjerëve; cinizëm.

Zilia: pakënaqësia në vendin tonë në rendin e krijimit të Perëndisë; manifestohet në xhelozë, keqdashje dhe përbuzje për të tjerët ose “gjërat” e të tjerëve.

Lakmia: refuzimi për të respektuar integritetin e krijesave të tjera, shprehur në akumulimin e gjërave materiale për të dëshmuar vlerën e vetvetës; përdorimi i të tjerëve për përfitime personale; kërkimi për status dhe pushtet në kurriz të të tjerëve.

Babëzia: shpërdorimi i burimeve natyrore ose pasurive personale; ekstravagancë ose jetesë përtej mundësive të dikujt; manifestohet në ambicie apo mbizotërim të tepruar të të tjerëve dhe mbrojtje të padrejtë të “gjërave” të veta; kopracia; dorështrëngimi.

Grykësia: teprimi i orekseve natyrore për ushqim dhe pije; kërkimi i tepruar për kënaqësi dhe rehati; manifestohet në mosdurim dhe mungesë disipline.

Epsi: keqpërdorimi i seksit; përfshin pandershmërinë, modestinë, maturinë dhe mizorinë; nuk e njeh martesën si marrëdhënie të urdhëruar nga

Perëndia për seksualitetin.

Përtacia: refuzimi për t'iu përgjigjur mundësive të dikujt për rritje, shërbim dhe sakrificë; përfshin përtacinë në detyrat shpirtërore, mendore ose fizike; neglizhimi i familjes; indiferenca ndaj padrejtësisë ose ndaj njerëzve që vuajnë në botë; duke lënë pas dore nevojtarët, të vetmuarit dhe të papëlqyerit.

Shenjat paralajmëruese mund të jenë delikate, por të rrezikshme për shpirtin. Kur duam të bëhemi të shëndetshëm fizikisht, ne ndryshojmë disa modele të jetesës dhe bëjmë zgjedhje të ushqimit në lidhje me dëshirat tona të reja – herë pas here mjekimi është i nevojshëm për të plotësuar ose kompensuar atë që trupat tanë nuk mund të prodhojnë vetë. Nëse duam që kopshtet tona të prodhojnë fruta më të mira, shtojmë plehra dhe disa herë heqim pjesë të sëmura të bimëve. E vërteta është si trupat, ashtu edhe kopshtet tona performojnë më mirë nëse shmangim përpjekjen për të gjetur një zgjidhje të shpejtë për çdo problem. Preferohet mirëmbajtja e rregullt dhe e vazhdueshme. Jeta e dishepullimit funksionon në të njëjtën mënyrë. Pa dyshim, nuk mundemi që thjesht të heqim qafe disa modele jo të shëndetshme pa i zëvendësuar ato me diçka tjetër, diçka më të mirë. Duhet të ketë një të mirë zhvendosëse që është më e fortë se e keqja aktuale. Kushdo që është në rrugën e shërimit nga varësia do t'ju tregojë se diçka duhet të zëvendësojë varësinë. Duhet të ketë një pasion më të lartë, shpirtëror për të zhvendosur atë më të ulët, mëkatar. Po kështu, duhet të ketë një program të rregullt mirëmbajtjeje për të përmirësuar rrugëtimin tonë të hirit – një mënyrë e rregullt, sistematike për ta mbajtur dishepullimin tonë në nivelet më të larta të performancës.

Cila është e mira e zhvendosjes që zëvendëson veset vdekjeprurëse? Cili është plani i mirëmbajtjes së hirit mbajtës? Dhjata e Re identifikon të mirën e zhvendosur si fryt të Frymës – ato virtyte jetëdhënëse që zhvendosin instiktet e ulëta të mishit tonë. Plan i rregullt, sistematik i mirëmbajtjes quhet disiplinë shpirtërore. Atletët profesionistë bëjnë xhiro, bëjnë tërheqje dhe ngrenë pesha – jo për argëtim ose sepse janë të mërzitur, por sepse janë të vendosur për të arritur një qëllim. Kontrollët shpirtërore nuk duhet të jenë kirurgji madhore

ose invazive. Ato mund të jenë kontrolle mirëqenieje. Mjekimi i së mirës së zhvendosur është fryti i Frymës; plani i mirëmbajtjes shëndetësore për të rritur pranueshmërinë tonë ndaj veprimtarisë së Perëndisë janë disiplinat shpirtërore. Ato janë elemente thelbësore të hirit mbajtës.

Disiplina si mjet hiri

Shkruesi i letrës së Hebrenjve e njeh rëndësinë e disiplinës shpirtërore: “Çdo ndreqje, pra, aty për aty, nuk duket se sjell gëzim, po hidhërim; por më pas u jep një fryt drejtësie atyre që janë ushtruar me anë të tij” (12.11). Disiplina mund të ketë një kuptim negativ, nëse shihet si ndëshkim për keqgjë. Sidoqoftë, siç e njeh Hebrenjve, ekziston edhe një gjë e tillë si disiplina për ta mbrojtur ose për ta bërë më të fortë. Ky është aspekti i disiplinës të cilit Hebrenjve i referohet. “Në qoftë se ju do ta duroni qortimin, Perëndia do t’ju trajtojë si bij; sepse cilin bir nuk e korrigjon i ati? Por, po të mbeten të pandrequr, ku të gjithë u bënë pjesëtarë, atëherë jeni kopila dhe jo bij.” (12.7–8).

Dy gjëra për t’u vënë re: (1) shkrimtari nuk mund të imagjinonte fëmijë që nuk janë përfitues të disiplinës prindërore; (2) shkruesi parashikon disiplinën si një formë të dashurisë së shenjtë. Të duash një fëmijë, përfshin disiplinë. Nuk është ndëshkim i fëmijës nëse i mohon pica në mesnatë, i vendos një orë për t’u futur brenda ose nëse nuk e lejon të shohë çfarë të dojë në Netflix. Prindi i mençur e di që ky nuk është ndëshkim; kjo është përgatitje për të ardhmen e tyre. Mund të ndihet e padrejtë ndaj fëmijës, madje mizore, por vjen një ditë kur ata mësojnë të vlerësojnë kufijtë e vendosur nga prindërit e dashur për t’i mbrojtur ata dhe për t’i ndihmuar të zhvillohen në të rritur–plotësisht të shëndetshëm. Në mënyra të ngjashme, Perëndia na disiplinon drejt shenjtërisë. Ndoshta nuk duket e këndshme në atë kohë, por mbjell fara për frytin paqësor të një jete të drejtë dhe – mos e humbisni këtë – ne duhet të stërvitemi në të.

E. Stenli Xhons (*E. Stanley Jones*) me mençuri tha: “Ju nuk mund ta arrini shpëtimin me anë të disiplinave – është dhurata e Perëndisë. Por nuk mund ta mbani atë pa disiplinë.”²⁵ Lidhur me formimin e karakterit, Agustinin i

25. E. Stanley Jones, *Conversion* (Nashville: Abingdon Press, 1991), quoted in Richard J. Foster

atribuohet përkufizimit të virtytit si “një zakon i mirë që përputhet me natyrën tonë”. Më tej, Xhons përmend zakonet e thjeshta të Jezusit si një shembull i një personi që ishte plotësisht i varur nga Perëndia dhe personalisht i disiplinuar në shprehitë e tij: “Ai bëri tre gjëra si shprehi: (1) ‘Ai u ngrit për të lexuar siç e kishte zakon’ – ai e lexoi Fjalën e Perëndisë si shprehi. (2) ‘Ai doli në mal për t’u lutur siç e kishte zakon’ – ai u lut si shprehi. (3) ‘Ai i mësoi përsëri siç e kishte zakon’ – ua kaloi të tjerëve si shprehi atë që kishte dhe çfarë kishte zbuluar. Këto zakone të thjeshta ishin zakonet themelore të jetës së tij.²⁶ Zakonet e shenjta formojnë disiplina të shëndetshme. Duke u kthyer në idenë e Ueslit për temperamentin e shenjtë, ai besoi se ato u formuan tek të krishterët ndërsa ata morën pjesë në jetën e kishës përmes praktikave të zakonshme që ai i quajti “mjetet e hirit” – të njohura edhe si disiplina shpirtërore. Mjetet e hirit janë përçues të hirit transformues të Perëndisë – ato aktivitete që e kanalizojnë veprimtarinë e Perëndisë në ne në udhëtimin e hirit.

Për Ueslin, këto mjete u përcollën përmes atyre që ai i quajti vepra të devotshmërisë dhe vepra të mëshirës. Veprat e devotshmërisë janë kryesisht ato që ne bëjmë për të forcuar marrëdhënien tonë personale me Krishtin. Veprat e mëshirës janë të lidhura me atë që ne bëjmë për të angazhuar shërbesën dhe misionin e Perëndisë në botë. Si veprat e devotshmërisë dhe veprat e mëshirës kanë një përbërës individual (atë që dikush mund ta bëjë vetëm) dhe një përbërës të përbashkët (çfarë duhet të bëhet me ndihmën e të tjerëve).

Veprat individuale të devotshmërisë përfshijnë meditimin mbi Shkrimet, lutjen, agjërimin, ndarjen e besimit me të tjerët (ungjillizimin) dhe dhënien me bujari të burimeve tona. Veprat e përbashkëta të devotshmërisë përfshijnë adhurimin e përbashkët, pjesëmarrjen në sakramentet e Darkës së Shenjtë dhe pagëzimin e krishterë, përgjegjësinë ndaj njëri-tjetrit (e njohur gjithashtu si “konferenca e krishterë”), studimi i Biblës dhe predikimi. Edhe një herë, ne i kryejmë këto ngjarje fetare jo thjesht sepse jemi të krishterë, por edhe sepse ato

and James Bryan Smith, eds., *Devotional Classics: Selected Readings for Individuals and Groups* (Englewood, CO: Renovaré, 1990), 281

26. Jones, Conversion, quoted in Foster and Smith, *Devotional Classics*, 282.

janë “praktika të mbushura me Frymë që do të riformojnë dhe rikualifikojnë dashuritë tuaja. . . kundër praktikave formuese, me rituale të formësimit me uri dhe liturgji të formësimit me dashuri” sepse përmes këtyre praktikave ne mësojmë të veshim Krishtin. (shih Kolosianëve 3.12–16).²⁷

Sakramentet si mjete hiri

Më shumë detaje mbi rëndësinë e sakramenteve do të jenë të dobishme për udhëtimin e hirit. Fjala “sakrament” buron nga një fjalë latine që do të thotë “të shenjtërojmë” ose “ta bëjmë të shenjtë”, e cila nga ana tjetër rrjedh nga fjala greke për “mister”. Kur rreshtohet së bashku, një sakrament është “një mister i shenjtë”. Xhon Uesli e huazoi përkufizimin e tij të sakramentit nga katekizmi i Librit Anglikan të Lutjes (i cili u huazua nga përkufizimi i përmbledhur i Agustinit), me një përshtatje të lehtë për një qartësi më të madhe: “Një shenjë e jashtme e një hiri të brendshëm dhe një mjet me të cilin e marrim të njëjtin”.²⁸ Duke kombinuar idenë e misterit dhe mjeteve të shenjta, N. T. Urajt i përshkruan sakramentet si “ato raste kur jeta e qiellit kryqëzohet në mënyrë misterioze me jetën e tokës”.²⁹ Disa tradita të krishtera praktikojnë më shumë sakramente se të tjerat. Protestantët zakonisht advokojnë për dy: pagëzimi dhe eukaristi (gjithashtu e quajtur si Darka e Zotit ose Darka e Shenjtë).³⁰

Xhon Uesli inkurajoi me forcë “një pjesëmarrje të ngushtë në të gjitha urdhëresat (disiplinat shpirtërore)”,³¹ por veçanërisht për Eukaristin. Ai e përmendi atë si “kanali i madh”, përmes të cilit na përcillet hiri dhe madje identifikoi marrjen e Darkës së Zotit si hapin e parë në ushtrimin e shpëtimit tonë.³² Një këndvështrim i tillë dinamik u bazua në besimin e tij se Darka e Zotit

27. James K. A. Smith, *You Are What You Love: The Spiritual Power of Habit* (Grand Rapids: Brazos Press, 2016), 68–69.

28. Rob L. Staples, *Outward Sign and Inward Grace: The Place of Sacraments in Wesleyan Spirituality* (Kansas City, MO: Beacon Hill Press of Kansas City, 1991), 21. Emphasis added.

29. Wright, *After You Believe*, 223.

30. Arsyëja për dy sakramente është një preferencë për të praktikuar vetëm ato të vendosura nga Jezus Krishti (të njohura gjithashtu si “sakramente dominuese”).

31. Wesley, *A Plain Account of Christian Perfection*, Annotated, 45

32. Maddox, *Responsible Grace*, 202.

është më shumë se një përkujtim simbolik i vdekjes së Krishtit, por që prania e vërtetë e Krishtit nga Fryma e Shenjtë, përjetohet kur dikush merr Darkën e Zotit.³³ Kjo bëri që Uesli të nxirrte dy përfundime të konsiderueshme.

Së pari, për shkak se hiri i tanishëm është shtrirë për një jetë të krishterë të fuqizuar, Darka e Shenjtë duhet të merret sa më shpesh që të jetë e mundur.

Së dyti, për shkak se prania e Frymës së Shenjtë në Darkën e Shenjtë është e barabartë me hirin e gatshëm shpëtues, shenjtërues dhe mbajtës të Perëndisë, mund të konsiderohet si një “urdhëresë kthyesë në besim”³⁴ – një person me zemër të penduar mund të shpëtohet, edhe si një mënyrë e promovimit të shenjtërisë. Kjo pikëpamje e lartë e Darkës së Shenjtë e shtyu teologun nazaretas Rob Stejpells (*Rob Staples*) t’i referohej eukaristit si “sakramenti i shenjtërimit”.³⁵

Pagëzimi është shumë më tepër sesa një ritual i thjeshtë ose një dëshmi publike. Kjo nënkupton vdekjen dhe ringjalljen tonë me Krishtin. “Ne pra, u varrosëm me Të me anë të pagëzimit në vdekje, që ashtu si Krishti u ringjall prej së vdekurish me anë të lavdisë së Atit, kështu edhe ne gjithashtu të ecim në risinë e jetës.” (Romakëve 6.4). Dikush nuk lëviz pa qëllim drejt mbretërisë së Perëndisë, përfundimisht duhet të ketë një vdekje ndaj mëkatit dhe vetvetes dhe një ringjallje në jetë të re.³⁶ Pagëzimi shënon atë moment. “Pagëzimi e bën të qartë se e gjithë jeta e krishterë është çështje e të qenit nën gjurmët e kryqit,

33. “Kur Jezusi thotë ‘përkujtim’, fjala greke është *anamnesis*. Është shumë më tepër sesa kujtesa historike. Ai tregon për një përkujtim të frymëzuar nga Fryma e Shenjtë që fut ngjarjen nga e kaluara në të tashmen në një mënyrë të tillë që fjalë për fjalë ‘po ndodh përsëri.’” J. D. Walt, “Wonder Bread,” Seedbed Daily Text, April 24, 2020, <https://www.seedbed.com/wilderness-wonder-bread/>.

34. “Urdhërimi kthimi në besim” është një frazë e përdorur personalisht nga Xhon Uesli. Staples, *Outward Sign and Inward Grace*, 252. Nga dëshmia e nënës së tij se asaj iu dha siguria e plotë e besimit të saj ndërsa merrte Darkën e Shenjtë, dhe shumë dëshmime të tjera të përvojave të tilla si kjo, Uesli u bind se momenti Eukaristik “flijimin një herë e përgjithmonë të Krishtit në një shfaqje dramatike, duke përcjellë fuqinë e Tij shpëtuese.” Maddox, *Responsible Grace*, 203.

35. See Staples, *Outward Sign and Inward Grace*, 201–249.

36. Wright, *After You Believe*, 281.

e pjesëmarrjes në kryq, e marrjes së kryqit dhe e ndjekjes së Jezusit.”³⁷ Uesli nuk përfshiu pagëzimin në asnjë nga listat e tij zyrtare të mjeteve të hirit, por kjo nuk ndodhi, sepse ai e zhvlerësoi pagëzimin, por për shkak të rolit të tij nismëtar në bashkësinë e besimit dhe si një ngjarje e vetme në jetën e një besimtari. Kështu, për Ueslin, pagëzimi shënoi fillimin e jetës së shenjtërisë, ndërsa Uesli i pa mjetet e tjera të hirit të përsëritura domosdoshmërisht për ndjekjen e vazhdueshme të shenjtërisë.³⁸

Uesli në një masë të madhe radhitej me Reformatorët anglezë në pjesën më të madhe të pikëpamjes së tij të pagëzimit, por ai ndryshoi në dy mënyra thelbësore. Sipas Maddox (*Maddox*), Uesli e lartësoi “transformimin e fuqizuar në mënyrë të hirshme të jetës sonë” mbi dhënien e “faljes juridike” (një fokus në faj dhe domosdoshmërinë e faljes). Ky është një dallim i rëndësishëm, sepse do të thotë që pagëzimi nuk është vetëm një shenjë që mëkatet tona janë falur, por gjithashtu që ne jemi duke u shëruar nga natyra jonë mëkatore dhe rrënimi që mëkati na ka shkaktuar.³⁹ Për më tepër, për Ueslin, megjithëse hiri i pagëzimit është “i mjaftueshëm për fillimin e jetës së krishterë”, njeriu duhet të marrë pjesë me përgjegjshmëri dhe përgjegjësi me hirin që jepet që mjetet e hirit të jenë plotësisht efikase.⁴⁰ Në këtë kuptim, pagëzimi është një shenjë dhe simbol i gatishmërisë së dikujt për t’u angazhuar plotësisht në atë që nevojitet për të ushqyer një jetë të shenjtë.

Historiani dhe studiuesi nazaretas Pal Baset (*Paul Bassett*) një herë më tha se liturgjia më e hershme e regjistruar e pagëzimit, nga fundi i shekullit të katërt, përfshinte vendosjen e duarve të zyrtarit dhe thënien e fjalëve (parafrazimi im): “Dhe tani merr hirin dhe shërimin e Zotit tonë Jezus Krisht dhe fuqia e Frymës

37. Wright, *After You Believe*, 281.

38. Staples, *Outward Sign and Inward Grace*, 98; Maddox, *Responsible Grace*, 222.

39. Ekzistojnë ndryshime të rëndësishme midis traditave të krishtera Perëndimore (latine) dhe Lindore (greke) në lidhje me kuptimin e shpëtimit. “Krishterimi Perëndimor (si protestant dhe katolik) u karakterizua nga një theks juridik dominant mbi fajin dhe faljen, ndërsa soteriologjia Ortodokse Lindore theksoi më shumë shqetësimin terapeutik për shërimin e natyrës sonë të sëmurë nga mëkati.” Maddox, *Responsible Grace*, 23. Pikëpamja e Ueslit për kuptimin e pagëzimit përfshinte të dyja, por theksoi aspektin shërues dhe jetëdhënës.

40. Maddox, *Responsible Grace*, 23.

së Shenjtë veproftë brenda teje, që pasi të keni lindur nga uji dhe Fryma, të jeni dëshmitar besnik”. Shkurt, kam marrë hir; Unë jam duke u shëruar; Do të jem dishepull i Jezusit.

Marrëdhëniet llogaridhënëse

Çdo diskutim i hirit mbajtës në jetën e dishepujve do të ishte i paplotë, veçanërisht për ata që janë në traditën e Shenjtërisë Uesliane, pa përmendur rëndësinë e marrëdhënieve të përgjegjshme shpirtërisht. Uesli zhvilloi një kornizë praktike që ai besonte se ishte e nevojshme për çdo të krishterë në rritje. Duke kuptuar prirjen e përqëndrimit në vetvete (e cila çon në mungesë të vetëdijes për veten) dhe tundimin këmbëngulës për të jetuar jetë të izoluar, Uesli vendosi pesë nivele të asaj që ai e quajti “konferencë e krishterë”. Këto ishin shoqëri (të ngjashme me orët e shkollës të së Dieles të dizajnuara për edukimin dhe udhëzimin e krishterë), takime klasash (më shumë për këtë më vonë), grupe (grupe të vogla), shoqëri të zgjedhura (zhvillimi i udhëheqësisë dhe mentorimi) dhe grupe pendimi (grupet e rimëkëmbjes).

Ndërsa të gjitha nivelet e konferencave të krishtera ishin të dobishme si një mjet hiri, Uesli arriti të besonte se mbledhja e klasës ishte zemra e komunitetit të krishterë dhe jetike për t’u rritur në ngjashmërinë e Krishtit. Ajo u bë “metoda” e lëvizjes Metodiste dhe shumica besojnë, ishte kontributi më i madh organizativ i Ueslit në jetën e shenjtërisë. Fokusi i saj kryesor nuk ishte në edukimin e krishterë në vetvete, por në sjelljet, duke theksuar modelin praktik dhe mjedisin më të përshtatshëm për transformimin shpirtëror. Studimet biblike dhe mësimi doktrinor ishin të rëndësishëm, por ato ishin të rezervuara për shoqëritë. Njerëzit ishin në mbledhjet e klasave për të bërë pyetje në lidhje me përparimin shpirtëror të secilit anëtar. Ata ishin atje për të parë njëri-tjetrin në sy dhe për të bërë pyetjen: “Si shkon me shpirtin tënd?” Ata duhej ta mbanin përgjegjësi njëri-tjetrin për rritjen e hirit dhe të ofronin çfarëdo inkurajimi të nevojshëm për ta nxitur njëri-tjetrin drejt shenjtërisë së zemrës dhe jetës.⁴¹

41. Kjo pjesë mbi mbledhjen e klasës është përshtatur nga libri im për shërbesën e urbanizmit.

Për më shumë detaje mbi konferencën e krishterë dhe ndikimin e takimit të klasës mbi

Predikuesi më i famshëm protestant në shekullin XVIII nuk ishte Xhon Uesli. Ky emërim i përkiste një anglezi tjetër, Xhorxh Uajtfild (*George Whitefield*). Një predikues orator dhe dinamik, Uajtfild u konsiderua botërisht zëri i Protestantizmit në të gjithë botën Perëndimore dhe një nga lëvizësit kryesorë të Zgjidhjes së Madh në Amerikën e Veriut.⁴² Uesli dhe Uajtfild ishin miq të ngushtë dhe secili admironte kontributin e tjetrit për të forcuar kishën. Sidoqoftë, në fund të fundit, puna e Ueslit qëndroi dhe jo ajo e Uajtfild. Adam Klark (*Adam Clarke*), një bashkëkohës më i ri i Ueslit, ia atribuoi drejtpërdrejt mbledhjes së klasës frytin e qëndrueshëm të rizgjidhjes së Ueslian.

Nga përvoja e gjatë, unë e njoh mirësjelljen e këshillës së z.Uesli: “Vendosni mbledhjet e klasave kudo që predikoni dhe keni dëgjues të vëmendshëm; sepse, kudo që kemi predikuar pa e bërë këtë, fjala ka qenë si farë përgjatë rrugës.” Me anë të këtij [hiri] na u dha mundësia të krijonim kisha të përhershme dhe të shenjta në të gjithë botën. Z. Uesli e pa domosdoshmërinë e kësaj që nga fillimi. Z.Uajtfild... nuk e ndoqi atë. Cila ishte pasoja? Fryti i punës së z.Uajtfild vdiq me të. Puna e z.Uesli mbetet dhe shumëzohet.⁴³

Vetë Uajtfild, në përgjigje të një pyetje rreth ndikimit të rizgjidhjes, më vonë reflektoi: “Vëllai im Uesli veproi me mençuri; shpirtat që u zgjuan nën shërbesën e tij, ai i bashkoi në [takime] klasa dhe kështu ruajt frytet e punës së tij. Këtë e lashë pas dore, dhe njerëzit e mi janë një litar rëre”.⁴⁴

Dishepullimi mund të jetë personal, por nuk duhet të jetë privat. Të krishterët e izoluar janë në rrezik, sepse besimi izolues prodhon dishepuj të dobët dhe të pafrytshëm. Adhurimi i përbashkët dhe edukimi i krishterë janë të dobishëm dhe të domosdoshëm, megjithatë pa një jetë të përbashkët të marrëdhëniesve të dashura dhe intime, të kombinuara me zbatimin e njohurive

Metodizmin, shih David A. Busic, *The City: Urban Churches in the Wesleyan–Holiness Tradition* (Kansas City, MO: The Foundry Publishing, 2020).

42. Harry S. Stout, *The Divine Dramatist: George Whitefield and the Rise of Modern Evangelicalism* (Grand Rapids: Eerdmans, 1991), xiii–xvi.

43. J. W. Etheridge, *The Life of the Rev. Adam Clarke* (New York: Carlton and Porter, 1859), 189.

44. Etheridge, *The Life of the Rev. Adam Clarke*, 189.

të marra, ne do ta kemi të vështirë për ta “ushtruar shpëtimin tonë” (Filipianëve 2.12). Sekreti i rritjes së shëndetshme dhe të lumtur në hir është në frazën e përsëritur të Ueslit “duke u kujdesur për njëri-tjetrin në dashuri”.⁴⁵

Mëshira e vetëkontrollit

Të mësuarit për t’u lutur, agjëruar, lexuar Shkrimet e Shenjta, reflektim, studim, thjeshtësi, vetmi, nënshtrim, shërbim, rrëfim, adhurim dhe llogaridhënie në marrëdhënie janë të gjitha shembuj të mjeteve të hirit. Këto dhe disiplina të tjera shpirtërore si ato, janë pjesë dhe copëza të hirit mbajtës.

Ju mund të thoni: “Unë nuk kam aftësi për ato gjëra!” Kështu jemi të gjithë. Fakti është se askush nuk ka një aftësi për ato në fillim. Ato nuk janë tërheqëse dhe kërkojnë punë të mundimshme dhe stërvitje të vazhdueshme. Mos harroni, me Frymën është ndihma, natyra jonë e vjetër po shndërrohet në një të re derisa ajo që më parë nuk erdhi natyrshëm të bëhet instiktive dhe “derisa të formohet Krishti në ju” (Galatasve 4.19). Ndoshta kjo është arsyeja pse vetëkontrolli renditet si karakteristika përfundimtare e frytit të Frymës. Vetëkontrolli është i nevojshëm sepse fryti nuk është automatik. Lulet tregojnë shenjat fillestare të potencialit, por përveç përqendrimit të përshtatur dhe vëmendjes së qëllimshme, nuk ka gjasa që fryti të piqet.

Në të vërtetë Urajt bën me dije se disa fryte mund të stimulohen: “Të gjitha llojet e fryteve që Pali përmend këtu janë relativisht të lehta për t’u falsifikuar, veçanërisht të njerëzit e rinj, të shëndetshëm dhe të lumtur, përveç vetëkontrollit. Nëse kjo nuk është aty, gjithmonë ia vlen të pyesësh nëse dukja e llojeve të tjera të fryteve është vetëm kaq, një dukje në vend se një shenjë e vërtetë e punës së Frymës”⁴⁶ Prandaj, nuk është çudi që vetëkontrolli i nënshtrohet Perëndisë të vendosur për të kultivuar jetën e shenjtërisë.

Ka shumë parazitë, shumë kaçube të huaja që do të kërcënojnë t’ja zënë frymën pemës frytëdhënëse, shumë grabitqarë të gatshëm të gërryejnë rrënjët ose të rrëmbejnë frytet para se të piqen. Duhet të ketë një zgjedhje të vetëdijshme

45. John Wesley, “The Nature, Design, and General Rules of the United Societies,” *Works*, 9.69.

46. Wright, *After You Believe*, 196.

të mendjes, zemrës dhe vullnetit për t’u marrë me të gjithë armiqtë e tillë pa mëshirë. Vetëm sepse “jetoni në Frymë”, nuk e bën ndjekjen e drejtimit të Frymës automatike. Duhet të zgjidhni ta bëni atë. Dhe ju mundeni.⁴⁷

Hiri mbajtës: shpirtëror dhe praktik

Hiri mbajtës është si shpirtëror ashtu dhe praktik. Është shpirtëror sepse nevojitet Fryma. Ashtu si fryti fizik është produkt natyror i një gjëje të gjallë, ashtu edhe fryti shpirtëror është produkt i Frymës së Shenjtë. Ne nuk mund ta prodhojmë veprën e thellë të Perëndisë në ne me fuqinë e Frymës së Shenjtë – është ajo që vjen nga jashtë dhe si e tillë, është plotësisht dhuratë. Megjithatë, është gjithashtu praktike; thjesht, duhen stërvitje. Këto praktika marrin formën e kopshtarisë në mënyrë që ajo që ka filluar tek ne do të “përfundojë” (Filipianëve 1.6) dhe “prodhojë fryte drejtësie” (Filipianëve 1.11). Asnjë fermer që mbjell misër të hënën nuk pret që të hajë misër në kalli të dielën pasardhëse. Nga fara tek korrja kërkon kultivim dhe kohë. Uji dhe rrezet e diellit janë të domosdoshme, duhet t’i hidhet pleh dhe barërat e këqija duhet të shkulen nëse dëshirojmë të shijojmë përfitimet e frytëzimit.

Ne jemi një kulturë e çdo gjëje të çastit: kafe e çastit, kokoshka mikrovale dhe internet me shpejtësi të lartë. Njerëzit në kafene i bërtasin laptopëve të tyre nëse u duhen më shumë se disa sekonda për t’u lidhur me Wi-Fi. Pritshmëria e gjithçkaje të çastit i bën të gjithë të paduruar. Nga vjen kjo? Unë them se ushqehet nga një dëshirë më e rrënjosur për kënaqësi të menjëhershme, e cila nuk është një fenomen modern, ka qenë me racën njerëzore për një kohë shumë të gjatë. Ndërsa ka shumë shembuj në Shkrimin e Shenjtë të virusit vdekjeprurës që është kënaqësia e menjëhershme, Esau, i njohur për të drejtën e parëlindjes, është më famëkeqi. Reputacioni i tij keqardhës u vendos pas një dite të gjatë dhe të pasuksesshme të gjuetisë. Kur u kthye në shtëpi, ai ishte i uritur. Vëllai i tij binjak, dinaku Jakob, po gatuante gjellë me fasule të kuqe mbi zjarr. Esau kërkoi të hante. Gjatë llogaritjes, Jakobi negocioi një marrëveshje: “Së pari më shit parëbirninë tënde” (Zanafilla 25.31).

47. Wright, *After You Believe*, 196–197.

Parëbirnia ose e drejta e të parëlindurit (i njohur gjithashtu si ligji i primogjenerës), ishte një rregull i zakonshëm ligjor i trashëgimisë që garantonte privilegjet financiare dhe autoritetin familjar për fëmijën më të madh mashkull – një bekim prestigjioz dhe fitimprurës. Për Jakobin që t'i kërkonte Esaut të shiste një pasuri kaq të vlefshme për një tas me supë ishte e jashtëzakonshme. Përgjigjja e Esaut ishte po aq e egër: “Ja, unë jam duke vdekur, ç'dobi kam nga parëbirnia?” (25.32) Ai ishte i gatshëm të tregtonte pasurinë e tij më të vlerësuar dhe të çmuar për një moment kënaqësie të menjëhershme – fjalë për fjalë, një tas me fasule të kuqe.

Ironia nuk mund të injorohet. Çfarë lloj personi impulsiv do të tregëtonte diçka me dobi të pafund dhe vlerë të paçmueshme për një moment kënaqësie të menjëhershme që do të mbarojë për disa momente? Megjithatë, kultura jonë e kënaqësisë së menjëhershme vepron kështu gjatë gjithë kohës: tregëton diçka të një dobie të pafund dhe vlere të paçmueshme për diçka që ata e dinë se vlen shumë më pak – diçka e qëndrueshme për diçka jetëshkurtër. “Unë dua atë që dua dhe e dua tani! Unë dua që orekset e mia të kënaqen, edhe nëse më kushton gjithçka.”

Nuk është çudi që shkruesi i letrës drejtuar Hebrenjve e barazon veprimin e Esaut me imoralitetin mëkatar: “Se mos ndodhet ndonjë kurvar ose profan, si Esau, i cili për një gjellë shiti të drejtën e tij të parëbirisë. Sepse e dini se më pas, kur ai deshi të trashëgojë bekimin, iu refuzua, ndonëse e kërkoi me lot, sepse nuk gjeti vend pendimi.” (Hebrenjve 12.16–17). Është një mësim tragjik, i mësuar me zor, të cilit nuk guxohet të mos i kushtohet vëmendje. Disiplina kërkohet për jetën e shenjtëruar dhe nuk mund t'i bihet shkurt procesit të dishepullimit.

Tajger Uods (*Tiger Woods*) vlerësohet si një nga lojtarët më të mirë të golfit të historisë. Kur isha i ri duke mësuar të luaja golf, u përpoqa të imitoja stilin e tij. Doja të godisja disqet e “përbindëshave” si Tajgër, të godisja hekurat e mia me saktësi të lartë si Tajgër, t'i ciflosja me një prekje të butë si Tajgër dhe të shënoja me sigurinë e Tajgër (madje bleva kapele golfi Nike për t'i vendosur si

Tajgër). Kishte vetëm një problem: Tajgër stërvitej me orë të tëra çdo ditë dhe e kishte bërë këtë para se të fillonte të ecte mirë.⁴⁸ Edhe kur ai u bë lojtari më i mirë i golfit në botë, personat e brendshëm na tregojnë se ai ende stërvitej më shumë se kushdo tjetër. Mund të them se dua të luaj golf si Tajgër Uods, por kjo nuk do të thotë asgjë nëse angazhimi im në stërvitje nuk është në përpjesëtim me dëshirën time. Kënaqësia e menjëhershme nuk do të mjaftojë. Pavarësisht se sa do të doja të ishte ndryshe, loja ime e golfit është proporcionale me angazhimin tim në stërvitje.

Ndonjëherë njerëzit do të thonë: “Unë dua të jem si motra Filane. Ajo duket aq afër Perëndisë. E shoh Jezusin tek ajo. Ajo është një shenjtore.” Nuk është keq ta shohësh atë si një shembull të mirë të ngjashmërisë me Krishtin dhe të kërkosh të imitosh stilin e saj të jetës, por ajo që mund të mos e dini janë orët e tëra që ajo kalon vetëm me Perëndinë në meditim dhe lutje – dekadat që ajo ka kaluar në stërvitje shpirtërore, duke u formuar në atë që tani shihni. Ajo nuk arriti atje ku është duke shijuar kënaqësi të menjëhershme. Stërvitjet shpirtërore kanë formuar temperamente të shenjta tek ajo që tani duken si virtyt. Ajo ka kultivuar frytin e Frymës dhe kjo është arsyeja pse dashuria, gëzimi, paqja, durimi, mirëdashja, mirësia dhe vetëkontrolli janë dukshëm kaq të pranishme.

Shenjtëria nuk është një moment kohor në të cilin shfaqet virtyti. Jo! Është ajo në të cilën jemi formuar. “Kthimi në besim është dhuratë dhe arritje. Është akti i një momenti dhe puna e një jete të tërë”.⁴⁹ Durimi për këndvështrimin afatgjatë është ajo që nevojitet për udhëtimin e hirit. Ne duhet të kultivojmë frytet.

Ndihet vetëm e drejtë të përfundosh një kapitull mbi hirin e mundshëm të Perëndisë me një lutje për pastërti që është bërë nga shenjtoret për më shumë se një mijë vjet: Perëndi i Plotfuqishëm, ndaj Teje të gjitha zemrat janë të hapura, të gjitha dëshirat dihen dhe prej Teje nuk fshihet asnjë sekret; pastroji mendimet e zemrave tona me anë të frymëzimit të Frymës

48. Uods u paraqit në një shfaqje të njohur televizive në moshën dy vjeçare dhe tregoi aftësinë e tij të golfit.

49. Jones, *Conversion*, quoted in Foster and Smith, *Devotional Classics*, 281.

Tuaj të Shenjtë, në mënyrë që të të duam në mënyrë të përsosur dhe ta lartësojmë denjësisht Emrin Tënd të shenjtë; përmes Krishtit, Perëndisë tonë. Amin⁵⁰

50. *The Book of Common Prayer* (Cambridge: Cambridge University Press, n.d.), 97–98.

6

HIRI I MJAFTUESHËM

Por ai më tha: “Hiri Im të mjafton, sepse fuqia ime përsoset në dobësi”.

2 Korintasve 12.9

Ne e filluam këtë libër duke thënë se hiri është personal, i përjetuar dhe i njohur përmes personit dhe veprës së Jezus Krishtit, i shfaqur në praninë e Frymës së Shenjtë. Siç vërehet nga Tomas Langford, hiri nuk njihet në mënyrë abstrakte si një parim, “por në vetëdhënien e vërtetë të Perëndisë në histori”.¹ Në Jezus Krishtin dhe në Frymë është prania, ripërtëritja e jetës njerëzore përjetohet përmes kërimit, shpëtimit, shenjtërimit dhe mbështetjes së hirit. Kjo shprehje e fundit biblike e hirit është për mua, më e mistershme nga të gjitha.

A keni menduar ndonjëherë pse ata që duket se kanë një jetë të lehtë mund të duken kaq të largët nga Perëndia, ndërsa ata që po kalojnë ujërat më të thella dhe po merren me betejat më të mëdha personale shpesh e ndiejnë afërsinë intime të Perëndisë? Në pamje të parë, të dy vëzhgimet duken kundërintuitive. Është e arsyeshme që ata me më pak probleme do të ishin më të lumtur dhe të rrethuar nga paqe më të madhe sesa ata që durojnë vuajtje të thella, megjithatë e kundërta është shpesh e vërtetë. Si ta shpjegojmë një paradoks të tillë?

Të lutesh: “U bëftë vullneti Yt në tokë si në qiell” do të thotë të rrëfesh se

1. Thomas A. Langford, *Reflections on Grace* (Eugene, OR: Cascade Books, 2007), 107.

jo gjithçka që ndodh në botë është vullneti i Perëndisë. Ne nuk i atribuojmë Perëndisë asgjë të keqe. Kurdoherë që e bëjmë, ne e vëmë në dyshim karakterin e Perëndisë. Urdhërimi i tretë ndalon përdorimin e emrit të Perëndisë kot, gjë që ka të bëjë më pak me mallkimin dhe më shumë ka të bëjë me keqprezantimin e Perëndisë në botë. Është një gjë serioze të emërtosh gjithçka që është e keqe si nga Perëndia ose të emërtosh diçka që është nga Perëndia si të keqe. Sidoqoftë, duhet përmendur që, edhe pse jo gjithçka që ndodh është vullneti i Perëndisë, megjithëse Perëndia ynë është i plotfuqishëm dhe gjithëdashës, Perëndia ka një vullnet në gjithçka, veçanërisht pasi ndërlihet me ata që Perëndia pretendon si të Tij dhe që qëndrojnë në Krishtin. Shkrimi na kujton se një nga specialitetet e Perëndisë është të shpengojë të gjitha gjërat, edhe kur synohet e keqja.

Jozefi u tha vëllezërve të tij xhelozë: “Ju keni kurdisur të këqija kundër meje, por Perëndia ka dashur që t’i shërbejë së mirës, për të kryer atë që po ndodh sot: të mbash gjallë një popull të shumtë.” (Zanafilla 50.20). Përsëri, Pali na kujton: “Ne e dimë se në të gjitha gjërat Perëndia punon për të mirën e atyre që e duan Atë, të cilët janë thirrur sipas qëllimit të Tij” (Romakëve 8.28). Jozefi nuk tha që Perëndia i shtyu vëllezërit e tij ta shisnin në skllavëri egjiptiane; ai tha se Perëndia nuk do t’i linte qëllimet e tyre të këqija ta kishin fjalën e fundit. Pali nuk tha që Perëndia bën që t’i ndodhin gjëra të këqija njerëzve të Tij; përkundrazi, ai tha se Perëndia është besnik për të punuar në çdo gjë, si të mirë, ashtu edhe të keqe, për të marrë atë që duket të jetë vetëm shkatërruese dhe e prishur dhe ta bëjë atë shëruese dhe të shenjtë. Këto shkrime të shenjta shpjegojnë pse ata në Krishtin që përballen me vuajtjet më të mëdha janë gjithashtu ata që përjetojnë paqen më të madhe. Diçka ndodh në jetën e një dishepulli plotësisht të shenjtëruar të Jezusit, i cili, përgjatë udhëtimit të hirit, kalon nëpër rrethana të vështira dhe situata kërkuese. Ata përjetojnë hirin e mjaftueshëm të Perëndisë në dobësinë e tyre për t’i mbështetur ata dhe për të siguruar atë që nevojitet në betejat e tyre më të mëdha.

Forca e përsosur në dobësi

Apostulli Pal foli për hir të mjaftueshëm në kontekstin e letrës së tij të dytë

drejtuar kishës së shekullit të parë në Korint. Sipas Palit, katërmëdhjetë vjet para se të shkruante letrën e tij për Korintasit, ai mori një vegim nga Perëndia ku ai “u rrëmbye gjer në të tretin qiell” (2 Korintasve 12.2). Shumica e studiuesve biblikë nuk besojnë se Pali po sugjeronte se ekzistojnë disa nivele të parajsës, por se ai po përshkruante një zbuluesë përtej kapacitetit të zakonshëm njerëzor për të parë dhe se ai ishte në gjendje, me frymëzimin e Frymës të perceptonte diçka përtej sferës fizike. Qëllimi i tij ishte t’u tregonte atyre dhe neve, se ai kishte hasur fuqimisht praninë e Perëndisë, kishte parë Krishtin e ringjallur dhe nuk do të ishte kurrë më i njëjtë; kjo i kishte ndryshuar jetën.²

Një përvojë e tillë euforike mund të bëjë që dikush të jetë krenar dhe mburravec shpirtëror. Njohës i rrezikut të mundshëm dhe për të mos u penguar në mendjemadhësi të pashenjtë, Pali shton se atij iu dha një “gjemb në mish” (12.7). As origjina dhe as specifikat e gjembit nuk janë plotësisht të qarta. Ne nuk e dimë nëse problemi ishte fizik, emocional apo në marrëdhënie.³ Ajo që është e qartë është se ajo u bë një barrë aq e rëndë për Palin, sa që iu referua atij si “një engjëll i Satanit, për të më rënë me grushta” dhe t’i kujtojë atij brishtësinë e tij (12.7). Ai iu lut Perëndisë që t’ia hiqte, t’i largonte mangësinë dhe kështu, me sa dukej, do ta bënte atë një udhëheqës më të fortë dhe më të mirë për kishën. Para se të eksplorojmë më tej gjembin, le të kujtojmë se Pali ishte një njeri i fortë. Ai nuk ishte dobësi shpirtërore. Në një vend tjetër, Pali përshkruan në detaje vuajtjet e tij si apostull:

Unë kam punuar shumë më shumë, jam burgosur më shpesh, rrahur më shumë herë sesa mund të llogaris, shpesh kam qenë në prag të vdekjes, nga judenj të mora pesë herë tridhjetë e nëntë kamxhikë, tre herë më rrahën

2. Douglas Ward, “The ‘Third Heaven,’” *The Voice: Biblical and Theological Resources for Growing Christians*, 2018, <https://www.crivoice.org/thirdheaven.html>. Shumë studiues pohojnë se vegimi që Pali përshkruan tek 2 Korintasve është një referencë për takimin e tij në rrugën e Damaskut me Krishtin e ringjallur.

3. Disa kanë speculuar se gjembi i Palit në mish ishte fizik: një gjendje e lëkurës, problem akut i shikimit ose epilepsi. Të tjerët kanë sugjeruar se gjembi ishte kujtimi i së kaluarës së tij si përndjekës i kishës dhe vështirësitë në marrëdhënie që mund të lindnin me të krishterët hebrej.

romakët me shkopinj, një herë më qëlluan me gurë, tre herë m'u mbyt anija në det, kalova një ditë e një natë i zhytur në det të hapur. Në udhëtime të shpeshta, në rreziqe lumenjsh, në rreziqe kusarësh, në rrezik nga ana e bashkëatdhetarëve, rrezik nga armiqtë, rrezik në qytet, rrezik në fshat, rrezik nga dielli i shkretëtirës dhe nga stuhija e detit dhe u tradhëtova nga ata që mendova se ishin vëllezërit e mi, në lodhje e në mundim, në netët pa gjumë, në uri e në etje, shpesh herë në agjërime, në të ftohtë dhe në të zhveshur.⁴

Për të mos përmendur presionin dhe ankthin e vazhdueshëm të marrjes me kishat problematike dhe anëtarë të padurueshëm të kishës!

Lexoni përsëri listën e sprovave të Palit. Ai i duroi të gjitha ato dhe pa dyshim më shumë (kafshimet e gjarprit më vijnë në mendje). A jeni i bindur akoma se Pali nuk ishte as një lule delikate dhe as një ankues çikërrues? Kjo na bën të supozojmë se cilido qoftë gjembi, nuk ishte një gjë e parëndësishme për Palin. Jo më pak se tre herë, Pali zbulon, ai i bëri thirrje Perëndisë që ta hiqte gjembin (një mënyrë biblike për të thënë: “Unë vetëm vazhdoja t’i kërkoja”).

Pali po na bën të vetëdijshëm se ai ishte në telashe të mëdha. Ai mbante një barrë që e shtypte dhe ai mund ta ndjente veten duke u penguar nën peshën e saj. Nuk ishte një gjë e vogël në sytë e Palit dhe ai u lut për shërim. Perëndia iu përgjigj lutjes së tij, por jo në mënyrën që priste. Jo Pal, ti do të mbash gjembin, por dije këtë: “Hiri Im të mjafton, sepse fuqia ime përsoset në dobësi.” (2 Korintasve 12.9). Ju jeni më të fortë në momentet tuaja më të dobëta kur Unë jam me ju sesa në momentet tuaja më të forta pa Mua. Forca ime është bërë e përsosur në dobësinë tuaj.

Bartur në krahët hyjnorë

Hiri i mjaftueshëm është mënyra e Perëndisë për të na thënë: “Kur të vini në fund të forcës suaj njerëzore, Unë do t’ju jap forcën Time të mbinatyrshme. Kur energjia juaj të mbarojë, energjia Ime do të bëhet e gjallë në ju. Kur nuk mund të shkoni më larg, Unë do t’ju marr dhe do t’ju mbaj. Pushoni pak në

4. Peterson, *The Message*, 2 Corinthians 11.23–27.

krahët e Mi.”

Ekziston një shëmbëlltyrë poetike moderne, e mirënjohtë e quajtur “Gjurmët e këmbëve në rërë”.

Një natë një burrë pa një ëndërr. Ai ëndërroi se po ecte përgjatë plazhit me Perëndinë. Nëpër qiell shkëlqenin skena nga jeta e tij. Për secilën skenë, ai vuri re dy grupe gjurmësh në rërë, njëra i përkiste atij dhe tjetra Perëndisë.

Kur skena e fundit e jetës së tij ndriçoi para tij, ai pa mbrapa gjurmët e këmbëve në rërë. Ai vuri re se shumë herë përgjatë shtegut të jetës së tij kishte vetëm një set gjurmësh. Ai gjithashtu vuri re se kjo ndodhi në kohërat më të ulëta dhe trishtueshme në jetën e tij.

Kjo e shqetësoi atë me të vërtetë dhe ai e pyeti Perëndinë për këtë. “Zot, Ti the që kur unë do të vendosja të të ndjekja, Ti do të ecje me mua gjatë gjithë rrugës. Sidoqoftë, kam vërejtur se gjatë kohërave më të mundimshme në jetën time ka vetëm një set gjurmësh. Nuk e kuptoj, pse kur kisha nevojë më së shumti për Ty, Ti do të më lije.”

Perëndia u përgjigj: “Fëmija im shumë i çmuar, Unë të dua dhe nuk do të të lija kurrë. Gjatë kohëve të tua të sprovës dhe vuajtjeve, kur sheh vetëm një set gjurmësh, ishte atëherë kur Unë të mbarta ty.”

Nëse dikush mund ta pasqyrojë hirin që na kërkon në formë imazhi, do të dukej si një bari në kërkim, një baba në pritje, një puthje zgjuere. Nëse hiri shpëtues do të ishte një figurë, do të dukej si një përqaftim, një birësim, pajtim. Nëse hiri i mjaftueshëm do të ishte një figurë, do të dukej si dikush që po bartej në krahët hyjnorë.

“Gjurmët e këmbëve në rërë” është më shumë se një shëmbëlltyrë, është një histori e jetës reale që kam dëgjuar vazhdimisht. Në vitet e mia si pastor, në asambltetë e mia kishte njerëz që përjetonin vuajtje të rënda dhe një hidhërim agonues, disa aq rëndë sa që pyesja veten se si kishin forcën të ngriheshin nga shtrati në mëngjes; njerëzit aq në fund të fuqisë të tyre, siç thotë Juxhin Piterson, sa “Unë mund të ndieja dëshpërimin e tyre në kockat e mia”.

Atëherë i dëgjoja duke thënë: “Pastor, nuk mund ta shpjegoj atë. Kjo nuk ka kuptim. E di që duhet të isha dërmuar nga e gjithë kjo, megjithatë unë ndiej” – dhe ata i përdorin këto fjalë – “sikur po më bartin. Jam thellësisht i trishtuar nga kjo humbje, nga kjo sëmundje, nga kjo vdekje, nga kjo tradhëti dhe duhet të isha copëtuar, por ka një paqe në mendjen time dhe një qetësi në shpirtin tim që është e pashpjegueshme. E vetmja mënyrë që mund ta përshkruaj është se është si të jesh duke u bartur në mënyrë të hirshme në krahët e përjetshëm.” Një set gjurmësh: hiri i mjaftueshëm.

Nëse ka një gjë që kam zbuluar kur bëhet fjalë për vuajtje, është se hiri i mjaftueshëm mbetet një realitet intelektual derisa të na nevojitet më së shumti. Dikush mund të dijë diçka në kokën e tij dhe kurrë të mos e dijë atë në zemrën e tij. Të përjetosh në të vërtetë, të qëndrosh lart, të bartesh, është përtej përkufizimit, vetëm mund të mbartet. I tillë është hiri i mjaftueshëm. Po flisja me një mik jo shumë kohë më parë i cili tha: “Unë nuk e di se çfarë do të bëja nëse do të humbja një nga fëmijët e mi. Unë nuk do të kisha forcën për të vazhduar më tej.”

Unë iu përgjigja: “Ke të drejtë. Ti nuk ke forcë tani, sepse nuk të është dashur të ecësh në atë rrugë. Shpresoj se nuk do të të duhet kurrë, por nëse do ta bëje ndonjëherë, do të kishte hir të mjaftueshëm.”

Hir “i mjaftueshëm”

Hiri i mjaftueshëm është gjithçka që ju nevojitet për sot. Është një dhuratë e përditshme e “mjaftueshme”. Është si mana në shkretëtirë. Populli i Perëndisë ishte në një udhëtim nëpër shkretëtirë. Kishte shumë pak ushqim dhe, nëse Perëndia nuk siguronte, ata do të vdisnin nga uria, prandaj Perëndia u dha atyre një dhuratë. Ai bëri që të binte bukë nga qielli. Çdo mëngjes kur njerëzit zgjoheshin, ishte në tokë jashtë çadrave të tyre, e freskët për atë ditë. Ata nuk u munduan për të, nuk punuan për të, as nuk paguan për të. Ishte aty si një dhuratë nga dora e Perëndisë. E tëra çfarë kishin për të bërë ishte ta mbledhin dhe ta përgatisin atë. Një kusht ishte se ata nuk mund ta ruanin atë. Ata nuk mund të mbushnin kanaçe me pjekurina të ëmbla dhe t'i ruanin ato për ditët

me shi. Ata nuk mund ta ruanin manën nën dyshekët e tyre për çdo rast nëse Perëndia nuk do ta mbante fjalën të nesërmen; nëse provonin, ajo prishej. Ajo mbushej me krimba, pushëzohej dhe kthehej në karrem peshku. Ata thjesht duhej të besonin se Perëndia do të siguronte gjithçka që i duhej sot dhe të kishin besim se Perëndia do të bënte të njëjtën gjë përsëri nesër. Mëshirat e tij janë të reja çdo mëngjes.

Kështu është hiri i mjaftueshëm. Nuk mund të ruhet për nesër. Është e mjaftueshme për sot. Perëndia na jep gjithçka që kemi nevojë sot, dhe është e mjaftueshme. Nesër do të jetë e mjaftueshme gjithashtu. Është “çfarëdo që të keni nevojë, unë jam” hir që na mbart kur nuk mund të shkojmë më tej. S’është për t’u habitur që Pali deklaroi me besim: “Prandaj me kënaqësi të madhe do të krenohem më tepër për dobësitë e mia, që fuqia e Krishtit të rrijë tek unë. Prandaj unë kënaqem në dobësi, në fyerje, në nevoja, në përndjekje, në ngushtica për shkak të Krishtit, sepse kur jam i dobët, atëherë jam i fortë.” (2 Korintasve 12.9–10).

Hiri që qëndron

Disa vite më parë, një pastor në Pensilvani pa një njeri pas kishës me një kapëse bulldogu në jakën e kostumit. Duke mos ditur se ai njeri punonte për një kompani kamionësh, logoja e biznesit e së cilës ishte një qen bulldog, ai me naivitet pyeti: “Çfarë simbolizon ai bulldog?”

Me një vezullim në sy, burri u përgjigj me djallëzi: “Epo Pastor, bulldogu simbolizon këmbënguljen me të cilën unë mbaj Jezus Krishtin”.

Pastori u përgjigj, “Është një simbol i mrekullueshëm – por teologji e gabuar”. I habitur, burri pyeti: “Çfarë do të thuash?”

“Asnjëherë nuk duhet të qëndroni për këmbënguljen me të cilën ju mbani Jezus Krishtin”, vërejti pastori. “Duhet të qëndroni për këmbënguljen me të cilën ju mban Jezus Krishti juve.”

Besimi në kohë të vështira nuk varet nga fakti se sa të fortë jemi ose sa besim kemi. Besimi në momentet më të errëta është vërtet çështje se sa i fortë është Perëndia. Pavarësisht se çfarë hasim në udhëtim, hiri i Perëndisë është i

mjaftueshëm për të na mbajtur lart, dhe dashuria e Tij është aq e fortë sa të na tërheqë përmes saj. Le të kujtojmë se “pa marrë parasysh çfarë ndodh” në jetë do të thotë që Jezus Krishti po na mban me këmbënguljen e një bulldogu dhe nuk do të na lëshojë kurrë.

Një grua në një kishë që po pastoroja papritmas u sëmur rëndë. Mjekët e dërguan atë përmes një pafund testesh për të parë se çfarë nuk shkonte në të. Ata zbuluan se ajo kishte një gjendje të rrallë që e bënte trupin i saj të kishte reaksione të forta alergjike ndaj çdo ushqimi që hante. Gjendja u bë shumë serioze, madje edhe kërcënuese për jetën. Gjatë asaj kohe, burri i saj u vendos në Afganistan për të kryer një turne detyre në ushtri. Ajo më në fund u shtrua në spital dhe u përball me një provë mjekësore që ata prisnin t’i shkaktonte një reagim të dhunshëm alergjik që përkohësisht do t’ia ndalonte frymëmarrjen. Askush nuk pret me padurim një reagim kaq të dhunshëm, veçanërisht kur dikush e di që po i vjen. Ajo më tha: “Pastor, unë isha shumë e frikësuar, madje deri në panik. Isha e shtrirë në shtratin e spitalit, duke ndjerë keqardhje për veten për atë që do të duroja dhe pyesja veten pse po më ndodhte e gjithë kjo. Mbi të gjitha, unë u mërzita që burri im ishte mijëra kilometra larg. Unë kisha frikë dhe ndihesha shumë e vetmuar.”

Erdhi koha për provën. Ajo ishte e tmerruar: “Tani e di se çfarë do të thotë termi “e frikësuar e ngurtë”. Unë fjalë për fjalë nuk mund të lëvizja dhe zbulova se as nuk mund të lutesha. Unë kurrë më parë nuk kam qenë në gjendje të mos lutem. E vetmja lutje që mund të nxirrja ishte: ‘Zot, të lutem më ndihmo.’”

Ajo iu kthye infermieres që do të administronte testin dhe pyeti: “A je e krishterë?”

“Po, jam”, u përgjigj infermierja.

“A do të lutesh për mua?”

Infermierja u përgjigj pa hezitim: “Sigurisht”, dhe ajo vazhdoi të bënte një lutje të thjeshtë për ngushëllim dhe shërim.

Shoqja ime më vonë më tha: “Ndërsa ajo po lutej, pata paqen më të pabesueshme që më pushtoi të tërën. Ishte gati sikur Perëndia i vuri duart mbi

mua dhe më ngriti në praninë e Tij” (po, ajo e përdori atë frazë). “E dija që Perëndia ishte me mua dhe papritmas frika u zhduk.”

Ata administruan testin dhe për habinë e të gjithëve, ajo nuk pati një reagim të dhunshëm. “Pastor, papritmas ndjeva këtë burim gëzimi që ngrihej në mua. Ishte një gëzim i egër. Nëse do të mund të kërceja nëpër dhomë, do të kisha kërcyer!”

Pikërisht në atë moment, infermierja e saj hoqi jelekun e rrezatimit që ajo kishte veshur duke iu varur rreth qafës një kryq të madh.

Tani me lot në sy nga ai kujtim i gjallë, shoqja ime më tha: “Atëherë e kuptova, Perëndia kishte qenë me mua gjatë gjithë kohës – thjesht nuk mund ta shihja Atë. Nuk mund ta ndieja praninë e Tij, por Ai ishte aty. Ai kishte qenë atje gjatë gjithë kohës. Megjithëse burri im ishte në Afganistan, unë isha ende nusja e Krishtit. Jezusi ishte burri im në atë moment, qëndroi pranë meje duke më mbajtur.”

Përgjatë udhëtimit të hirit, hiri i mjaftueshëm i Perëndisë na mbërthen në mënyra të ndryshme, por një nga mënyrat më të rëndësishme është përmes trupit të Krishtit. Nuk duhet të na habisë që, kur u lutëm që Perëndia të na zbulojë në dhimbjen tonë, Ai erdhi në formën e një kartoline ose një telefonate nga një person në kishën tonë duke thënë: “Unë të dua. Unë jam duke u lutur për ty. Perëndia është me ty”. Ne ndonjëherë hyjmë në bashkësinë e kishës duke mbajtur ato që duket se janë barrë të padurueshme dhe një vëlla ose motër në Krishtin vendos krahët rreth nesh dhe thotë: “Ju keni qenë në mendjen time kohët e fundit. Unë dua që ju të dini se jeni të dashur dhe në lutjet tona.” Dhe mrekulli e mrekullive, prania e mishëruar e Jezusit na rrethon, pothuajse sikur Ai po na mbante në atë moment me këmbënguljen e një bulldogu, duke na mbartur nëpër momentet më sfiduese të jetës sonë.

Kur një nga vajzat e mia ishte e vogël, ajo kishte frikë nga errësira. Unë dhe gruaja ime e fusnim atë në shtrat dhe i thoshim: “Mos ki frikë. Jezusi është këtu me ty”.

Ajo do të përgjigjej: “Mirë, mami dhe babi. Unë nuk do të kem frikë.”

Sidoqoftë, nuk vononte shumë dhe do të dëgjonim një trokitje në derën tonë të dhomës së gjumit. “Mami dhe babi, e di që Jezusi është me mua, por kam nevojë për dikë që duket si ju.”

Ajo kishte të drejtë. Ndonjëherë kemi nevojë për dikë që duket si ne. Kjo është ajo që është trupi i Krishtit, bashkësia e krishterë është Jezusi me lëkurë. Nëpërmjet trupave të ngrohtë të njerëzve, të mbushur me dhembshurinë e Tij të pakufishme dhe dashurinë e Tij të qëndrueshme, ne jemi të përqafuar dhe të mbajtur nga Perëndia.

Qëndresa, karakteri dhe shpresa

Dhimbja dhe vuajtja janë gjëra që zakonisht duam t'i shmangim. Nuk është e gabuar të dëshironi rehati dhe shëndet. Megjithatë, ne gjithashtu e dimë se mund të gjejmë gëzim, madje edhe shpresë, në kohë të dhimbshme dhe shqetësuese, sepse ne e dimë se forca e Jezusit është përsosur në dobësinë tonë. Në një letër tjetër drejtuar të krishterëve të shekullit të parë që jetonin në Romë, Pali tha: “Ne mburremi edhe në shtrëngimet, duke ditur që shtrëngimi prodhon këmbënguljen, këmbëngulja përvojnë dhe përvoja shpresën. Por shpresa nuk turpëron, sepse dashuria e Perëndisë është derdhur në zemrat tona me anë të Frymës së Shenjtë që na është dhënë.” (Romakëve 5.3–5). Edhe një herë, Pali po i referohet virtytit dhe formimit të karakterit në shëmbëlltyrën e Krishtit.

Së pari, vuajtja prodhon durim. Problemet, presioni dhe provat nuk janë aksidente të rastit të fatit që nuk kanë asnjë ndikim në qëllimin tonë përfundimtar (*telos*) të ngjashmërisë me Krishtin. Në gjuhën origjinale të Dhjatës së Re, “qëndrueshmëri” është fjala *hípomone*, që do të thotë të qëndrosh i palëkundur pa marrë parasysh çfarë ndodh, të qëndrosh i palëkundur edhe kur presionet e jetës vërshojnë mbi ne. Vështirësitë prodhojnë qëndrueshmëri dhe durimi është cilësia që thotë: “Unë nuk do të të lë, pavarësisht se çfarë ndodh”. Është e ngjashme me vrapimin në distancë të gjatë. Këmbët tuaja ndjehen të rënda, mushkëritë bërtasin për ajër, zemra juaj ndjehet sikur mund të shpërthejë nga gjoksi juaj dhe ju dëshironi fort të hiqni dorë. Sidoqoftë,

ju e dini që duhet të vazhdoni të vraponi sepse, në momentin kur doni të hiqni dorë, po merrni përfitimin më të madh të të qenit në formë. Kjo është *bipomone* – qëndrueshmëria nën presion. Ne mund të gëzohemi për problemet dhe sprovat tona duke ditur se presionet, madje edhe vuajtjet e jetës prodhojnë qëndrueshmëri dhe këmbëngulje. Së dyti, qëndrueshmëria prodhon karakter.

Fjala greke *dokime* fillimisht i referohej një metali që ishte rafinuar dhe i ishin hequr të gjitha papastërtitë. Problemet dhe sprovat prodhojnë qëndrueshmëri, dhe qëndrueshmëria prodhon forcë të karakterit. Në çdo nivel të shoqërisë, karakteri është jashtëzakonisht i nevojshëm sot. Riçard Xhon Neuhaus (*Richard John Neuhaus*) thekson kuptimin: “Që ne jemi qenie të reja në Krishtin është dhurata e pastër e Perëndisë; ndërtimi i karakterit është aktualizimi i asaj dhurate. Është një proces i mundimshëm për t’u bërë ata që në Krishtin, ne tashmë jemi. Kërkon respekt për përvojat e përditshme, aspektet kuidiane, të shtegëtimit të të krishterit.”⁵ Neuhaus përfundon me vendosmëri: “Karakterin nënkupton guximin dhe hirin për të jetuar një jetë të mirë në një botë ku nevojat kryesisht nuk plotësohen.”⁶ Dikush nuk merr forcën e karakterit me prokurë. Mbizotërimi përmes provave të situatave të jetës reale prodhon qëndrueshmëri, dhe qëndrueshmëria, kur bëhet e drejtë, prodhon integritet dhe thellësi karakteri.

Së treti, karakteri prodhon shpresë. Shpresa është besimi i qetë, i sigurt se Perëndia është me ne. Shpresa është pritja e sigurt që, pavarësisht se çfarë do të ketë e ardhmja, shoqëruesi ynë i udhëtimit të hirit mban të ardhmen. Problemi qëndror i epokës sonë nuk është stresi i tepërt, por shpresa e vogël. Në të vërtetë, Tomas Langford e thotë mirë: “Shpresa nuk i shtrihet së ardhmes; shpresa ndryshon kuptimin e së kaluarës dhe përcakton jetën në të tashmen. Ne jetojmë të transformuar në shpresë.”⁷

Një ilustrim mund të ndihmojë në sqarimin.⁸ Imagjinoni një dhomë të

5. Richard John Neuhaus, *Freedom for Ministry* (Grand Rapids: Eerdmans, 1979), 90.

6. Neuhaus, *Freedom for Ministry*, 88.

7. Langford, *Reflections on Grace*, 107.

8. E dëgjova këtë ilustrim në një predikim të predikuar nga Rev. Dr. Thomas Tewell in the 1990s

mbushur me maturantë të shkollës së mesme. Kthehuni tek ai në të majtë dhe pyesni: “Si po ju shkon viti i fundit i shkollës së mesme?”

Nxënësi përgjigjet: “Nuk po shkon shumë mirë. Unë ngela në disa lëndë, dhe nëse ngel edhe në një, nuk do të diplomohem. Më duhet të përsëris vitin e fundit.”

Ju pyesni përsëri: “Çfarë shihni në të ardhmen tuaj?”

“Epo unë shpresoj të diplomohem në maj, dhe më pas do të përpiqem të futem në një kolegji të komunitetit në vjeshtë.”

Pastaj i drejtoheni nxënësës në të djathtë dhe i bëni asaj të njëjtën pyetje. “Si jeni në vitin tuaj të fundit?”

“Po ec shumë mirë!” thotë ajo.

“Po mendon të shkosh në kolegji?”

“Absolutisht! Unë tashmë jam pranuar në Universitetin e Harvardit. Unë jam ende duke pritur të dëgjoj nga Princeton, Stanford dhe MIT, por kam shpresë.”

“Ju me siguri jeni një studente shumë e mirë. Dëshiron të më thuash ku renditesh në klasën tënde të shkollës së mesme?”

“Nga gjashtëqind studentë, unë jam e dyta në klasën time, me një mesatare prej 4.3 pikësh.”

“Uau! Kjo është mbresëlënëse! A mund të më tregoni se si keni dalë në provimin e SAT-it?”

“Kam marrë një 780 në matematikë dhe një 760 në gjuhë për një total prej 1540 pikësh.” (800 është një rezultat i përsosur në secilën kategori.)

“Kjo është pothuajse aq mirë sa bëra unë në SAT” shtoni duke qeshur. “Çfarë shihni në të ardhmen tuaj?”

Epo, shpresoj të diplomohem në maj dhe pastaj të vazhdoj në një nga ato universitete për t’u bërë shkencëtare kërkimore.”

Ju mendoni, “shpreson të diplomohesh”? Kjo e re ia ka hedhur! Nuk është as pyetje.

called “The Tenacity of a Bulldog.” (*Kryeneçësia e Bulldogut*)

A e shihni ndryshimin? Nxënësi i parë shpresonte përtej shpresës; nxënësja e dytë shpresonte me siguri se do të ndodhte. Shpresa të tilla nuk shtyhen për të ardhmen. Ai ndryshon kuptimin e së kaluarës dhe përcakton jetën në të tashmen. Ne jemi transformuar në dhe nga shpresa si kjo. Njerëzit ndonjëherë thonë: “Shpresoj që Perëndia të më dojë. Shpresoj që Perëndia të mos ma kthejë shpinën. Shpresoj që Perëndia të mos më braktisë kur jam në një situatë të pashpresë. Shpresoj që Perëndia të më mbajë lart dhe të më forcojë në orët e mia më të errëta.” Shpresa e krishterë bazohet në dashurinë e kaluar, të tashme dhe të ardhme të kryqit të Jezus Krishtit dhe fuqisë jetëdhënëse të ringjalljes së Tij. Kjo shpresë nuk na zhgënjën (Romakëve 5.5). Ne jemi në kontrollin e fortë të hirit të mjaftueshëm të Perëndisë. Ai na mban me këmbënguljen e një bulldogu.

Në duart e Tua e dorëzoj frymën Time

Jo rastësisht, e shkrova këtë kapitull gjatë pandemisë COVID-19, një kohë pasigurie të madhe dhe vuajtjesh të thella. E shtuna e madhe, një ditë para Pashkës, është menduar si një kohë për reflektim të qetë mbi vdekjen e Jezusit dhe për të kujtuar kohën e Tij në errësirën e një varri. Një nga tekstet mësimore për këtë ditë, Psalmi 31, përmbante fjalët që Jezusi tha nga kryqi para se të vdiste: “Atë, në duart e Tua po dorëzoj frymën Tim.” (Luka 23.46). Jezusi citoi drejtpërdrejt Psalmin 31.5, duke shtuar vetëm fjalën Abba (“Atë”) në lutjen e Tij.

Nga shumë gjëra që mund të mësohen nga kjo lutje e Jezusit, ajo që më bie në sy në shkretëtirën e COVID-19 është se ekziston një ndryshim i madh midis një jete të marrë dhe asaj që jepet. Jezusi e bëri të qartë në Ungjillin e Gjonit: “Askush nuk mund të ma heqë, por e lë nga vetja” (10.18). Ai heq dorë nga jeta me vullnet të lirë dhe me dëshirë. Vdekja e Jezusit në kryq nuk ishte një përfundim tragjik i një jete premtuese ose zhgënjimi i një misioni të dështuar. Ishte dizajni hyjnor gjatë gjithë kohës. Kryqi ishte plani kozmik i Perëndisë për të na shpëtuar nga errësira dhe vdekja e parimeve dhe fuqive. Kështu, sakrifica e Jezusit nuk iu imponua, Ai e përqafoi me dëshirë për ne. Ai e dinte se ishte

në duart e Perëndisë, kështu që mund të thoshte: “Unë e jap jetën Time për ta marrë përsëri” (10.17).

Duhet të na bëjë të ndalojmë dhe pyesim, a po na jepet apo po na merret jeta? Ekziston një ndryshim i madh midis të dyve, kryesisht në lidhje me çështjen e besimit. “At, në duart e tua e dorëzoj Frymën Tim” do të thotë që ne kemi besim se jeta jonë po jepet për diçka më të madhe dhe më të bukur sesa mund të arrijmë ndonjëherë, përveç Atit tonë qiellor. Jezusi duke u lutur për atë lutje në momentin më të vështirë të jetës së Tij na tregon se Ai tashmë e kishte bërë këtë lutje për një kohë të gjatë – përfshirë lutjet agonizuese që Ai bëri në kopshtin e Gjetsemanisë. “Në duart e Tua” është një lutje e dorëzimit të plotë sepse, në zemër të saj, është një deklaratë që ne po e heqim veten nga duart e njerëzve dhe rrethanave të tjera – përfshirë planet dhe qëllimet tona – dhe po e vëmë me vetëdëshirë jetën tonë në duart e Perëndisë. Në një kuptim të fuqishëm, ai ripërcakton dhe riimagjinon përvojat e jetës sonë ose duke lejuar që gjërat të na ndodhin, ose duke e vënë veten në kujdesin e Perëndisë për të drejtuar hapat tanë. Njëra është të marrësh diçka, tjetra po e dorëzon atë. Mund të jetë humbje ose dorëzim.

Jezusi na prezanton me fuqinë tronditëse të sakrificës. Ai na tregon se, duke iu dorëzuar Perëndisë, ne jemi në gjendje ta kthejmë diçka që duket për të gjithë botën si një humbje në diçka që është për të gjithë botën një fitim. Kur Frederik Buechner (*Frederik Buechner*) thotë: “Të sakrifikosh diçka do të thotë ta bësh të shenjtë duke e dhënë atë për dashuri”, ai do të thotë se edhe nëse dikush po përpiket ta heqë atë nga duart tona, edhe kur ndjehet se është jashtë kontrollit tonë, ne ende mund të vendosim se si do ta dorëzojmë.⁹ Ne ende mund të hapim duart në momentin e fundit dhe të japim atë që të tjerët menduan se po na merrej dhe cilat rrethana dukej se po na e vidhnin. Ne mund ta bëjmë të shenjtë duke e bërë atë për dashuri, duke ia dorëzuar Perëndisë.

Në përvojën surreale të pandemisë COVID-19, me ditë të grumbulluara në javë, ishte e lehtë të ndiheshim sikur diçka po na merrej. Ne u ndjemë të

9. Frederick Buechner, *Wishful Thinking: A Seeker's ABC* (New York: HarperOne, 1973), 10

frikësuar, të zemëruar, të pasigurt dhe krejt jashtë zonave tona të rehatisë. Ne kishim një zgjedhje për të bërë. Ne mund ta luanim viktimën dhe të thoshim: “Diçka po më merret”, ose mund t’ia dorëzonim Perëndisë dhe të thoshim: “O At, në duart e Tua e dorëzoj frymën Tim. Ne i dorëzohemi planeve dhe qëllimeve të Tua. Jeta jonë nuk është e jona. Unë e dorëzoj atë, sepse të përkasim Ty, dhe e dorëzoj atë për dashuri, në mënyrë që ta bëni të shenjtë “. Kjo kërkon njëfarë besimi nga ana jonë, por shpërblimi është paqja absolute e të kuptuarit se jeta jonë e ka përlëvduar Perëndinë, se jetët tona nuk janë aksidente apo dështime të rastësishme nervore, por që ditët tona janë në duart e Tij. As një pandemi globale nuk dikton qëllimin dhe kuptimin e jetës sonë. Askush nuk na merr jetën – ne e japim atë. Ky është realiteti i shpresës sonë.

Hiri i vajtimit

Hiri i mjaftueshëm nuk eliminon gjithë frikën dhe dyshimin tonë. Nuk ka mundësi për ta kapërcyer atë: edhe me shpresë se ka vend për pyetje. Është e mundur të kesh besim edhe kur ka më shumë pyetje sesa përgjigje. Është e mundur të trishtohesh dhe të ruash shpresën në të njëjtën kohë. Jo vetëm që është e mundur – është gjithashtu biblike. Ne e quajmë vajtim. Nga 150 Psalmet në librin e lutjeve që ne i quajmë Psalter, ekzistojnë larmishmëri të ndryshme psalmesh, duke përfshirë falenderimet, mbretërorët, shtegtimet, vajtimet dhe madje edhe mallkueset (lutjet ne i lutemi kur jemi të zemëruar). Psalmet na ofrojnë shembuj, si Fjala e frymëzuar e Perëndisë, se si të lutemi në çdo situatë të jetës.

Psalmet e falënderimit (halel – prej nga e marrim fjalën tonë “haleluja”) janë lutjet e lavdërimit që ofrojmë kur jeta po shkon mirë dhe prania e Perëndisë ndihet veçanërisht afër. Psalmet e vajtimit nga ana tjetër, janë lutjet që i thërrasim Perëndisë në dhimbjen tonë, kur jeta është e vështirë dhe e paqëndrueshme, pafund në sy. Dy pyetjet kryesore të ngritura në vajtim janë: “Pse po ndodh kjo?” dhe “Sa do të zgjasë kjo?” Jo vetëm që Perëndia i lejon këto lloj pyetjesh, por është gjithashtu interesante të theksohet se 70 përqind e psalmeve biblike janë lutje dhimbjeje, jo lutje lavdërimi – vajtime, jo *halel-e*. Vetë Jezusi bëri një

lutje vajtimi (Psalmi 22) gjatë vuajtjeve të Tij në kryq.

Shenja dalluese e vajtimin nuk është dyshimi, por besimi i rrënjësor thellë në besnikërinë e Perëndisë. Ndërsa vajtimi mund të fillojë si një klithmë dëshpërimi, karakteristika e tij më e rëndësishme është besimi i thellë në natyrën, karakterin dhe fuqinë e Perëndisë, i cili është i pranishëm, që merr pjesë dhe është i vëmendshëm ndaj errësirës, dobësisë e vuajtjes së jetës. Vajtimi është varësia e plotë dhe dorëzimi i plotë tek një Perëndi që mund të duket i largët, por që nuk mungon kurrë.

Unë kam një mik, i cili u diagnostikua me një formë të rrallë të kancerit. Për shkak të pazakonshmërisë së sëmundjes, mjekët e tij po provojnë forma të ndryshme të terapisë, shumë prej të cilave janë eksperimentale. Mjerisht, pavarësisht kujdesit dhe shkencës më të mirë në dispozicion, kanceri ka vazhduar të përhapet në trupin e tij. Një ditë, pas një raporti tjetër të keq, gruaja e tij postoi këtë dëshmi në Facebook: “Ndërsa alternativat e trajtimit mjekësor po zvogëlohen, realiteti i pranisë së Perëndisë po rritet.” Unë nuk di për një shprehje më të bukur të vajtimin dhe shpresës së drejtë në hirin e mjaftueshëm të Perëndisë.

Ne jemi më të fortë në momentet tona më të dobëta kur Perëndia është me ne sesa çastet tona më të forta pa Të. Ne e kemi këtë siguri për udhëtimin e hirit: forca e Tij është e përsosur në dobësinë tonë. Kjo është një shpresë që nuk na zhgënjën. Ne do ta lëmë Pjetrin të thotë fjalën e fundit mbi hirin e mjaftueshëm: “Dhe Perëndia i çdo hiri, që ju thirri në lavdinë e Tij të përjetshme në Krishtin Jezus, mbasi të kenë vuajtur për pak kohë, do t’ju bëjë të përsosur Ai vetë, do t’ju bëjë të patundur, do t’ju forcojë dhe do t’ju vërë themel.” (1 Pjetrit 5.10)

PASTHËNIE

JEZUS KRISHTI ËSHTË ZOT

Një jetë plotësisht e përkushtuar ndaj Perëndisë ka më shumë vlerë për Të sesa njëqind jetë të cilat thjesht janë zgjuar nga Fryma e Tij.

Oswald Chambers (*Oswald Chambers*)

Kaq shumë gjëra kanë ndryshuar në njëqind vitet e fundit. Paramendoni të kishit lindur në vitin 1920 dhe të jeni gjallë në vitin 2020. Vetëm në një shekull të vetëm, konteksti kulturor në çdo rajon të botës ka kaluar nga industriale në informacion (Gutenberg në Google), nga rurale në atë urbane, dhe nga të menduarit modern në të menduarit postmodern. Këto janë ndryshime tektonike kulturore që mbetën të pandryshuara në pesëqind vitet e mëparshme. Ai që kishte qenë një mjedis i ndryshimit të vazhdueshëm (ajo që është zhvilluar nga ajo që ka kaluar më parë dhe për këtë arsye mund të pritet, parashikohet dhe menaxhohet) për gjysmë mijëvjeçari shpejt u zhvendos në një situatë ndryshimi të shpejtë, të vazhdueshëm që ishte trazues dhe i paparashikuar.¹ Ne jemi në ujëra kryesisht të panjohura.

Këto ndryshime tronditëse të themelit kanë krijuar situata të reja që sfidojnë supozimet e vjetra se si funksionon bota. Si rezultat, eklesiologjia (natyra dhe struktura e kishës) dhe misiologjia (sesi kisha e përfshin misionin e Perëndisë)

1. Alan J. Roxburgh, *The Missional Leader: Equipping Your Church to Reach a Changing World* (San Francisco: Jossey Bass, 2006), 7.

nga nevoja janë bërë shumë përshtatëse pa u kompromentuar. Sidoqoftë, në aspekte të rëndësishme, ajo që mbetet e vazhdueshme në këtë kohë ndryshimi të shpejtë, të vazhdueshëm është parimi i përjetshëm që Jezusi është Udhë, e Vërteta dhe Jeta – ose, sipas fjalëve të rrëfimit të hershëm të krishterë: “Jezus Krishti është Zot ..”

Atë që ne e konsiderojmë “Zot” është një bazë themelore për udhëtimin e hirit. Nëse themi, “[PLOTËSOJENI VETË] është ‘zot’”(dhe me të vërtetë nuk ka rëndësi nëse është një person tjetër, një gjë tjetër, apo vetja), ai ndryshon të gjithë tregimin, përfshirë qëllimin përfundimtar dhe rezultatin përfundimtar. Por nëse besojmë vërtet se Jezus Krishti është Zot, i caktuar të jetë i tillë nga përjetësia në përjetësi, ka vetëm një përgjigje të drejtë: dishepullimi. Riçard Xhon Neuhaus, na kujton se autoriteti i Perëndisë nuk është “vetëm një pohim i faktit, por një premtim i besnikërisë personale dhe të përbashkët”.² Meqenëse Jezus Krishti është Zot, ne duam të jemi si Ai. Ne duam të bëjmë atë që bëri Jezusi dhe të jetojmë ashtu siç jetoi Ai. Ky është përkufizimi i dishepullimit të krishterë dhe është ende mënyra sesi Jezusi hyn në kishën e Tij.

Dallas Uillard bën argumentin bindës se Dhjata e Re është një koleksion librash për dishepujt, nga dishepujt dhe për dishepujt e Jezus Krishtit.³ Prandaj, qëllimi i dishepullimit nuk është vetëaktualizimi (“Unë kam nevojë për të gjetur veten time të vërtetë dhe atë që është më e mira për mua”) ose dorëheqja nga forcat e paracaktimit (“Unë nuk mund ta ndryshoj atë; kjo është mënyra se si jam.”). Në fakt, nga perspektiva e krishterimit, të qenit i vërtetë me veten do të thotë të jesh i vërtetë me veten që ne jemi thirrur nga Perëndia Atë, të rimodeluar në ngjashmërinë e Birit të Tij. Të ndjekësh Jezusin dhe të bëhesh si Ai është qëllimi mospëndues i udhëtimit të hirit. Gjoni, Shkruesi i Ungjillit mundohet shumë për të na thënë se Jezusi duket dhe vepron si Ati i Tij: “Nëse më keni parë Mua, keni parë Atin” (14.9), dhe se Jezusi është Fjala e bërë mish

2. Neuhaus, *Freedom for Ministry*, 98.

3. Willard, *The Great Omission*, 3. Uillard përsërit se fjala “dishepull” paraqitet 269 herë në Dhiatën e Re, ndërsa “i krishterë” gjendet tre herë dhe prezantohet për t’iu referuar pikërisht dishepujeve të Jezusit në Antioki (shih Veprat e Apostujve 11.26).

dhe, që ka ardhur nga Ati i Tij, është plot hir dhe të vërtetë (1.14). Kush është Jezusi dhe çfarë bën Jezusi janë dy anët e së njëjtës medalje, një realitet që ngre argumente të rëndësishme për natyrën e dishepullimit tonë.

Përkundër mendimit popullor, Perëndia nuk është një plak sentimental me mjekër të gjatë e të bardhë, i cili tund dorën me mospërfillje dhe thotë: “Nuk ka rëndësi se çfarë bëjnë; Unë thjesht dua që të rinjtë të kënaqen dhe të kalojnë një kohë të mirë.” As nuk është Perëndia Ati zemërues, i ashpër dhe i zemëruar, i cili mezi pret që fëmijët e Tij të gabojnë, në mënyrë që të shfaq zemërimin e Tij dhe t’i ndëshkojë ata. E para është hiri pa të vërtetën, kënaqësia e butë pa zjarrin e shenjtërisë, e cila çon në lejueshmëri të papërgjegjshme. E dyta është e vërteta pa hir, religjioziteti i pamëshirshëm që të çon në legalizëm të ngurtë me pak dashuri. Për të qenë të sigurt, nuk është e lehtë të ruash ekuilibrin midis hirit dhe së vërtetës, por ato duhet të mbahen në tendosje për domosdoshmërinë dhe integritetin e dashurisë së shenjtë.

Në thelb, fakti që kaq shumë njerëz në kishat tona janë të krishterë në emër, por nuk janë dishepuj të Jezus Krishtit që është Perëndia, është problemi i madh i kishës sot. Fakti që dishepullimi i shenjtëruar (një jetë e të mësuarit se si të jetosh në mbretërinë e Perëndisë siç bëri Jezusi) është bërë fakultative përveç për më radikalët mes nesh është katastrofike, jo vetëm sepse përjetëson idenë se Jezusi mund të jetë Shpëtimtari yt pa qenë Perëndia yt por, ndoshta më e rëndësishmja, sepse supozon se hiri është dhënë për të na pranuar ashtu siç jemi, por nuk ka ndikim në atë që bëhemi.

Vëzhgimi i C.S. Luis se “i krishteri nuk mendon se Perëndia do të na dojë sepse ne jemi të mirë, por që Perëndia do të na bëjë të mirë sepse na do” është thjesht një mënyrë tjetër për të thënë se Perëndia na do ashtu siç jemi, por na do aq shumë sa nuk na lë aty. Dashuria e Perëndisë është dashuri e shenjtë, kështu që lloji i njerëzve që ne bëhemi ka rëndësi për Perëndinë. Dashuria e shenjtë është plot hir dhe të vërtetë. Dashuria e shenjtë davarit hirin e lirë. Dashuria e shenjtë bëhet kushti dhe mjeti për dishepullimin. Dashuria e shenjtë kërkon që ne të marrim kryqin tonë dhe të ndjekim Jezusin.

Nëse marrja e kryqit tonë duket si një mesazh i vështirë për kohën tonë, merrni parasysh alternativën: ekzistenca anemike dhe e pakuptimtë e jetuar për veten: feja pa marrëdhënie. Unë nuk kam qenë në gjendje t'i shpëtoj komenteve të Dallas Uillard mbi koston e “mosdishepullimit” (fjala e tij):

Kostoja e mosdishepullimit është shumë më e madhe ... sesa çmimi i paguar për të ecur me Jezusin. ... Mosdishepullimi kushton paqe të qëndrueshme, një jetë e përshkuar nga dashuria, besim që sheh gjithçka nën dritën e qeverisjes mbizotëruese të Perëndisë për mirë, shpresë që qëndron e patundur në rrethanat më dekurajuese, fuqi për të bërë atë që është e drejtë dhe për t'i bërë ballë forcave të këqija. Me pak fjalë, mosdishepullimi ju kushton pikërisht atë bollëk jete që Jezusi tha se erdhi për ta sjellë (Gjoni 10.10). Zgjedha e Krishtit në formë kryqi është në fund të fundit një mjet çlirimi dhe fuqie për ata që jetojnë në Të, me Të dhe mësojnë butësinë dhe përlësinë e zemrës që i sjell pushim shpirtit.⁴

Dishepullimi është një udhëtim hiri që fillon dhe përfundon me Jezusin, i cili është Udhë, e Vërteta dhe Jeta. Qëllimi i dishepullimit është të ndjekim Jezusin ndërsa ne, me anë të hirit, bëhemi gjithnjë e më shumë si Ai. Udhëtimi fillon dhe mbështetet nga hiri, por aktualizohet ndërsa ne bashkëpunojmë lirshëm me Jezusin si Zot.

Të krishterët lindin; dishepujt bëhen. Ngjashmëria me Krishtin është fati ynë.

4. Dallas Willard, *The Great Omission*, 8.

